

EKOINFO-SISTEM

KËRKIME NË SHKENCAT EKONOMIKE DHE INFORMATIKE



UMSHPRESS

Qëllimi dhe objektivat

Revista EkoInfo-Sistem, si pjesë e shtëpisë botuese UMSH Press, boton studime, kërkime, vëzhgime dhe analiza në fushën e ekonomisë dhe informatikës. Ajo synon të nxisë debatin shkencor në këto disiplina, duke përfshirë mjedisin universitar shqiptar dhe subjektet e biznesit që janë baza e ekonomisë së vendit. Me punimet e saj revista do të ofrojë një mbështetje qoftë edhe modeste për të gjithë të interesuarit në nxitjen e konkurrencialitetit të subjekteve ekonomike, rritjen e nivelit të tyre të digjitalizimit, forcimin e kapaciteteve eksportuese dhe përmirësimin e aktiviteteve menaxheriale, me ndikim në rritjen e rendimentit të punës.

Filozofia editoriale: Bordi editorial dhe gjithë struktura organizative e kësaj reviste janë të përkushtuar që të rrisin mundësinë e botimeve si me problematika teorike ashtu dhe me rekomandime praktike, në mënyrë që në fushat përkatëse mundësia e botimit të jetë shumë e lartë. Kjo politikë realizohet nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë të bordit editorial me autorët e artikujve, që nga faza e paraqitjes së tyre deri sa ato marrin formën përfundimtare për botim.

Njëkohësisht, i gjithë procesi i rishikimit, sugjerimit, rikonceptimit problemor të përmbajtjes dhe pasqyrimit të vërejtjeve të çdo artikulli është tërësisht i fshehtë, duke garantuar objektivitetin e vlerësimit, barazmundësinë e botimit dhe mbi të gjitha cilësinë e punimit. Ky proces garantohet nga një aplikacion specifik i botimit të revistës, që siguron një sistem të mbyllur gjatë gjithë procesit të përpunimit të çdo artikulli. Bordi editorial realizon një procedurë transparente për autorët në ndihmë të cilësisë së botimeve.

Për autorët: Revista synon t'ju shërbejë interesave të studiuesve parësorë, pedagogëve, studentëve të universiteteve të vendit dhe praktikienëve në biznese dhe organizata të tjera. Të gjithë autorët që do të botojnë në këtë revistë do të përfitojnë një ripozicionim të tyre në tregun e botimeve, ndërtimin e marrëdhënieve më aktive me studentët, pedagogët, kërkuesit dhe sidomos më shumë paraqitje për problematikat e fushës së ekonomisë dhe informatikës në fondin e literaturës shqiptare.

Revista EkoInfo-Sistem

KRYEREDAKTOR

Nikollaq Pano
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

REDAKTORË

Lindita Milo
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Dhimitri Tole
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

ANËTARË TË REDAKSISË

Neki Frashëri,
Akademia e Shkencave

Kozeta Sevrani
Universiteti i Tiranës

Greta Angjeli
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Jusuf Qarkaxhia
Universiteti AAB, Prishtinë

Shpetim Latifi
Ministria e Arësimit, RMV

Frederik Premti
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Ira Gjika
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Mimoza Kasimati
Universiteti i Tiranës

Orkida Ilollari
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Florjan Bombaj
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Dolantina Hyka
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Olgerta Idrizi
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Vebina Resuli
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Blerina Metanj
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Kreshnik Vukatana
Universiteti i Tiranës

Elis Pelivani
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Blerina Vika
Universiteti i Tiranës

Elira Hoxha
Universiteti i Tiranës

GRAFIK DIZAJN

Iris Tole GR Property Mng; UX Leader ; +1 269 290 6184

UMSHPRESS

Adresa: Blv. Gjergj Fishta, Nr. 52 Kodi postar: 1023, Tiranë
email: revistaekoinfo@umsh.edu.al

Përmbajtja

Rikornizimi i drejtësisë shpërndarëse: Qasje teorike ndaj perspektivave komunitariste, meritokratike dhe të njohjes	2
Përdorimi i rrjeteve sociale dhe ndjeshmëritë digjitale të studentëve: Një vëzhgim eksplorues në një institucion të arsimit të lartë në Shqipëri	16
Kujdesi për të moshuarit në Francë e Shqipëri: Mësime e perspektiva	28
Pabarazia gjinore dhe tavani i qelqtë në arsimin e lartë shqiptar	43
Si mundën hipermarketet shqiptare të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm?	65
Një qasje teorike e formimit të pritshmërive, sjelljes kognitive dhe politikave makroekonomike	83
Auditimi i brendshëm si instrument strategjik i qeverisjes së mirë	100

Rikornizimi i drejtësisë shpërndarëse: Qasje teorike ndaj perspektivave komunitariste, meritokratike dhe të njohjes

Nerajda Feruni ^{a,1}

^a *Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë*

Përmbledhja

Ndërsa qasjet egalitariste dhe utilitariste kanë dominuar për një periudhë të gjatë debatin mbi drejtësinë shpërndarëse, teori të tjera alternative si komunitarizmi, drejtësia e bazuar në meritë dhe drejtësia e bazuar në njohje kanë ofruar korniza morale të veçanta përmes të cilave drejtësia mund të interpretohet, vlerësohet dhe rikonceptohet përtej barazisë materiale apo maksimizimit të mirëqenies. Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një qasje tërësisht teorike mbi komunitarizmin, teoritë e drejtësisë të bazuara në meritë dhe ato të bazuara në njohje, duke analizuar themelet e tyre konceptuale, përfaqësuesit kryesorë dhe kufizimet që janë evidentuar në debatin akademik. Punimi karakterizohet nga një natyrë përshkruese dhe mbështetet në një qasje cilësore. Pavarësisht dallimeve midis tre teorive, ato arrijnë në një përfundim të përbashkët: drejtësia shpërndarëse përbën një realitet moral kompleks e shumëdimensional, i cili nuk mund të shpjegohet në mënyrë të plotë përmes një parimi normativ të vetëm.

Fjalë kyçe: drejtësi shpërndarëse; komunitarizmi; meritë; njohje

Abstract

While egalitarian and utilitarian approaches have long dominated the discourse on distributive justice, alternative perspectives such as communitarianism, desert-based theories, and recognition-based theories have introduced distinct moral frameworks for understanding justice. These approaches extend the analysis of justice beyond equality and welfare maximization, emphasizing its relational, ethical, and contextual dimensions. This study aims to present a comprehensive theoretical

¹ KONTAKT: nerajda.feruni@umsh.edu.al

analysis of these three frameworks, focusing on their conceptual foundations, leading contributors, and the limitations highlighted within academic discourse. The study adopts a qualitative approach, focusing only on theoretical aspects of each of the theories. Despite their conceptual differences, these theories converge on a shared insight: distributive justice constitutes a complex and multidimensional moral construct that cannot be fully explained through a single normative principle.

Keywords: distributive justice; communitarianism; desert; recognition

1. Hyrje

Drejtësia shpërndarëse i referohet shpërndarjes së drejtë të përfitimeve, barrës dhe burimeve midis anëtarëve të shoqërisë (Lamont & Favor, 2017). Ky koncept ngre pyetje themelore mbi mënyrën se si duhet ndarë në mënyrë të drejtë pasuria, përgjegjësitë dhe mundësitë brenda një shoqërie. Pikërisht mënyra se si duhet bërë kjo ndarje ka qenë një ndër shqetësimet më të qëndrueshme të filozofisë morale dhe politike. Ndërsa modelet egalitariste dhe utilitariste kanë dominuar për një kohë të gjatë debatin, teoritë alternative si komunitarizmi, teoritë e drejtësisë të bazuara në meritë (desert-based theories) dhe teoritë e drejtësisë të bazuara në njohje (recognition-based theories) kanë ofruar themele morale të ndryshme për të kuptuar drejtësinë përtej barazisë materiale apo maksimizimit të mirëqenies (Miller, 2001; Sandel, 1982; Fraser & Honneth, 2003).

Secila prej këtyre qasjeve ofron një këndvështrim të veçantë mbi drejtësinë shpërndarëse, të rrënjosur përkatësisht në vlerat komunitare, në meritat individuale dhe në dinjitetin e njohjes shoqërore. Për komunitaristët, drejtësia nuk është një nocion universal, por shihet e rrënjosur në mënyrën konkrete të jetesës së njerëzve dhe në traditat morale të komuniteteve të tyre, të cilat ndryshojnë sipas kontekstit kulturor e historik (Bell, 2024). Sakaq, teoritë e drejtësisë të bazuara në meritë mbështeten në idenë se shpërndarja e drejtë e burimeve duhet të reflektojë kontributin dhe përpjekjen individuale (Lamont & Favor, 2017). Kjo qasje sintetizohet në parimin e njohur moral: “çdo kujt sipas meritës së tij”. Më tej, teoritë e njohjes e zgjerojnë kuptimin e drejtësisë përtej sferës ekonomike, duke e lidhur atë me respektin, dinjitetin dhe pjesëmarrjen e barabartë të individëve dhe grupeve në jetën shoqërore. Në këtë kuadër, drejtësia shihet si një proces njohjeje reciproke, përmes së cilës çdo aktor afirmohet si pjesëmarrës i plotë në jetën kolektive (Iser, 2019).

Të marra të treja sëbashku, këto teori ilustrojnë një zhvendosje në diskursin mbi drejtësinë shpërndarëse, ku secila ofron një lente morale të veçantë përmes së cilës mund të vlerësohet dhe rikonceptohet drejtësia. Pavarësisht dallimeve ndërmjet tyre, këto qasje përputhen në një përfundim thelbësor: peisazhi moral i drejtësisë është shumëdimensional dhe drejtësia shpërndarëse nuk mund të reduktohet në një parim normativ të vetëm. Një perspektivë e tillë ofron mjete konceptuale për t'u përballuar me sfidat bashkëkohore që karakterizohen nga pabarazia, diversiteti kulturor dhe politikat e identitetit. Në këtë kontekst, studimi i këtyre teorive bëhet veçanërisht domethënës, pasi ndihmon jo vetëm në zbardhjen e koherencës së tyre të brendshme dhe limitimeve, por edhe në nënvizimin e kontributit të tyre në zgjerimin e horizonteve morale të drejtësisë shpërndarëse.

Andaj, qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një qasje tërësisht teorike mbi komunitarizmin, teoritë e drejtësisë të bazuara në meritë dhe teoritë e bazuara në njohje, duke shqyrtuar themelet e tyre konceptuale, përfaqësuesit kryesorë dhe kufizimet që janë evidentuar në debatet akademike. Në vijim, ky punim synon të japë një kontribut të vlefshëm në pasurimin e bazës teorike në gjuhën shqipe mbi këto teori alternative të drejtësisë shpërndarëse. Punimi karakterizohet nga një natyrë përshkruese dhe mbështetet në një qasje cilësore. Analizimi i këtyre teorive në kontekstin shqiptar dhe rajonal mbetet një fushë premtuese kërkimi, që mund të thellojë kuptimin mbi mënyrën se si konceptet e drejtësisë shpërndarëse ndërthuren me realitetet sociale, ekonomike dhe kulturore të këtyre shoqërive.

2. Disa teori të drejtësisë shpërndarëse

2.1 Komunitarizmi

Teoritë komunitariste të drejtësisë sfidojnë idenë se parimet e drejtësisë janë të zbatueshme në mënyrë universale dhe theksojnë se drejtësia është e rrënjësor thellë në vlerat e përbashkëta dhe traditat kulturore të komuniteteve. Mendimtarët komunitaristë argumentojnë se standardet dhe konceptet e drejtësisë duhet të kërkohen në format konkrete të jetesës dhe në traditat e shoqërive dhe mund të ndryshojnë nga një kontekst në tjetrin (Bell, 2024). Nga ky këndvështrim, drejtësia shihet si e lidhur në mënyrë të qenësishme me komunitetin. Ajo që konsiderohet si shpërndarje e drejtë mund të ndryshojë sipas normave të komunitetit dhe kuptimit shoqëror të të mirave.

Një nga zërat më të rëndësishëm komunitaristë në drejtësinë shpërndarëse është Michael Walzer. Në veprën e tij *Spheres of Justice: A Defense of Pluralism and Equality* (1983), Walzer kundërshton idenë se një parim i vetëm i tillë si barazia apo dobia duhet të udhëheqë të gjitha format e shpërndarjes. Ai propozon se shoqëria përbëhet nga sfera të shumta të të mirave, secila me kriteret e veta të drejtësisë, të cilat përcaktohen nga kuptimi shoqëror që i atribuohet asaj të mire. Për shembull, pushteti politik, në një shoqëri demokratike, duhet të shpërndahet përmes procedurave demokratike, si parimi “një person, një votë” dhe jo përmes transaksioneve monetare. Po kështu, arsimi duhet të shpërndahet bazuar në meritë dhe nevojë, pra, kush kualifikohet dhe kush përfiton më shumë, dhe jo sipas kapacitetit për të paguar. Në fushën e kujdesit shëndetësor, drejtësia kërkon që shpërndarja të bëhet sipas nevojës, duke u dhënë përparësi më të sëmurëve, përpara pasurisë apo statusit shoqëror. Sipas Walzer, edhe nderimet dhe pozitat duhet të bazohen në meritë dhe kontribut, jo në ndikim apo interes personal. Ndërkohë, mallrat dhe të mirat e zakonshme mund të shpërndahen përmes mekanizmave të tregut, por edhe këta mekanizma duhen kufizuar brenda sferës së tyre.

Koncepti i *barazisë komplekse* i Walzer (1983) qëndron në qendër të teorisë së tij mbi drejtësinë shpërndarëse dhe paraqet një përgjigje komunitariste ndaj dominimit dhe hierarkive shoqërore. Në një shoqëri të drejtë të udhëhequr nga barazia komplekse, asnjë e mirë e tillë si pasuria, pushteti politik apo arsimi, nuk duhet të dominojë qasjen ndaj të mirave të tjera. Barazia komplekse kërkon që çdo sferë e të mirave shoqërore të funksionojë sipas parimeve të veta të brendshme të shpërndarjes. Pabarazitë brenda çdo sfere mund të ekzistojnë, por janë të pranueshme vetëm nëse mbeten të kufizuara në atë fushë dhe nuk përkthehen në dominim të përgjithshëm shoqëror. Ky kuadër bën të mundur atë që Walzer e quan “monopole lokale të shumëfishta”. Duke ruajtur kufij të qartë ndërmjet sferave dhe duke parandaluar konvertimin e një të mire në një tjetër, barazia komplekse siguron mbrojtje kundër dominimit dhe Walzer ndërton një vizion pluralist të drejtësisë, ku shpërndarja nuk ndjek një formulë universale, por përcaktohet nga kuptimi shoqëror i të mirave dhe nga normat që rregullojnë secilën sferë të jetës kolektive.

Filozofi Michael Sandel, në veprën e tij *Liberalism and the Limits of Justice* (1982), argumenton se konceptimi i drejtësisë nuk mund të jetë i shkëputur nga vlerat, traditat dhe konteksti shoqëror ku individi është i

rrënjosur. Ai sfidon idenë liberale të individit si qenie autonome dhe të pavarur, duke theksuar se identiteti personal nuk është produkt i vetëm i zgjedhjes individuale, por formësohet në mënyrë të thellë nga marrëdhëniet sociale, kultura dhe përkatësia komunitare. Sipas kësaj qasjeje komunitariste, individi nuk mund të kuptohet si një “vete e shkëputur”, por si një subjekt i mishëruar në historinë dhe jetën kolektive të komunitetit të tij. Kritika e tij sugjeron se një shpërndarje e drejtë duhet të jetë në përputhje me kuptimin e përbashkët që një komunitet i jep së mirës dhe vlerave që ai përfaqëson. Sakaq, MacIntyre (1981) thekson domosdoshmërinë e traditave morale dhe kuptimit të virtyteve si pjesë përbërëse e jetës komunitare. Kritika komunitariste e MacIntyre thekson se morali nuk mund të mbështetet në parime abstrakte, të ndara nga tradita dhe konteksti shoqëror. Ai e sheh traditën jo si diçka statike apo dogmatike, por si një kornizë dinamike përmes së cilës ndodh debati racional dhe zhvillimi moral. Virtyti, në këtë kuadër, nuk është një koncept universal dhe abstrakt, por përcaktohet brenda komuniteteve dhe praktikave historike konkrete. Edhe pse analiza e tij nuk fokusohet drejtpërdrejt në drejtësinë shpërndarëse, ai e konsideron zhvillimin e karakterit moral si thelbësor për vlerësimin e praktikave dhe institucioneve shoqërore.

Etzioni (1983) paraqet një vizion komunitarist ku të drejtat individuale ruhen brenda një kornize përgjegjësish shoqërore. Ai prezanton idenë e “komunitetit përgjegjës”, një shoqëri që vlerëson si autonominë individuale, ashtu edhe mirëqenien kolektive si dhe kritikon si ndërhyrjen e tepruar të shtetit, ashtu edhe absolutizmin e tregut të lirë. As qeveria qendrore, as tregu i pakufizuar nuk mund të ruajnë lidhjet komunitare apo detyrimet morale. Përkundrazi, institucionet ndërmjetëse si grupet lokale, komunitetet fetare dhe organizatat civile janë thelbësore për të nxitur besimin dhe bashkëpunimin. Më tej, Uysal (2025) argumenton se anëtarët e shoqërisë nuk janë marrës pasivë të traditës, por interpretues aktivë që rinovojnë vazhdimisht vlerat e përbashkëta. Komunitetet mbeten legjitime vetëm nëse sistemet e tyre morale evoluojnë përmes pjesëmarrjes kritike dhe jo bindjes së verbër. Prandaj, kritika “nga brenda” përbën një detyrim moral që parandalon dogmatizmin.

Një kritikë madhore ndaj komunitarizmit është se theksimi i tij mbi vlerat e veçanta të komunitetit çon drejt relativizmit moral, duke minuar çdo standard universal të drejtësisë. Meqë teoritë komunitariste mbështeten në idenë se ajo që është e drejtë përcaktohet nga kuptimet e përbashkëta të çdo

komuniteti, ato rrezikojnë ta bëjnë drejtësinë plotësisht të varur nga konteksti (Jidal, 1997). Për të shmangur relativizmin kulturor, ku çdo komunitet përcakton të mirën e vet, Uysal (2025) argumenton në favor të një procesi dinamik në të cilin korniza të ndryshme morale mund të mësojnë nga njëra-tjetra përmes shkëmbimit ndërkulturor. Ky proces pranon ekzistencën e dallimeve të qëndrueshme midis komuniteteve, por lejon një bisedë morale globale pa e fshirë autenticitetin lokal. Komunitarizmi shpesh supozon se njerëzit ndajnë qëllime shoqërore dhe pikëpamje morale të përbashkëta. Ky idealizim injoron konfliktet reale, interesat konkurruese dhe antagonizmat që ekzistojnë edhe brenda vetë komuniteteve, duke e bërë drejtësinë shpërndarëse komunitariste tepër optimiste dhe të pazbatueshme në shumë kontekste reale (Condlin, 2007). Në vetvete, theksi i komunitarizmit mbi komunitetin dhe vlerat e përbashkëta është kufizues pasi individët shihen si të paaftë për të dalë jashtë kornizës njohëse që u ofron shoqëria e tyre, duke nënvlerësuar autonominë dhe aftësitë kritike të individit (Kymlicka, 1988). Në epokën e globalizimit dhe lëvizjes së lirë, arena globale përbëhet nga shumë komunitete të mbivendosura me vlera të ndryshme. Andaj, në një botë kaq të ndërlikuar, është e vështirë të ofrohet një kornizë e përshtatshme për drejtësinë shpërndarëse. Një teori që lidh drejtësinë vetëm me një komunitet specifik ofron pak udhëzime për zgjidhjen e konflikteve midis komuniteteve të ndryshme ose për garantimin e drejtësisë përtej ndarjeve shoqërore.

2.2 Teoritë e drejtësisë të bazuara në meritë

Teoritë e drejtësisë të bazuara në meritë theksojnë se shpërndarja e drejtë e burimeve apo përfitimeve duhet të bëhet në përputhje me atë që secili individ meriton. Ky koncept përmbledhet shpesh në thënieën: “çdo kujt sipas meritës së tij”. Në traditën e filozofisë klasike, Aristoteli (350 B.C.E) pohon se merita përbën kriterin e vetëm dhe më të përshtatshëm për ndarjen e të mirave. Sipas tij, drejtësia përfaqëson një formë barazie proporcionale, ku pabarazitë në shpërndarje janë të pranueshme vetëm kur pasqyrojnë në mënyrë të drejtë dallimet reale në meritat e individëve.

Teoritë e ndryshme të drejtësisë të bazuara në meritë identifikojnë kritere të ndryshme (baza merite) mbi të cilat përcaktohet se çfarë konsiderohet e merituar. Bazat më të zakonshme të propozuara janë kontributi (Riley, 1989), përpjekja (Milne, 1986) dhe kompensimi (Lamont, 1997). Kontributi përbën një nga bazat themelore mbi të cilat teoritë e drejtësisë të bazuara në meritë

mbështesin shpërndarjen e burimeve. Drejtësia shpërndarëse e bazuar në meritë thekson përgjegjësinë individuale dhe kontributin personal, duke mbështetur idenë se individët duhet të gëzojnë përfitime (ose të mbajnë barra) në përpjesëtim me atë që kanë fituar ose kontribuar përmes veprimeve apo karakterit të tyre. Kjo nënkupton se ata që kontribuojnë më shumë përmes aftësive, talentit ose inovacionit justifikohen të marrin shpërblime më të mëdha. Përpjekja lidhet me sasinë e mundit dhe zellit të investuar, pavarësisht nga rezultati përfundimtar. Edhe në raste kur përpjekja nuk shndërrohet domosdoshmërisht në një rezultat përfundimtar të pëlqyeshëm, vetë fakti i angazhimit dhe përkushtimit përbën një arsye të vlefshme për shpërblim. Ndërsa, kompensimi, mbështetet në idenë se shpërndarja e drejtë duhet të marrë në konsideratë kostot dhe sakrificat me të cilat individët përballen gjatë punës së tyre.

Në filozofinë bashkëkohore, David Miller ka trajtuar gjerësisht nocionin e meritës, duke e identifikuar atë krahas nevojës dhe barazisë si parime themelore të drejtësisë. Në veprën e tij *Principles of Social Justice* (2001), Miller argumenton se drejtësia shpërndarëse në jetën reale është shumëdimensionale dhe kërkon një qasje të integruar që pranon bashkëjetesën e parimeve të shumta. Barazia, nevoja dhe merita bashkëjetojnë si parime udhëzuese, dhe individët kalojnë nga njëri parim tek tjetri në varësi të situatës. Pra, njerëzit nuk zbatojnë një parim të vetëm në çdo situatë. Përkundrazi, gjykimet e tyre varen nga konteksti. Brenda familjeve apo marrëdhënieve të ngushta, parimi i nevojës priret të dominojë. Në vendin e punës, merita është më e rëndësishme, pasi shpërblimet lidhen me përpjekjet dhe performancën. Ndërsa në sferën politike dhe sociale, barazia merr më shumë peshë, veçanërisht në raport me të drejtat dhe mundësitë bazë. Megjithatë, Miller thekson gjithashtu rolin e kontekstit kulturor dhe shoqëror në formësimin e bindjeve mbi drejtësinë. Edhe pse barazia, nevoja dhe merita shfaqen në shoqëri të ndryshme, pësha që u jepet atyre ndryshon nga kultura në kulturë dhe nga institucioni në institucion.

Filozofi Fred Feldman, me veprën e tij *Distributive Justice: Getting What We Deserve from Our Country* (2016), synon të ndërtojë një teori të drejtësisë shpërndarëse të bazuar në meritë, e cila rivalizon teoritë tashmë të konsoliduara të drejtësisë shpërndarëse. Feldman dallon katër koncepte kryesore të meritës dhe zgjedh si më të përshtatshëm konceptin e meritës politike-ekonomike (political economic desert). Ideja kryesore qëndron në faktin se anëtarët e komunitetit meritojnë të mirat thelbësore si siguri, kujdes

shëndetësor, të drejta politike, etj sepse kanë nevoja thelbësore komunitare. Shteti, në rolin e shpërndarësit, ka detyrimin të sigurojë që këto nevoja të përmbushen. Sipas Feldman, drejtësia shpërndarëse e përsosur arrihet atëherë kur çdo qytetar përfiton të mirat politike dhe ekonomike që i takojnë në bazë të nevojave të tij thelbësore, të cilat sigurohen nga shpërndarësi përkatës. Ndonëse Dekker (2016) e cilëson teorinë e Feldman si një alternativë rigorozë dhe të qartë ndaj teorive të tjera të drejtësisë, thekson se kjo teori nuk është realisht një teori e bazuar në meritë në kuptimin klasik të termit. Më shumë sesa një teori e bazuar në meritë, qasja e Feldman afron me teorinë e bazuar në nevojë pasi e vendos theksin tek lulëzimi njerëzor përmes përmbushjes së nevojave, sesa tek merita si gur themeli i drejtësisë shpërndarëse. Sakaq, Mulligan (2018) ofron një teori koherente të shpërndarjes së bazuar në meritë, duke argumentuar se vetëm një meritokraci e mbështetur mbi barazi të fortë të mundësive dhe shpërndarje të drejtë të punëve e të ardhurave ofron një rend shoqëror më të drejtë e më efikas. Sipas tij, meritokracia minimizon pakënaqësitë, përputhet me intuitat popullore mbi drejtësinë, si dhe bashkon drejtësinë dhe efikasitetin ekonomik. Merita shihet si retrospektive, pra individët shpërblehen për përpjekjet, aftësitë dhe kontributet e tyre reale, e jo për potenciale apo pasojat të ardhshme. Në këtë kuadër, punët duhet të ndahen mbi bazën e meritës, duke përjashtuar faktorë të parëndësishëm si raca, gjinia apo lidhjet familjare, ndërsa edhe të ardhurat duhet të pasqyrojnë kontributin real ekonomik të individit.

Teorinë e drejtësisë të bazuar në meritë përballen me sfida të rëndësishme. Një nga problemet më praktike lidhet me përcaktimin e bazës së drejtë të meritës dhe me matjen e saj. Në një ekonomi moderne komplekse është jashtëzakonisht e vështirë të identifikohen dhe të kuantifikohen me saktësi kontributet individuale ose niveli i përpjekjes (Lamont & Favor, 2017). Produktiviteti shpesh është rezultat i punës në grup, i përdorimit të teknologjisë, apo i faktorëve të rastësisë, dhe jo thjesht i punës së një individi të vetëm. Për shembull, kur një ekip prej 10 individësh zhvillon një software, është pothuajse e pamundur të ndahet në mënyrë të drejtë dhe të saktë kontributi i secilit anëtar. Nëse zgjidhet si standard përpjekja, shfaqet një tjetër vështirësi: si duhet të matet përpjekja? Përmes orëve të punës, intensitetit, apo shkallës së vështirësisë së detyrës? Këto janë çështje të ndërlikuara dhe të debatueshme, të cilat tregojnë vështirësitë e aplikimit praktik të teorive të bazuar në meritë.

Kritikat filozofike ndaj meritës shpesh theksojnë ndikimin e fatit dhe rrethanave shoqërore në arritjet e individëve. Teoritë e drejtësisë të mbështetura në meritë përfundojnë duke shpërblyer individët për faktorë që janë moralisht arbitrare ose jashtë kontrollit të tyre. Rawls (1971) argumenton se moralisht, askush nuk i “meriton” talentet e veta të lindura apo prejardhjen familjare, megjithëse këta faktorë kanë një ndikim vendimtar në rezultatet jetësore të individit. Pra, nuk është e drejtë të shpërblehen njerëzit vetëm pse kanë lindur me talente të caktuara ose në familje mbështetëse, pasi këto avantazhe nuk janë të fituara nga vetë individi. Mbështetja e të ardhurave ose pasurisë mbi këto rastësi nuk përbën një parim të qëndrueshëm të drejtësisë.

Në praktikë, parimet e bazuara në meritë nuk e mbulojnë në mënyrë të plotë shpërndarjen e të gjitha burimeve. Ato zakonisht aplikohen mbi të ardhurat që burojnë nga puna, por jo çdo gjë mund të lidhet ngushtësisht me meritën (Lamont & Favor, 2017). Individët me aftësi ndryshe, ose ata që nuk janë në gjendje të punojnë, gjithsesi kanë nevojë për burime dhe mbështetje, ndërkohë që një parim strikt i meritës (i fokusuar vetëm në kontributin ekonomik) do t’u mohonte atyre përfitime të rëndësishme. Ky boshllëk tregon një kufizim të qasjes, sepse vetëm meritës nuk mund t’i besohet të udhëheqë shpërndarjen e kujdesit shëndetësor, të arsimit apo të mbështetjes për fëmijët dhe të moshuarit, pa u plotësuar nga parime të tjera ndihmëse.

2.3 Teoritë e drejtësisë të bazuara në njohje

Teoritë e drejtësisë të bazuara në njohje përfaqësojnë një zhvendosje konceptuale ku drejtësia nuk kufizohet vetëm në dimensionin ekonomik dhe shpërndarjen e pasurive materiale, por lidhet ngushtësisht me nevojën që individët dhe grupet të trajtohen dhe njihen si aktorë të plotë dhe të barabartë në jetën kolektive (Iser, 2019).

Një ndër përfaqësuesit kryesorë të këtyre teorive, Axel Honneth, identifikon tre sfera të ndërlidhura, të domosdoshme si për formësimin e identitetit personal, ashtu edhe për realizimin e drejtësisë. Sfera e parë është dashuria dhe përfaqëson atë që njihet si njohja afektive dhe është thelbësore për zhvillimin e vetëbesimit dhe marrëdhëniet personale. Sfera e dytë është barazia dhe qëndron për njohjen juridike, e cila përfshin të drejta të barabarta përpara ligjit duke garantuar autonominë e individit. Së fundmi, sfera e tretë është vlerësimi shoqëror dhe ka të bëjë me njohjen e arritjeve dhe kontributeve që individët i japin shoqërisë, duke nxitur kështu respektin ndaj

vetes. Secila prej këtyre sferave lidhet me parime të ndryshme të drejtësisë, përkatësisht me nevojën, barazinë dhe meritën (Honneth, 2004). Sipas Honneth, në mënyrë që shoqëritë të arrijnë legjitimitet dhe stabilitet duhet të pranojnë dhe njohin bashkëveprimin e sferave të sipërpërmendura. Në mungesë të tyre, individët përjetojnë mungesë respekti dhe padrejtësi shoqërore. Parë nga ky këndvështrim, teoria e drejtësisë e bazuar në njohje e zgjeron kuadrin e drejtësisë duke përfshirë identitetin dhe statusin si dimensione thelbësore të asaj që u takon individëve në mënyrë të drejtë.

Filozofja dhe teoricienia amerikane Nancy Fraser, thekson nevojën për të integruar rishpërndarjen dhe njohjen në konceptin bashkëkohor të drejtësisë. Në leksionin e saj *Social Justice in the Age of Identity Politics: Redistribution, Recognition, and Participation* (1998) dhe më tej në librin *Redistribution or Recognition* (2003) në bashkëautorësi me Axel Honneth, Fraser identifikon dy paradigma themelore të drejtësisë, atë të rishpërndarjes dhe të njohjes. E para synon të korrigjojë pabarazitë socio-ekonomike që burojnë nga struktura politike dhe ekonomike e shoqërisë, ndërsa e dyta kërkon rishikimin e hierarkive të vlerave, rivlerësimin e identiteteve të nënvlerësuara dhe transformimin e normave që prodhojnë pabarazi. Ajo prezanton konceptin e “kolektiviteteve bivale” (bivalent collectivities), të cilat janë grupe që vuajnë njëkohësisht pabarazi ekonomike dhe mosnjohje kulturore. Në botën reale, shumica e formave të padrejtësisë janë bivale, prandaj kërkojnë një politikë që të kombinojë rishpërndarjen dhe njohjen. Parimi themelor normativ i Fraser është barazia në pjesëmarrje, sipas së cilës, çdo anëtar i shoqërisë duhet të ketë mundësinë të marrë pjesë si i barabartë në jetën sociale. Sipas Fraser, shoqëritë bashkëkohore kanë nevojë për një model dy-dimensional të drejtësisë, i cili i konsideron ekonominë dhe njohjen kulturore si fusha të ndërlidhura por të dallueshme. Sidoqoftë, Swanson (2005) cilëson se ndonëse debati Fraser-Honneth ka ndikuar në teorinë kritike bashkëkohore, riprodhon një dualizëm problematik midis sferës kulturore dhe asaj ekonomike. Ajo e ridimensionon debatin mbi njohjen dhe rishpërndarjen duke shpërbërë ndarjen midis kulturës dhe ekonomisë dhe parashtron një qasje që shqyrton se si njohja dhe rishpërndarja ndërthuren në formësimin e pushtetit, identitetit dhe pabarazisë në kuadër të kapitalizmit neoliberal.

Megjithatë, përkthimi në praktikë i teorive të njohjes paraqet sfida të konsiderueshme. Në ndryshim nga drejtësia shpërndarëse e cila mund të mbështetet në tregues sasiore, njohja është cilësore, gjë që e bën më të vështirë matjen e progresit apo hartimin e politikave. Schweiger (2019) cilëson se

njohja nuk është një burim që mund të shpërndahet me lehtësi si paraja apo mallrat. Ajo buron nga ndërveprimi midis individëve ose midis grupeve dhe institucioneve. Kjo do të thotë se nuk ekziston një matës për mungesën e njohjes në shoqëri, përpos një subjektiviteti të brendshëm në procesin e njohjes. Për më tepër, është shumë e rëndësishme të bëhet fillimisht dallimi midis përvojës së mungesës së njohjes (mosnjohja) dhe përvojës së padrejtësisë, pasi jo çdo formë padrejtësie përfshin një formë mosnjohjeje (Schweiger, 2019). Schweiger argumenton se teoria e njohjes duhet të përfshijë standarde objektive për të përcaktuar se çfarë përbën mosnjohje dhe kur ajo kthehet në padrejtësi, pa u mbështetur vetëm në përjetime subjektive. Sakaq, Knieriem (2024) argumenton se një teori kritike e njohjes nuk mund të shpjegojë njëkohësisht të gjitha konfliktet shoqërore dhe t'i vlerësojë ato moralisht. Sipas Knieriem, një standard moral që bën dallimin midis betejave shoqërore legjitime dhe jolegjitime nuk mund të bëjë dallime brenda betejave për njohje. Përkundrazi, cilësohet se ky standart vetëm dallon betejat e njohjes nga format e tjera të konflikteve. Kështu, teoria e njohjes përballlet me një dilemë thelbësore dhe ka kufij të brendshëm. Së pari, nëse përpiqet të shpjegojë çdo konflikt shoqëror, ajo humbet forcën normative. Së dyti, nëse vendos kritere morale për legjitimitet, ajo kufizon fushën e aplikimit të vet.

Më tej, duhet theksuar se pretendimet për drejtësi të bazuar në njohje duhet të shqyrtohen në mënyrë kritike për të shmangur prirjet e përjashtimit përmes përfshirjes (Gürtler & Herberg, 2023). Kjo do të thotë se ndonjëherë përfshirja e një grupi në një formë të caktuar mund të jetë ende patronizuese, dhe theksimi i tepruar i identitetit të grupit mund të çojë në konkurrencë midis grupeve për njohje dhe në fragmentimin e sferës publike në grupe interesi, gjë që mund të minojë unitetin shoqëror. Aboim (2020) vëren se modelet tradicionale të njohjes kanë tendencën të imponojnë një normë në vend që të njohin diversitetin, që do të thotë se njohja formale mund t'i "ngurtësojë" identitetet në kategori fikse. Në mënyrë të ngjashme, Asenbaum (2021) argumenton se "reifikimi i përhershëm i identiteteve" ua mohon individëve lirinë themelore të vetëshprehjes së shumëllojshme. Me fjalë të tjera, njohja nuk duhet t'i kufizojë njerëzit në kuti identitare statike, duke sakrifikuar kështu autonominë personale dhe ndryshueshmërinë individuale. Përsa i takon fragmentimit, Hobson (2018) vëren se fragmentimi në identitete pengon reagimin kolektiv ndaj përjashtimit, duke vënë në dukje se si ndarjet e brendshme branda komuniteteve të marginalizuara dëmtojnë solidaritetin dhe mobilizimin. Një kornizë drejtësie e fragmentuar në luftëra të izoluara

për njohje mund të dështojë në adresimin e padrejtësive që i tejkalojnë kufijtë e identiteteve të veçanta.

3. Përfundime

Komunitarizmi, teoritë e drejtësisë të bazuara në meritë dhe ato të bazuara në njohje përfaqësojnë tre qasje të rëndësishme dhe plotësuese ndaj konceptit të drejtësisë shpërndarëse. Secila qasje ofron një mënyrë të veçantë të konceptimit të marrëdhënieve midis individit dhe shoqërisë, të mirave dhe vlerave, si dhe të drejtës dhe përgjegjësisë. Komunitarizmi thekson se drejtësia nuk mund të kuptohet jashtë kontekstit moral dhe kulturor të një shoqërie. Për më tepër, drejtësia nuk është një koncept universal, përkundrazi është e lidhur ngushtësisht me mënyrën e jetesës dhe me kuptimet që komunitetet u japin të mirave shoqërore. Nga ana tjetër, teoritë e drejtësisë të bazuara në meritë mbështeten në idenë e përgjegjësisë individuale dhe në parimin moral që shpërblimet duhet të pasqyrojnë përpjekjet dhe kontributet reale të individëve. Ndërkohë, teoritë e drejtësisë të bazuara në njohje e zgjerojnë horizontin moral të drejtësisë, duke theksuar se përfshirja e barabartë, respekti dhe dinjiteti përbëjnë elemente po aq thelbësore sa shpërndarja ekonomike.

Megjithatë, secila teori ka kufizimet përkatëse. Komunitarizmi rrezikon relativizmin moral dhe mbylljen brenda kufijve të traditës. Përsa i takon meritës, një nga problemet më praktike është pasiguria në matje dhe ndikimi i faktorëve të jashtëm. Sakaq, njohja përballet me rrezikun e përjashtimit përmes përfshirjes dhe me rrezikun e fragmentimit identitar. Pavarësisht limitimeve, këto teori kontribuojnë në pasurimin e debatit mbi drejtësinë shpërndarëse, duke e paraqitur këtë të fundit komplekse dhe shumëdimensionale. Për rrjedhojë, një qasje integruese, që bashkon ndjeshmërinë komunitariste, kriterin meritokratik dhe dimensionin e njohjes, mund të ofrojë një kuadër më të plotë për të kuptuar drejtësinë në shoqëritë bashkëkohore dhe për të ndërtuar politika më të ndjeshme ndaj diversitetit, përgjegjësisë dhe dinjitetit njerëzor.

Literatura

- Aboim, S. (2020). Gender in a box? The paradoxes of recognition beyond the gender binary. *Politics and Governance*, 8(3), 231–241.
- Aristotle. (4th century BCE). *Nicomachean ethics* (Book V: Justice; W. D. Ross, Trans., 1999). Batoche Books.
<https://historyofeconomicthought.mcmaster.ca/aristotle/Ethics.pdf>
- Asenbaum, H. (2021). The politics of becoming: Disidentification as radical democratic practice. *European Journal of Social Theory*, 24(1), 86–104.
- Bell, D. (2024). *Communitarianism*. In E. N. Zalta (Ed.), *The Stanford encyclopedia of philosophy*. Stanford University.
<https://plato.stanford.edu/entries/communitarianism/>
- Condlin, R. J. (2007). Bargaining with a hugger: The weaknesses and limitations of a communitarian conception of legal dispute bargaining, or why we can't all just get along. *Cardozo Journal of Conflict Resolution*, 9, 1.
- Dekker, T. J. (2016). Fred Feldman's *Distributive justice: Getting what we deserve from our country*. *Erasmus Journal for Philosophy and Economics*, 9(2), 208–212. <https://doi.org/10.23941/ejpe.v9i2.240>
- Etzioni, A. (1993). *The spirit of community: Rights, responsibilities, and the communitarian agenda*. Crown Publishers.
- Feldman, F. (2016). *Distributive justice: Getting what we deserve from our country*. Oxford University Press.
- Fraser, N. (1998). Social justice in the age of identity politics: Redistribution, recognition and participation. *The Tanner Lectures on Human Values*.
- Fraser, N., & Honneth, A. (2003). *Redistribution or recognition?: A political-philosophical exchange*. Verso.
- Gürtler, K., & Herberg, J. (2023). Moral rifts in the coal phase-out—how mayors shape distributive and recognition-based dimensions of a just transition in Lusatia. *Journal of Environmental Policy & Planning*, 25(2), 194–209.
- Hobson, B. (2018). Revisiting recognition and redistribution and extending the borders: Julia Szalai's contribution. *Intersections: East European Journal of Society and Politics*, 4(1).
- Honneth, A. (2004). Recognition and justice: Outline of a plural theory of justice. *Acta Sociologica*, 47(4), 351–364. <https://www.jstor.org/stable/4195049>
- Iser, M. (2019). *Recognition*. In E. N. Zalta (Ed.), *The Stanford encyclopedia of philosophy*. Stanford University. <https://plato.stanford.edu/entries/recognition/>
- Jindal, B. (1997). Relativism, neutrality, and transcendentalism: Beyond autonomy. *Louisiana Law Review*, 57(4), 1253–1282.
- Knieriem, M. (2024). The limits of recognition. *Inquiry*, 1–36.

- Kymlicka, W. (1988). Liberalism and communitarianism. *Canadian Journal of Philosophy*, 18(2), 181–204.
- Lamont, J. (1997). Incentive income, deserved income, and economic rents. *Journal of Political Philosophy*, 5(1), 26–46.
- Lamont, J., & Favor, C. (2017). *Distributive justice*. In E. N. Zalta (Ed.), *The Stanford encyclopedia of philosophy* (Fall 2017 ed.). Stanford University. <https://plato.stanford.edu/entries/justice-distributive/>
- MacIntyre, A. (1981). *After virtue: A study in moral theory*. University of Notre Dame Press.
- Milne, H. (1986). Desert, effort and equality. *Journal of Applied Philosophy*, 3(2), 235–243.
- Miller, D. (2001). *Principles of social justice*. Harvard University Press.
- Mulligan, T. (2018). *Justice and the meritocratic state*. Routledge.
- Rawls, J. (1971). *A theory of justice*. Harvard University Press.
- Riley, J. (1989). Justice under capitalism. In J. W. Chapman (Ed.), *Markets and justice* (pp. 122–162). New York University Press.
- Sandel, M. (1982). *Liberalism and the limits of justice*. Cambridge University Press.
- Schweiger, G. (2019). Recognition, misrecognition and justice. *Ethics & Global Politics*, 12(4), 1693870. <https://doi.org/10.1080/16544951.2019.1693870>
- Swanson, J. (2005). Recognition and redistribution: Rethinking culture and the economic. *Theory, Culture & Society*, 22(4), 87–118.
- Uysal, Ö. F. (2025). Revisiting communitarianism: Neither liberal nor authoritarian. *Humanities and Social Sciences Communications*, 12(1), 1–9.
- Walzer, M. (1983). *Spheres of justice: A defense of pluralism and equality*. Basic Books.

Përdorimi i rrjeteve sociale dhe ndjeshmëritë digjitale të studentëve: Një vëzhgim eksplorues në një institucion të arsimit të lartë në Shqipëri

Arnisa Mulgeci ^{a,2}, Dhimitri Tole ^a
^a *Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë*

Përmbledhja

Ky studim synon të eksplorojë mënyrën se si studentët e ciklit Bachelor në një institucion të arsimit të lartë në Shqipëri përdorin rrjetet sociale dhe si e perceptojnë ndikimin e tyre në përditshmërinë personale dhe shoqërore. Në këtë kuadër, kërkimi fokusohet në tri fusha kryesore: kohëzgjatjen dhe intensitetin e përdorimit të rrjeteve sociale, platformat më të preferuara dhe qëndrimet e studentëve ndaj validimit social përmes “pëlqimeve” apo komenteve. Studimi mbështetet në një qasje sasiore, përmes një pyetësi online, të përfutur nga një kampion probabilitar me 390 studentë të ciklit Bachelor. Shumica e studentëve përdorin rrjetet sociale për një periudhë kohore të moderuar, kryesisht nga dy deri në katër orë në ditë, me përqendrim të lartë në platformat Instagram, TikTok dhe YouTube. Në lidhje me perceptimin e validimit social, pjesa më e madhe e studentëve nuk e lidhin vetëvlerësimin e tyre me numrin e “pëlqimeve” apo reagimeve që marrin, megjithatë një përqindje më e vogël shfaq ndjeshmëri ndaj miratimit digjital. Këto gjetje tregojnë se, ndonëse rrjetet sociale janë të integruara fort në jetën e përditshme studentore, ato përdoren kryesisht për komunikim dhe informim, më shumë sesa për kërkim të miratimit social. Studimi ofron një panoramë të përgjithshme mbi përvojën digjitale të studentëve shqiptarë, duke nxjerrë në pah rëndësinë e edukimit digjital dhe të ndërgjegjësimit mbi përdorimin e balancuar të mediave sociale. Këto rezultate mund të shërbejnë si bazë për kërkime të mëtejshme dhe për zhvillimin e iniciativave institucionale që promovojnë mirëqenien dhe vetëdijen digjitale në mjediset universitare.

Fjalë kyçe: rrjete sociale; studentë universitarë; validim social; vetëprezantim digjital; përdorim online

² KONTAKT: arnisa.mulgeci@umsh.edu.al

Abstract

This study explores how Bachelor students in a higher education institution in Albania use social media and perceive its influence on their daily personal and social lives. Social networks have become an essential part of modern communication, shaping how individuals interact, share information, and construct their self-image. Within this context, the research focuses on three main areas: the duration and intensity of social media use, the most preferred platforms, and students' attitudes toward social validation through "likes" and online reactions. The study relies on a quantitative approach, through an online questionnaire, obtained from a random sample of 390 Bachelor's degree students from four different faculties. The study relies on a quantitative approach, through an online questionnaire, obtained from a probability sample of 390 Bachelor's degree students. Students use social media for a moderate amount of time—typically between two and four hours per day—with Instagram, TikTok, and YouTube being the dominant platforms. Regarding social validation, the majority of students do not associate their self-esteem with the number of "likes" or reactions they receive, although a smaller portion reported a certain sensitivity to online approval. These results suggest that, while social networks are deeply integrated into students' daily routines, they are primarily used for communication and information rather than for seeking social validation. This study provides an overview of the digital experiences of Albanian university students, emphasizing the importance of digital literacy and awareness for a balanced and conscious use of social media. The findings may serve as a foundation for further research and institutional initiatives promoting digital well-being and media awareness in higher education settings.

Keywords: social networks; university students; social validation; digital self-presentation; online use

1. Hyrje

Në dekadën e fundit, rrjetet sociale janë bërë një pjesë thelbësore e jetës së përditshme dhe kanë ndryshuar mënyrën se si individët komunikojnë, informohen dhe ndërtojnë identitetin e tyre personal. Përdorimi masiv i platformave si Instagram, TikTok, YouTube dhe Facebook ka krijuar një hapësirë të re ndërveprimi ku të rinjtë shprehin veten, krijojnë lidhje dhe marrin pjesë në diskutime të gjera shoqërore (Smith & Anderson, 2018; Kircaburun & Griffiths, 2019). Kjo prani e gjerë digjitale ka bërë që rrjetet

sociale të shihen jo vetëm si mjete komunikimi, por edhe si një mjedis i dytë i socializimit, që ndikon në mënyrën se si individët perceptojnë veten dhe të tjerët (Reinecke & Trepte, 2014; Boyd & Ellison, 2007).

Në kontekstin e brezit të ri, veçanërisht tek studentët universitarë, rrjetet sociale përfaqësojnë një komponent qendror të jetës sociale dhe akademike. Përmes tyre, të rinjtë jo vetëm ndërveprojnë me bashkëmoshatarët, por gjithashtu ndërtojnë një imazh të vetvetes dhe kërkojnë miratim social (Festinger, 1954; Andreassen et al., 2017). Megjithatë, dinamika e këtij ndërveprimi nuk është gjithmonë neutrale: ajo shpesh përfshin presione për përputhje me standardet sociale, krahasime të vazhdueshme dhe varësi nga reagimet digjitale, si “pëlqimet” apo komentet.

Në Shqipëri, studimet mbi ndikimin e rrjeteve sociale në sjelljen dhe mirëqenien e të rinjve janë ende të kufizuara. Shumica e kërkimeve ekzistuese kanë natyrë përshkruese dhe fokusohen më shumë në përdorimin teknologjik sesa në dimensionet psikologjike apo shoqërore të këtij fenomeni (Rama, 2021; Leka & Hoxha, 2020). Në këtë kuadër, lind nevoja për studime që analizojnë më thellë përvojën digjitale të studentëve shqiptarë, jo vetëm në aspektin e përdorimit të rrjeteve sociale, por edhe në mënyrën se si ky përdorim ndikon në ndjeshmëritë e tyre shoqërore dhe perceptimet vetjake.

Ky studim, me temë “Përdorimi i rrjeteve sociale dhe ndjeshmëritë digjitale të studentëve: Një vëzhgim eksplorues në një institucion të arsimit të lartë në Shqipëri”, synon të ofrojë një panoramë të përgjithshme të mënyrës se si studentët Bachelor përfshihen në aktivitetet digjitale, cilat platforma përdorin më shumë dhe si e perceptojnë ndikimin e tyre në përditshmëri. Përmes një qasjeje sasimore, studimi analizon sjelljet tipike të përdorimit, qëndrimet ndaj validimit social dhe ndjeshmërinë ndaj perceptimit publik, me qëllim identifikimin e disa prirjeve që karakterizojnë përdoruesit e rinj të rrjeteve sociale në Shqipëri.

Ky kërkim nuk ka për qëllim të arrijë në përfundime përfundimtare rreth ndikimit psikologjik të rrjeteve sociale, por të hedhë dritë mbi disa modele të përdorimit dhe perceptimit të tyre. Gjetjet e këtij studimi pritet të shërbejnë si bazë për kërkime të ardhshme më të specializuara dhe për iniciativat institucionale që synojnë përdorimin e ndërgjegjshëm dhe të ekuilibruar të mediave digjitale në mjediset universitare.

2. Rishikimi i literaturës

Rrjetet sociale si fenomen shoqëror

Rrjetet sociale janë bërë një nga elementet më të rëndësishme të komunikimit modern, duke ndikuar thellësisht në mënyrën se si individët ndërveprojnë dhe ndërtojnë marrëdhënie shoqërore. Ato përkufizohen si platforma që mundësojnë krijimin e profileve personale, ndarjen e përmbajtjeve dhe ndërlidhjen me të tjerë nëpërmjet strukturave të rrjetëzuara (Boyd & Ellison, 2007). Me kalimin e kohës, këto platforma kanë kaluar nga mjete të thjeshta komunikimi në hapësira shumëdimensionale të ndërveprimit dhe vetëprezantimit (Kaplan & Haenlein, 2010).

Zhvillimi i Web 2.0 shënoi një kthesë të rëndësishme, duke e bërë përdoruesin jo më një konsumator pasiv të informacionit, por një krijues aktiv të përmbajtjes (O'Reilly, 2005). Kjo ka ndikuar në transformimin e mënyrës se si të rinjtë perceptojnë botën dhe veten, pasi realiteti virtual është bërë një zgjatim i jetës së përditshme dhe një pjesë integrale e identitetit personal dhe social.

Vetëprezantimi dhe validimi social në mjediset digjitale

Një ndër aspektet më të studiuara të sjelljes digjitale është mënyra se si individët e paraqesin veten në rrjetet sociale. Përmes përmbajtjeve të publikuara, fotografive, reagimeve dhe ndërveprimeve, përdoruesit ndërtojnë një imazh të vetvetes që shpesh synon të jetë i përshtatur me pritshmëritë dhe standardet e grupit social (Reinecke & Trepte, 2014). Ky proces shoqërohet shpesh me kërkimin e validimit social – nevoja për të marrë pëlqime, komente ose reagime pozitive si shenjë e pranimit nga të tjerët (Festinger, 1954; Andreassen et al., 2017).

Validimi social është bërë një formë e re e matjes së vlerës personale, ku miratimi digjital fiton kuptime simbolike që ndikojnë në perceptimin e vetvetes (Barry et al., 2017). Për shumë përdorues të rinj, ndjesia e miratimit nga të tjerët mund të shndërrohet në një burim motivimi apo presioni, duke ndikuar në mënyrën se si ndërtojnë marrëdhëniet dhe vetëbesimin në mjediset virtuale.

Krahasimi social dhe ndikimi i perceptimit publik

Krahasimi social është një tjetër proces kyç në kuptimin e dinamikave të rrjeteve sociale. Sipas teorisë klasike të Festinger (1954), individët kanë prirje

natyrore të krahasojnë veten me të tjerët për të vlerësuar statusin, aftësitë dhe arritjet e tyre. Në rrjetet sociale, ky proces është thelluar për shkak të natyrës vizuale dhe të kurrar të përmbajtjes, ku përdoruesit shpesh ekspozojnë versionet më pozitive dhe të filtruar të realitetit të tyre.

Studimet tregojnë se përdoruesit që janë më të orientuar drejt krahasimit social, sidomos në platformat vizuale si Instagram, përjetojnë më shumë presion nga perceptimi publik dhe ndjeshmëri ndaj vlerësimit të të tjerëve (Lee, 2021). Po ashtu, kërkimet e Kircaburun dhe Griffiths (2019) theksojnë se përdorimi i shpeshtë i rrjeteve sociale lidhet me nevojën për pranim publik dhe vetëvlerësim të kushtëzuar. Vogel et al. (2014) shtojnë se ekspozimi i vazhdueshëm ndaj përmbajtjeve të kurrara mund të ndikojë në perceptimin e suksesit personal dhe të krijojë ndjesi të shtuar krahasimi.

Perspektiva shqiptare dhe boshllëqet kërkimore

Në kontekstin shqiptar, fenomeni i rrjeteve sociale është studiuar kryesisht nga këndvështrimi i komunikimit dhe përdorimit teknologjik, ndërsa dimensionet psikologjike dhe sociale të tij mbeten më pak të eksploruara. Sipas studimeve të Rama (2021) dhe Leka & Hoxha (2020), përdorimi i rrjeteve sociale ndër të rinjtë shqiptarë është i përhapur gjerësisht, por mënyra se si ky përdorim ndikon në perceptimet dhe sjelljet e tyre mbetet e paqartë.

Kjo tregon për nevojën e zhvillimit të kërkimeve që analizojnë rrjetet sociale si një mjedis kompleks ndërveprimi dhe vetëprezantimi, ku përfshirja digjitale, validimi social dhe krahasimi publik janë fenomene që formësojnë përditshmërinë e studentëve. Ky dimension kërkimor hap rrugë për analiza të reja që fokusohen jo vetëm në pasojat, por edhe në kuptimin social të përvojës digjitale dhe marrëdhënieve që ajo krijon në mjediset universitare.

3. Metodologjia

Qasja kërkimore

Studimi është realizuar përmes një qasjeje sasiore me natyrë përshkruese dhe korrelative, me qëllim eksplorimin e mënyrës se si studentët e ciklit Bachelor ndërveprojnë me rrjetet sociale dhe perceptojnë ndikimin e tyre në përditshmëri. Kjo qasje është përzgjedhur pasi lejon mbledhjen e të dhënave të strukturuar mbi sjelljet digjitale dhe marrëdhëniet midis variablave që lidhen me përfshirjen dhe validimin social. Kërkimi është zhvilluar në një institucion të arsimit të lartë në Shqipëri gjatë periudhës maj–qershor 2025.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi kryesor i kërkimit ishte të vlerësonte prirjet e përdorimit të rrjeteve sociale dhe perceptimet që studentët kanë për ndikimin e tyre në jetën e përditshme. Objektivat përfshijnë:

- Identifikimin e kohës së përfshirjes ditore në rrjetet sociale.
- Analizimin e varësisë ndaj validimit social përmes reagimeve digjitale (“pëlqimeve”).
- Vlerësimin e ndjeshmërisë ndaj perceptimit dhe gjykit publik në mjediset virtuale.
- Krahasimin e tendencave sipas faktorëve demografikë si gjinia, moshë dhe fakulteti.

Pjesëmarrësit dhe kampioni

Në studim morën pjesë 390 studentë të ciklit Bachelor nga katër fakultete të ndryshme të institucionit. Kampioni përfaqësonte rreth 18% të popullsisë totale studentore. Pjesëmarrësit ishin të përfshirë në mënyrë vullnetare dhe anonime, dhe të dhënat u mbledhën përmes një ankete elektronike të shpërndarë nëpërmjet adresave institucionale të email-it. Pas procesit të pastrimit të të dhënave, u siguroi një kampion i balancuar gjinor dhe fakultetesh, përmes poststratifikimit statistikor.

Instrumenti dhe mbledhja e të dhënave

Instrumenti kërkimor përbëhej nga një pyetësor me pyetje të strukturuar me alternativa të mbyllura. Ai përfshinte tre seksione kryesore:

- Seksioni I: Të dhëna demografike (gjinia, moshë, fakulteti).
- Seksioni II: Përdorimi i rrjeteve sociale (koha ditore, numri i platformave, platforma e preferuar).
- Seksioni III: Perceptime dhe sjellje digjitale (validimi social, krahasimi me të tjerët, ndikimi i mendimit publik).

Pyetjet e seksionit të tretë janë përshtatur nga studime ndërkombëtare mbi përdorimin e rrjeteve sociale dhe ndjeshmërinë ndaj perceptimit social (Anto et al., 2023; Lee, 2021). Para shpërndarjes përfundimtare, pyetësori iu

nënshtrua një testimi pilot me 30 studentë për të vlerësuar qartësinë dhe kuptueshmërinë e tij.

Përpunimi i të dhënave

Të dhënat e mbledhura u analizuan përmes programit IBM SPSS Statistics. U aplikuan analiza përshkruese për të vlerësuar shpërndarjen e përgjigjeve sipas variablave demografikë dhe digjitalë. Gjithashtu, u përdorën tabela krahasuese dhe analiza korrelative për të identifikuar prirje të përgjithshme dhe marrëdhënie të mundshme midis faktorëve të përfshirjes dhe perceptimeve sociale.

Pjesëmarrja në studim ishte plotësisht vullnetare dhe anonime. Studentët u informuan paraprakisht për qëllimin e kërkimit dhe përdorimin shkencor të të dhënave. Nuk u kërkua asnjë informacion personal identifikues dhe të gjitha përgjigjet u ruajtën në përputhje me standardet e etikës kërkimore të institucionit.

Studimi kufizohet nga natyra ndërprerëse e dizajnit (cross-sectional), që nuk lejon vlerësimin e ndryshimeve në kohë, si dhe nga përdorimi i vetë-raportimit, i cili mund të ndikohet nga perceptimi subjektiv i pjesëmarrësve. Megjithatë, të dhënat ofrojnë një panoramë të vlefshme për kuptimin e sjelljeve dhe perceptimeve digjitale të studentëve shqiptarë.

4. Analiza statistikore


Ky kapitull paraqet rezultatet kryesore të analizës statistikore mbi marrëdhënien midis përdorimit të rrjeteve sociale dhe simptomave të ankthit tek 390 studentë të ciklit Bachelor në një institucion të arsimit të lartë në Shqipëri. Analiza përfshiu të dhëna demografike, mënyrën e përdorimit të rrjeteve sociale, perceptimet ndaj validimit social dhe krahasimit me të tjerët.

Prirjet e përdorimit të rrjeteve sociale

Rezultatet e studimit tregojnë se studentët janë përdorues aktivë dhe të rregullt të rrjeteve sociale, me përfshirje të gjerë në platforma të ndryshme. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit (98%) raportuan se përdorin të paktën një rrjet social çdo ditë. Pjesa më e madhe e studentëve (rreth 56%) deklaruan se kalojnë nga dy deri në katër orë në ditë në rrjetet sociale, ndërsa 24% kalojnë mbi pesë orë në ditë. Kjo tregon një nivel të lartë të angazhimit digjital, tipik për moshat universitare.

Sa i përket platformës më të përdorur, Instagram rezultoi më dominues (rreth 43.2% e studentëve), ndjekur nga TikTok (33.6%) dhe YouTube (18.8%). Facebook dhe platforma të tjera kishin përdorim më të kufizuar, veçanërisht në grupmoshat më të reja. Këto të dhëna përputhen me trendet ndërkombëtare të zhvendosjes drejt platformave vizuale dhe të orientuara drejt përmbajtjeve të shkurtra.


Figura 1. Platforma më e përdorur nga studentët



Kohëzgjatja dhe intensiteti i përfshirjes digjitale

Analiza e të dhënave mbi kohëzgjatjen ditore të përdorimit të rrjeteve sociale tregon se studentët shpenzojnë një pjesë të konsiderueshme të ditës në këto platforma. Sipas rezultateve, 33.7% e studentëve i përdorin rrjetet sociale për më pak se dy orë në ditë, 40.3% kalojnë nga dy deri në më pak se katër orë, ndërsa 26% raportojnë përdorim mbi katër orë në ditë.

Kjo shpërndarje tregon se pjesa më e madhe e studentëve janë përdorues aktivë, por jo në nivele të tepruara, duke reflektuar një përfshirje të moderuar dhe të zakonshme në jetën e tyre të përditshme.


Figura 2. Koha mesatare ditore e përdorimit të rrjeteve sociale

4.3 Integrimi i rrjeteve sociale dhe validimi social

Një aspekt i rëndësishëm i studimit lidhet me mënyrën se si studentët e perceptojnë ndikimin e reagimeve sociale në rrjetet ku janë aktivë. Pyetja e përfshirë në këtë pjesë të anketës synonte të vlerësonte nëse “pëlqimet” (Like-t) ndikojnë në vetëvlerësimin dhe mirëqenien emocionale të tyre.

Sipas rezultateve, 45.1% e studentëve nuk janë aspak dakord me idenë se “pëlqimet” i bëjnë të ndihen më mirë me veten, ndërsa 16.9% janë gjithashtu në kundërshti. Rreth 20.6% mbajnë një qëndrim neutral, ndërsa vetëm 11% janë dakord dhe 6.4% plotësisht dakord me këtë deklaratë.

Kjo shpërndarje tregon se shumica e studentëve nuk e lidhin vetëvlerësimin e tyre me reagimet që marrin në rrjetet sociale, megjithatë një përqindje e vogël e përdoruesve përjeton ndikim emocional pozitiv nga miratimi digjital. Ky rezultat përforcon idenë se përdorimi i rrjeteve sociale në këtë grup mbetet më tepër shoqëror dhe komunikues sesa varësor.

Figura 3. Vlerësimi i ndikimit emocional të “Like”-ve në vetëvlerësim

5. Përfundime

Studimi mbi përdorimin e rrjeteve sociale nga studentët e ciklit Bachelor në një institucion të arsimit të lartë në Shqipëri tregon qartë se platformat digjitale janë bërë një komponent i pandashëm i jetës së përditshme studentore. Përdorimi i tyre është i përhapur në të gjitha fakultetet dhe grupmoshat, duke reflektuar rolin e rrjeteve sociale si mjet komunikimi, informimi dhe vetëprezantimi.

Të dhënat tregojnë se shumica e studentëve i përdorin rrjetet sociale nga dy deri në katër orë në ditë, ndërsa një pjesë më e vogël kalon më shumë se katër orë. Kjo tregon për një nivel të moderuar përfshirjeje, ku rrjetet sociale janë të pranishme në rutinën e përditshme, por jo domosdoshmërisht në mënyrë të tepruar. Përdorimi i tyre shpesh lidhet me kërkimin e informacionit, ndarjen e përmbajtjeve personale, argëtimin dhe ruajtjen e kontakteve shoqërore.

Një tjetër gjetje me interes lidhet me perceptimet e studentëve për validimin social dhe ndikimin e reagimeve online. Rezultatet tregojnë se shumica e pjesëmarrësve nuk e lidhin mirëqenien apo vetëvlerësimin e tyre me pëlqimet (“like”-t) apo komentet që marrin në rrjete, duke reflektuar një marrëdhënie të shëndetshme me hapësirën digjitale. Megjithatë, një pjesë më

e vogël e studentëve pranon se ndihen më mirë emocionalisht kur marrin reagime pozitive, gjë që sugjeron se për disa individë miratimi virtual mund të ketë një ndikim të moderuar në përjetimin personal.

Këto gjetje tregojnë se përdorimi i rrjeteve sociale në mjedisin universitar shqiptar është një fenomen kompleks, që ndërthur aspektet funksionale të komunikimit me elementë emocionale të perceptimit social. Studentët shqiptarë duken të vetëdijshëm për ndikimet e këtyre platformave dhe arrijnë të ruajnë një raport relativisht të ekuilibruar midis përfshirjes online dhe jetës reale.

Në një kuptim më të gjerë, rezultatet e këtij studimi nënvizojnë rëndësinë e zhvillimit të kompetencave digjitale dhe të edukimit mediatic në nivel universitar. Promovimi i një përdorimi të ndërgjegjshëm të rrjeteve sociale mund të ndihmojë studentët të shfrytëzojnë potencialin e tyre pozitiv – si mjet bashkëpunimi, informimi dhe zhvillimi profesional – duke minimizuar në të njëjtën kohë ndikimet e padëshiruara që lidhen me krahasimin shoqëror dhe varësinë nga miratimi online.

Në përfundim, rrjetet sociale mbeten një pjesë integrale e përvojës studentore moderne. Sfida që qëndron përpara institucioneve arsimore dhe vetë studentëve është gjetja e ekuilibrit midis shfrytëzimit të mundësive që ofron teknologjia dhe ruajtjes së mirëqenies personale e akademike. Ky studim kontribuon në kuptimin e këtyre dinamikave në kontekstin shqiptar dhe hap rrugën për kërkime të mëtejshme mbi mënyrat se si përdorimi i ndërgjegjshëm i mediave sociale mund të mbështesë zhvillimin e një gjenerate më të qëndrueshme, kritike dhe të shëndetshme digjitalisht.

Literatura

- Andreassen, C. S., Pallesen, S., & Griffiths, M. D. (2017). The relationship between addictive use of social media, narcissism, and self-esteem: Findings from a large national survey. *Personality and Individual Differences, 133*, 40–43. <https://doi.org/10.1016/j.paid.2016.10.048>
- Barry, C. T., Sidoti, C. L., Briggs, S. M., Reiter, S. R., & Lindsey, R. A. (2017). Adolescent social media use and mental health: The good, the bad, and the ugly. *Journal of Adolescence, 61*, 1–8. <https://doi.org/10.1016/j.adolescence.2017.08.005>
- Boyd, D. M., & Ellison, N. B. (2007). Social network sites: Definition, history, and scholarship. *Journal of Computer-Mediated Communication, 13*(1), 210–230. <https://doi.org/10.1111/j.1083-6101.2007.00393.x>

- Festinger, L. (1954). A theory of social comparison processes. *Human Relations*, 7(2), 117–140. <https://doi.org/10.1177/001872675400700202>
- Kaplan, A. M., & Haenlein, M. (2010). Users of the world, unite! The challenges and opportunities of social media. *Business Horizons*, 53(1), 59–68. <https://doi.org/10.1016/j.bushor.2009.09.003>
- Kircaburun, K., & Griffiths, M. D. (2019). Instagram addiction and the Big Five of personality: The mediating role of self-liking. *Journal of Behavioral Addictions*, 8(2), 335–342. <https://doi.org/10.1556/2006.8.2019.14>
- Lee, S. Y. (2021). Exploring the role of social comparison on Instagram: The effect of comparison orientation on psychological well-being. *Computers in Human Behavior*, 122, 106853. <https://doi.org/10.1016/j.chb.2021.106853>
- Leka, A., & Hoxha, L. (2020). Përdorimi i rrjeteve sociale dhe ndikimi i tyre në shëndetin mendor të studentëve shqiptarë. *Revista Shqiptare e Psikologjisë*, 8(2), 45–60.
- O'Reilly, T. (2005). What is Web 2.0? Design patterns and business models for the next generation of software. *O'Reilly Media*. <https://www.oreilly.com/pub/a/web2/archive/what-is-web-20.html>
- Rama, M. (2021). Rrjetet sociale dhe mirëqenia psikologjike e të rinjve shqiptarë: Një analizë deskriptive. *Studime Shoqërore*, 15(3), 77–91.
- Reinecke, L., & Trepte, S. (2014). Authenticity and well-being on social network sites: A two-wave longitudinal study on the effects of online self-presentation. *Cyberpsychology, Behavior, and Social Networking*, 17(6), 430–435. <https://doi.org/10.1089/cyber.2013.0496>
- Smith, A., & Anderson, M. (2018). *Social media use in 2018*. Pew Research Center. <https://www.pewresearch.org/internet/2018/03/01/social-media-use-in-2018>
- Vogel, E. A., Rose, J. P., Roberts, L. R., & Eckles, K. (2014). Social comparison, social media, and self-esteem. *Psychology of Popular Media Culture*, 3(4), 206–222. <https://doi.org/10.1037/ppm0000047>

Kujdesi për të moshuarit në Francë e Shqipëri: Mësimet e perspektiva

Kladiola Gjini ^{a,3}

^a *Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë*
Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'
Elbasan, Shqipëri

Përmbledhja

Ky punim analizon dallimet në Francë dhe Shqipëri, midis kujdesit spitalor dhe kujdesit në shtëpi për të moshuarit, duke vlerësuar përfitimet, kufizimet dhe implikimet socio-ekonomike të secilit model. Franca ka një strukturë të konsoliduar shërbimesh, me programe të profesionalizuara të kujdesit në shtëpi dhe mekanizma financiarë që synojnë të ulin ngarkesën mbi familjet dhe spitalet. Në Shqipëri, kujdesi mbetet kryesisht i mbështetur te familja, me kapacitete të kufizuara institucionale dhe me mbështetje të fragmentuar për kujdesin afatgjatë. Përmes një krahasimi të strukturës së shërbimeve, financimit, rolit të kujdesit informal dhe politikave sociale, studimi identifikon mësimet të vlefshme për përmirësimin e kujdesit afatgjatë. Punimi synon të kontribuojë në diskutimin mbi reforma të mundshme, duke nxjerrë në pah praktikatat e mira franceze dhe mënyrat se si ato mund të përshtaten në kontekstin shqiptar.

Fjalë kyçe: kujdes spitalor; kujdes në shtëpi; të moshuarit; Franca; Shqipëria

Abstract

In this paper we analyse differences in France and Albania in hospital and home care for elderly, by estimating benefits, limitations and socio-economic implications of each model. France has a consolidated service structure, with professional home-care programs and financial mechanisms which tend to reduce the burden on families and hospitals. In Albania, care relies primarily on families with limited institutional capacity and fragmented support for long-term care. Through a comparison of service structures, financing, the role of informal care, and social policies, the study

³ KONTAKT: kladiola.gjini@uniel.edu.al

identifies valuable lessons for improving long-term care. The paper aims to contribute to the discussion on potential reforms by highlighting good practices from France and exploring how they may be adapted to the Albanian context.

Keywords: hospital care; home care; elderly; France; Albania

1. Hyrje

Franca dhe Shqipëria paraqesin dy pamje krejt të ndryshme për kujdesin e të moshuarve në shtëpi dhe spital. Shërbimet në Francë janë të mirë-përcaktuara dhe synojnë t'i mbajnë pacientët e moshuar larg spitalit kur është e mundur dhe e sigurtë: pasi ata kanë një sektor të gjërë e të mirë-koordinuar kujdesi spitalor në shtëpi '*hospital at home*' (HaH), shërbime mbështetëse dhe të integruara. Të gjitha këto janë të mundura falë financimit publik dhe një force punëtore të konsiderueshme e cila merret me kujdesin afat-gjatë.

Ndryshe paraqitet situata në Shqipëri, ku sistemi mbetet i mbështetur tek familja dhe politikat për kujdesin shëndetësor janë ende në zhvillim. Më së shumti kujdesi i përditshëm dhe afatgjatë kryhet nga bashkëshortët, fëmijët ose të afërm të tjerë, ku fondet publike dhe shërbimet sociale janë të limituara në mbulim e kapacitete. Shërbimet institucionale të përqëndruara më shumë në qytetet e mëdha, mungesa në punonjës dhe pagesa të ulëta e pengojnë zgjerimin e shërbimit si dhe nuk mundësojnë krijimin e alternativave të tjera formale ndaj kujdesit spitalor.

Në Francë edhe pse shumë sfida mbesin për t'u përballuar, HaH dhe infrastruktura të kujdesit në shtëpi, ulin disa pranime në spital dhe mbështesin daljet nga spitali, duke vazhduar ndjekjen në shtëpi (Rossinot et al., 2019).

Në Shqipëri, mungesa e mbështetjes klinike për kujdesin në shtëpi si dhe mungesa e shërbimeve sociale shpesh herë e bëjnë shtrimin në spital të vetmen alternativë për kujdes shëndetsor të specializuar.

2. Rishikimi i literaturës

Brisku (2023) paraqet se institucioni i parë shtetëror ose shtëpia e parë për të moshuar në Shqipëri është krijuar në vitin 1940 në Shkodër. Kërkimi i bazuar në arkiva, tregon se ky institucion u krijua si një ndërhyrje minimale publike, i cili manaxhohej nga Kruqi i Kuq me financim nga taksa të dedikuara dhe

duke synuar vetëm njerëzit e varfër dhe të izoluar. Kjo iniciativë e hershme reflekton varësinë e Shqipërisë në familjen për kujdesin shëndetësor, dhe paraqet përpjekjen e parë të shtetit për të institucionalizuar kujdesin social ndaj të moshuarve.

Në Shqipëri, shërbimet sociale për të moshuarit organizohen sipas standardeve të miratuara dhe ofrohen përmes tre llojeve kryesore: kujdesi rezidencial, qendrat ditore dhe ndihma në shtëpi (Shërbimi Social Shtetëror, 2025). Shërbimet e kujdesit rezidencial janë të disponueshme për individët që kanë arritur moshën e pensionit, marrin një pension minimal ose social, nuk zotërojnë banesë apo llogari bankare, dhe janë verifikuar si të vetmuar ose të braktisur nga punonjësit socialë lokalë. Ndërsa, shërbimet e qendrës ditore ofrohen për të moshuarit e moshës së pensionit që marrin një pension minimal ose social dhe janë konfirmuar si të vetmuar ose të braktisur nga Njësia Lokale për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin e Rastit.

Përsa i takon ndihmës në shtëpi, sistemi i kujdesit social për të moshuarit përfshin aktualisht institucione rezidenciale publike dhe jo-publike, të cilat ndodhen në Tiranë, Shkodër, Kavajë, Fier, Gjirokastër dhe Poliçan. Qendrat ditore publike përfshijnë Qendrën Multifunkionale Ditore në Kamëz dhe Qendrën Multifunkionale Ditore në Sarandë.

Franca ka një sistem të zhvilluar të kujdesit shëndetësor me një gamë më të gjerë shërbimesh për të moshuarit. Kujdesi në shtëpi është i mirë-integruar në sistemin shëndetësor, me shërbime të ofruara nga profesionistë të shëndetit dhe të mbështetura nga skemat publike të sigurimit.

Kuadri ligjor francez daton që nga vitet 1970, dhe reforma e vitit 1991 njohu zyrtarisht HaH si një alternativë ndaj kujdesit spitalor tradicional. Programet e para u prezantuan në vitin 1961 si në Paris ashtu edhe në Bayonne në Pirenejt Atlantikë.

Këto iniciativa të hershme u krijuan fillimisht për t'u mundësuar pacientëve me kancer në fazën terminale të marrin kujdesin në fund të jetës në shtëpitë e tyre.

Pra edhe pse HaH ka qenë pjesë e sistemit shëndetësor francez për shumë vite, vizibiliteti dhe përdorimi i tij janë rritur ndjeshëm gjatë dy dekadave të fundit (Rossinot et al., 2019). Brenda sistemit shëndetësor francez, ai përfaqëson një alternativë më ekonomike ndaj kujdesit tradicional spitalor, me një kosto mesatare ditore prej rreth 198 €; kjo tregon se kujdesi në shtëpi në Francë është ekonomikisht efikas, me kosto më të ulëta dhe rezultate më

të mira krahasuar me hospitalizimin për disa gjendje të caktuara (Rossinot et al., 2019).

Për më tepër, HaH është përshkruar si forma më e avancuar e kujdesit mjekësor të ofruar në mjedis shtëpiak, e karakterizuar nga vizita dhe trajtime të rregullta dhe të vazhdueshme çdo ditë (Leff & Montalto, 2004).

Megjithatë, pavarësisht këtij potenciali, zbatimi i HaH nuk është i njëjtë në të gjithë territorin, pasi në zonat më pak të dendura ose rurale mbeten të pazhvilluara për shkak të vështirësive në mbullimin e vizitave në shtëpi dhe ngarkesave të larta logjistike (Terrade et al., 2012) (Rossinot et al., 2019).

Edhe në zonat ku shërbimet HaH janë të zhvilluara dhe të aksesueshme, sfidat nuk kufizohen vetëm te aspektet organizative. Një tjetër kufizim lidhet me për zgjedhjen e pacientëve dhe rrezikun e rikthimit në spital. Studimet mbi pacientët e moshuar që marrin HaH në Francë tregojnë se disa faktorë klinikë dhe kontekstualë rrisin mundësinë e rikthimit brenda 30 ditësh, që nënkupton se, pavarësisht potencialit të tij, ky model nuk është i përshtatshëm për të gjithë pacientët dhe kërkon kritere të kujdesshme përfshirjeje (de Stampa, et al., 2023).

Disa elementë të tranzicionit nga spitali në shtëpi për të moshuarit mbeten të pamjaftueshëm dhe konsiderohen si pikë e dobët për vazhdimësinë e kujdesit. Në shumë raste, mjekët e përgjithshëm nuk marrin në kohë përmbledhjet e daljes nga spitali në kohë, duke krijuar boshllëqe në komunikim dhe duke vështirësuar koordinimin pasues të trajtimit (Hurtaud, et al., 2020).

Në një kuptim më të gjerë, sfidat për të siguruar kalime të qeta midis spitalit, HaH, kujdesit ambulator dhe shërbimeve sociale mbeten të rëndësishme. Së fundi, financimi dhe qëndrueshmëria paraqesin kufizime. Edhe pse HaH rimbursohet nga sigurimet shëndetësore kombëtare, presionet buxhetore i detyrojnë ofruesit dhe rajonet të balancojnë uljen e kostove me cilësinë. Disa iniciativa mbeten në fazë pilot ose të kufizuara rajonalisht, në vend që të shtrihen gjerësisht.

Gjithashtu, financimi publik për kujdesin afatgjatë dhe shërbimet sociale për të moshuarit është më pak i integruar në buxhetet e shëndetësisë, gjë që e vështirëson ofrimin e një kujdesi gjithëpërfshirës për të moshuarit me sëmundje kronike ose paafësi.

Mungesa e një vizioni të integruar të shpenzimeve për të moshuarit e vështirëson planifikimin dhe vlerësimin (Bajeux et al., 2021).

3. Metodologjia

Në këtë punim, metodologjia është bazuar në rishikimin e literaturës, duke u mbështetur plotësisht në burime dytësore. Analiza është ndërtuar mbi artikuj shkencorë të publikuar, raporte institucionale, dokumente politike dhe studime ndërkombëtare që trajtojnë kujdesin për të moshuarit, si në shtëpi ashtu edhe në spital, në Francë dhe Shqipëri. Kjo metodë mundëson paraqitjen e rezultateve ekzistuese kërkimore, identifikimin e modeleve të përbashkëta dhe të dallimeve strukturore ndërmjet dy vendeve, si dhe ndërtimin e një krahasimi të bazuar në artikuj të publikuar.

Duke përdorur vetëm të dhëna të publike, rishikimi i literaturës ofron një panoramë të gjerë dhe të argumentuar mbi zhvillimet, sfidat dhe praktikatat e kujdesit për të moshuarit në të dy kontekstet.


4. Rezultatet

4.1 Shqipëri- dimensionin ekonomik i një sistemi të fragmentuar dhe të varur nga familja

Shqipëria, një vend i Europës Jug-lindore ka një sistem shëndetsor akoma në tranzicion, mbetet akoma e varur në sistemin shëndetësor të ofruar nga shteti. Organizimi i strukturës shëndetësore bëhet në tre nivele: parësor, dytësor dhe terciar.

Që prej vitit 1990, sektori ka pësuar reforma të ndryshme, duke përfshirë legalizimin e ofruesve privatë, decentralizimin e menaxhimit të kujdesit parësor, privatizimin e plotë të farmacive dhe dentistëve, si dhe themelimin e Institutit të Sigurimeve Shëndetësore.

Krahas këtyre reformave, sistemi mbetet i nënfinancuar dhe i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë, ku shërbimet shëndetësore private mbeten të përqëndruara kryesisht në qendrat e mëdha urbane (Gabrani et al., 2020).

Figura 1. Popullsia sipas grupmohave në Shqipëri

Burimi: UN, World Population

Në Figurën 1 paraqet popullsia e Shqipërisë sipas grupmohave nga viti 1950 në 2023 duke përdorur të dhënat e United Nations, World Population Prospects (2024). Popullsia mbi 65 vjeç është rritur në mënyrë të qëndrueshme, veçanërisht pas viteve 2000, duke evidentuar një plakje të popullsisë dhe rritje të kërkesës për shërbime për të moshuarit dhe shërbime sociale.

Kërkimet për të moshuarit në Shqipëri janë të kufizuara, dhe shumica paraqesin përgjegjësinë familjare dhe rrjetet informale të mbështetjes. Shqipëria po përballë me një normë plakjeje të shpejtë dhe ka një projektion kërkesë në rritje për kujdes shëndetësor aftagjatë. Nisur nga shumë vlerësime ndërkombëtare, dhjetëra mijëra të moshuar në Shqipëri po kërkojnë aktualisht kujdes shëndetësor aftagjatë dhe parashikohet që kërkesa do të rritet ndjeshëm në dekadat e ardhshme.

Analizat kombëtare dhe të Kombeve të Bashkuara, theksojnë mungesa të mëdha në përmbushjen e nevojave. Mbulimi formal i kujdesit shëndetësor aftagjatë është shumë i ulët dhe shumica e kujdesit mbetet informal dhe i bazuar në familje gjë që krijon boshllëqe në vazhdimësinë e kujdesit në shtëpi për të moshuarit (ILO, 2022).

Sipas raportit të mësipërm, shërbimet formale të kujdesit në shtëpi janë të pakta, skemat e mbrojtjes sociale nuk mbulojnë plotësisht nevojat për kujdes aftagjatë dhe financimi publik për kujdesin në shtëpi është minimal.

Pjesa më e madhe e kujdesit në shtëpi ofrohet në mënyrë informale (nga familja ose komuniteti), ndërsa shërbimet profesionale të infermierisë në shtëpi ose rehabilitimit janë të rralla jashtë qendrave të mëdha urbane. Raporti thekson se të ardhurat e kufizuara të familjeve dhe kapaciteti i pamjaftueshëm publik përbëjnë pengesa strukturore për zgjerimin e shërbimeve formale të kujdesit në shtëpi.

Në vitin 2019, qeveria Shqiptare miratoi Planin Kombëtar të Veprimit mbi Moshimin 2020–2024, duke shënuar dokumentin e parë zyrtar të politikave që trajton në mënyrë specifike shërbimet e kujdesit afatgjatë për të moshuarit. Raporti ILO (2022) vlerëson se në vitin 2020, rreth 22% e shqiptarëve të moshës 65 vjeç e lart, afërsisht 90,900 persona, kishin nevojë për shërbime afatgjata. Për të llogaritur barrën ekonomike të kujdesit formal dhe informal (duke supozuar se secili prej këtyre të moshuarve ka nevojë për të paktën një orë kujdes në ditë), ILO vlerëson një kosto totale prej 18.3 miliardë lekësh, që është e barabartë me 150 milionë euro dhe përfaqëson 1.08% të PBB-së së Shqipërisë (llogaritjet bazohen në pagën mesatare).

Raporti thekson nevojën urgjente për zgjerimin e infrastrukturës dhe politikave të kujdesit për të moshuarit, pasi kërkesa për kujdes afatgjatë pritet të më shumë se dyfishohet deri në vitin 2050, duke arritur rreth 161,000 individë (ILO, 2022).

Më poshtë, në Tabelën 1, paraqiten tre skenarë (bazuar në të dhënat e raportit (ILO, 2022)) ku vlerësohet se sa mund t'i kushtojë Shqipërisë kujdesi për të moshuarit në vitin 2050.

Tabela 1. Parashikimi i kostove vjetore për kujdesin afatgjatë në shtëpi për të moshuarit në Shqipëri sipas skenarëve të ndryshëm, 2050 (në milion € dhe si % e PBB-së)

	Numri i personave të moshuar	Kosto vjetore (mln euro)	% e GDP
Skenari 1 (bazë) (1650 euro/person në vit)	161,000	266	1.2%
Skenari 2 (mesatar) +30% rritje	161,000	345	1.6%
Skenari 3 (maksimum) + 60% rritje	161,000	425	2%

Burimi: Llogaritje të vetë autorit

Skenari bazë llogarit kostot sipas shpenzimeve aktuale për person, skenari mesatar parashikon një rritje prej 30 % të kostos për person për shkak të inflacionit dhe rritjes së pagave, ndërsa skenari maksimum merr parasysh një rritje prej 60% të kostove.

Në Tabelën 1 tregohet jo vetëm shumën totale në euro, por edhe sa përqind e Prodhimit të Brendshëm Bruto përbëjnë këto shpenzime, duke ilustruar kështu ndikimin ekonomik të ofrimit të kujdesit të të moshuarve në vend. Ajo e bën të qartë se çdo rritje e koston për person rrit ndjeshëm barrën për ekonominë kombëtare dhe nënvizon nevojën për planifikim të kujdesshëm dhe politika të qëndrueshme financiare.

Natyrisht, këto skenarë, nuk marrin parasysh disa elementë si p.sh nëse Shqipëria do pësojë ndryshime të mëtejshme demografike apo ndryshime në GDP reale. Po ashtu, nuk marrin parasysh kostot në infrastrukturë, staf, koordinim shërbimesh si dhe investime fillestare, apo edhe efikasitetin e shërbimeve, pjesëmarrjen familjare, apo zhvillimet socio-ekonomike afatgjata.

Tabela 2. Projeksioni i popullsisë në Shqipëri (2020–2050).

Grupmosha	2020	2030	2040	2050
Total	2,856,728	2,757,540	2,599,689	2,345,636
Mosha 65+	420,348	588,195	657,539	622,761
Mosha 85+	82,246	123,079	189,073	214,222

Burimi: (ILO, 2022)

Ndërkohë, Tabela 2 paraqet popullsinë e parashikuar të Shqipërisë nga viti 2020 deri në 2050, të ndarë sipas popullsisë totale, individëve të moshës 65 vjeç e lart dhe atyre 80 vjeç e lart. Popullsia totale pritet të bjerë gradualisht, nga rreth 2.86 milionë në vitin 2020 në afërsisht 2.35 milionë në vitin 2050, duke pasqyruar tkurrjen e përgjithshme demografike që ka të ngjarë të lidhet me normat e ulëta të lindshmërisë dhe emigracionin.

Në kontrast, popullsia e të moshuarve paraqet një rritje të fortë, veçanërisht te grupmosha 65 vjeç e lart, e cila rritet nga 420,348 në vitin 2020 në një kulm prej 657,539 në vitin 2040, përpara se të bjerë lehtësisht në


622,761 në vitin 2050. Grupi i moshës 80+ shfaq rritjen më të theksuar, duke u më shumë se dyfishuar nga 82,246 në vitin 2020 në 214,222 në vitin 2050.

4.2 Franca, model i integruar dhe professional

Franca, e vendosur në Evropën Perëndimore, është vendi i tretë më i madh në Evropë për nga sipërfaqja dhe ka një popullsi prej rreth 67 milionë banorësh. Franca ka një sistem shëndetësor shumë të zhvilluar, i cili konsiderohet ndër më efikasit në botë, dhe që kombinon ofrues publikë dhe privatë, duke u financuar kryesisht përmes sigurimeve shëndetësore shoqërore.

Në Francë, ekziston një bazë të dhënash kombëtare e quajtur Sistemi Kombëtar i të Dhënave Shëndetësore (Système National des Données de Santé, SNDS), e cila përmbledh informacion të detajuar shëndetësor për pothuajse gjithë popullsinë, pasi sigurimi shëndetësor publik është i detyrueshëm për të gjithë (Rachas, et al., 2022).

Figura 2. Popullsia në Francë sipas grupmoshave



Burimi: UN, World Population

Figura 2 paraqet popullsinë e Francës sipas grupmoshave nga viti 1950 deri në 2023. Popullsia totale është rritur në mënyrë të qëndrueshme nga rreth 42 milionë në vitin 1950 në rreth 67 milionë në 2023. Grupi 65+ (zona e kuqe) tregon një rritje të vazhdueshme, duke theksuar trendin e plakjes së popullsisë

në Francë, me ndikime për sistemin shëndetësor, pensionet dhe shërbimet sociale.

Literatura trajton disa dimensione të modelit HaH, nga efektiviteti klinik tek përvojat e pacientëve dhe mekanizmat organizativë që mundësojnë funksionimin e tij.

Katër fusha kryesore studimi në këtë drejtim janë: 1) rezultatet klinike dhe norma e rikthimit në spital, 2) përvojat e pacientëve dhe kujdestarëve, 3) integrimi i sistemit dhe roli i ekipeve të lëvizshme spitalore, 4) si edhe përparimet teknologjike që mbështesin shërbimet HaH.

Një numër i konsiderueshëm studimesh në Francë ka vlerësuar efektivitetin klinik të programeve HaH, duke u fokusuar në rezultate si vdekshmëria, rikuperimi funksional dhe rikthimi i hershëm në spital. Gjetjet përgjithësisht tregojnë se HaH mund të ofrojë kujdes të sigurt dhe efektiv për të moshuarit, duke prodhuar shpesh rezultate klinike të ngjashme me trajtimin tradicional spitalor.

Për shkak të numrit të madh të ndërlikimeve mjekësore, psikologjike dhe sociale që kërkojnë një qasje shumëdimensionale (duke përfshirë infermierë, mjekë, psikologë, fizioterapistë, terapistë profesionalë, dietologë, punonjës socialë dhe farmacistë) për pacientët e moshuar, shërbimet HaH në Francë janë të disponueshme për individët që jetojnë në shtëpitë e tyre, në banesa private ose në institucione të kujdesit për të moshuarit (de Stampa, et al., 2023).

Pranimi në shërbimin HaH kërkon një përshkrim mjekësor, pëlqimin e pacientit, një mjek të përgjithshëm dhe, mundësisht, një kujdestar informal, megjithëse të jetuarit vetëm nuk është kriter përjashtimor. HaH⁴ që financohen nga sistemi kombëtar i sigurimeve shëndetësore ofrohen për një periudhë të kufizuar dhe kanë karakter elastik.

Në një studim, i cili përfshiu një kampion prej 71 mjekësh të përgjithshëm⁵ si dhe një numër të barabartë pacientësh të moshës +75 vjeç⁶ u

⁴ Të cilat përfshijnë ndihmë për veshjen e pacientëve, kujdesin paliativ dhe atë të avancuar infermieror, ushqimin artificial, terapitë intravenoze përfshirë kimioterapinë, rehabilitimin, menaxhimin e dhimbjes dhe monitorimin pas operacionit, por përjashtojnë detyrat shtëpiake si përgatitja e ushqimit ose punët e shtëpisë.

⁵ Mjekë familjeje me moshë mesatare 49 vjeç: 62% e tyre ishin meshkuj.

⁶ Pacientë me moshë mesatare 84 vjeç: 52% e tyre ishin meshkuj, 94% jetonin në shtëpi, dhe 22% kishin çrregullime konjitive.

zbulua se 65% e tyre e kishin konsultuar mjekun e tyre të përgjithshëm brenda 7 ditëve nga dalja nga spitali (Hurtaud et al., 2020).

Një studim tjetër paraqet një protokoll për vlerësimin e efektivitetit të një programi me infermiere, që synon të ulë rikthimet në spital brenda 30 ditëve tek pacientët e moshuar të dalë nga njësitë e qëndrimit të afat-shkurtër. Në studimin klinik PROUST, pjesëmarrësit janë pacientë të moshës 75 vjeç e lart, të cilët kanë dalë nga njësitë spitalore të qëndrimit afat-shkurtër. Këta pacientë konsiderohen me rrezik të lartë për rikthim të hershëm të ndikuar nga mosha e tyre, sëmundjet bashkëshoqëruese dhe kompleksiteti i kalimit nga spitali në kujdesin në shtëpi. Nga studimi vërehet se pacientët e moshuar shpesh përballen me sfida gjatë kalimit nga spitali në shtëpi, përfshirë probleme në komunikim, planifikimin e pamjaftueshëm të daljes dhe mungesën e ndjekjes së koordinuar. Autorët argumentojnë se caktimi i një infermiere të dedikuar për tranzicionin mund të ndihmojë në zgjidhjen e këtyre çështjeve duke ofruar mbështetje të individualizuar, duke reduktuar rikthimet në spital dhe duke përmirësuar rezultatet e përgjithshme të pacientit. Madje, autorët theksojnë përfitimet më të gjera të mundshme të programeve të tilla, si përdorimi më i mirë i burimeve, rritja e kënaqësisë së pacientëve dhe integrimi i përmirësuar midis shërbimeve spitalore dhe kujdesit primar (Occelli et al., 2016).

Kërkimet kanë treguar se kujdesi në shtëpi shpesh sjell kosto më të ulëta dhe rezultate më të mira shëndetësore për pacientët e moshuar, veçanërisht për ata me sëmundje kronike. Megjithatë, efektiviteti i kujdesit në shtëpi varet nga disponueshmëria e personelit të trajnuar, infrastruktura dhe aftësia për të monitoruar pacientët në distancë.

Më shumë se një e katërta e popullsisë ishte mbi 60 vjeç në Janar 2020; mbi 1.4 milion të moshuar jetojnë në shtëpi dhe 584,000 jetojnë në institucione dhe konsiderohen të varur. Parashikimet tregojnë se ky numër mund të rritet me 200,000 deri në 410,000 (+15% deri +33%) deri në vitin 2030, dhe deri në vitin 2050 rreth 4 milion të moshuar mund të përjetojnë humbje të autonomisë, duke përfaqësuar 16.4% të atyre mbi 60 vjeç, krahasuar me 15.3% në 2015.

Një sfidë tjetër e rëndësishme janë pabarazitë territoriale dhe fenomeni i ‘shkretëtirave mjekësore’, term që përdoret për të përshkruar mungesat dhe dobësitë në aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore në disa zona (Bajeux et al., 2021). Megjithëse sigurimi shëndetësor kombëtar ul pengesat financiare,

qasja në mjekun e familjes, specialistët dhe shërbimet HaH mbetet e pabarabartë midis rajoneve dhe midis zonave urbane dhe rurale. Gusmano et al., (2014) konfirmojnë këtë variacion, duke treguar se akses më i dobët ekziston në zonat me të ardhura më të ulëta dhe më rurale, edhe pse sistemi është universal.

Përveç pabarazive territoriale, një sfidë kryesore që ndikon në qasjen dhe cilësinë e shërbimeve HaH lidhet me kufizimet e fuqisë punëtore dhe ngarkesën mbi ofruesit e shërbimeve. Rekrutimi dhe mbajtja e infermierëve, geriatërve dhe ekipeve lëvizëse të kujdesit në shtëpi është i vështirë, veçanërisht në zonat me dendësi të ulët (Bonal et al., 2024).

Diskutime

Adresimi i problemit të moshimit të popullsisë kërkon një ri-orientim drejt zgjidhjeve për një kujdes afat-gjatë të integruar, të bazuar në komunitet, dhe të qëndrueshëm.

Eksperiencia e Francës na tregon që programet e kujdesit në shtëpi të cilat janë të mirë strukturuara mund të ulin shtrimet e panevojshme në spital dhe mund të përmirësojnë koordinimin midis shërbimeve mjekësore dhe sociale.

Një sfidë e madhe për Shqipërinë mbetet krijimi nga e para i strukturave të tilla duke i adaptuar ato me realitetin demografik, financiar dhe social të vendit.

Për të kaluar në një model të qëndrueshëm kujdesi ndaj të moshuarve, propozojmë që Shqipëria të ndërhyjë në disa faza:

Faza afat-shkurtër (1–2 vite):

- Të nisë një *model pilot hibrid* duke kombinuar mbikqyrjen në spital me mbështetjen e komunitetit dhe familjes.
- Të implementojë programe pilotimi rajonale për të integruar kujdes nga infermierët në shtëpi, rehabilitim dhe shërbime tele-monitoruese.
- Të ofrojë programe të targetuara trajnimi për infermierë dhe punonjës socialë rreth kujdesit për të moshuarit dhe kujdesit në shtëpi.

Faza afat mesme (3–5 vite):

- Të përfshijë gradualisht shërbime kujdesi afat-gjatë në skemën kombëtare të sigurimit të shëndetit.

- Të vendosë koordinimin midis sektorëve të shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe sektorëve të punës për ofrimin e shërbimeve dhe të të dhënave.
- Të zhvillojë mekanizma nxitës për bashkitë në mënyrë që të bashkë financohen programet e kujdesit lokal në shtëpi, si dhe bashkëpunime me OJQ.

Faza afat-gjatë (5–10 vite):

- Të formalizojë rolin e kujdestarëve profesionistë nëpërmjet sistemit të certifikimit dhe licensimit, duke siguruar kushte pune dinjitoze dhe njohje profesionale.
- Të krijojë një fond kombëtar të kujdesit afatgjatë për të garantuar financim të qëndrueshëm dhe për të ulur varësinë nga pagesat vetjake të padeklaruar.
- Të ndërmarrë fushata publike ndërgjegjësimi për të njohur kujdesin afat-gjatë si një e drejtë sociale dhe njerëzore për të inkurajuar përgjegjësinë sociale për të moshuarit.

Rekomandime

Për të monitoruar ndryshimet demografike dhe për vendim-marrjen në të ardhmen, është thelbësore të zhvillohen baza të dhënash kombëtare të besueshme mbi plakjen, kujdesin në shtëpi dhe tranzicionin nga kujdesi spitalor.

Studimet e ardhshme duhet të përfshijnë mbledhjen e të dhënave parësore përmes intervistave ose pyetësorëve me kujdestarë, profesionistë të shëndetësisë dhe pacientë të moshuar. Kërkime afat-gjata mund të vlerësojnë efektet afatgjata në rezultatet e pacientëve, mirëqenien e kujdestarëve dhe efikasitetin e kostove.

Shqipëria mund të zhvillojë sisteme të qëndrueshme për kujdesin e të moshuarve, duke integruar dimensionet mjekësore, sociale dhe njerëzore dhe duke i përshtatur praktikat krahasuese me kontekstin lokal.

Përfundime

Nga analizimi i literaturës dhe krahasimi midis Francës dhe Shqipërisë arrijmë në disa përfundime kryesore.

Së pari, kujdesi i strukturuar profesionalisht në shtëpi, siç është modeli HaH në Francë, paraqet rezultate klinike të ngjashme ose më të mira se kujdesi spitalor. Kjo qasje përmirëson kënaqësinë e pacientëve, ruan pavarësinë funksionale dhe mund të jetë më efektive ekonomikisht në kushtet e mbështetjes së përshtatshme profesionale.

Së dyti, Shqipëria mbetet e varur kryesisht nga kujdesi informal familjar, me mbulim të kufizuar të shërbimeve profesionale dhe infrastruktura të fragmentuara, gjë që rrit rrezikun e pabarazive në qasje dhe cilësi të kujdesit.

Së treti, ndikimi i faktorëve socialë, kulturorë dhe politikë është vendimtar: efektiviteti i kujdesit në shtëpi nuk varet vetëm nga teknologjia dhe protokollet klinike, por edhe nga sistemi mbështetës, financimi dhe normat shoqërore.

Së katërti, për të përmirësuar kujdesin për të moshuarit në Shqipëri, nevojiten politika të integruara, investime në kapacitetet profesionale dhe zhvillimi i databazave kombëtare për ndjekjen e plakjes dhe shërbimeve të kujdesit në shtëpi dhe në spital.

Një model i suksesshëm për Shqipërinë mund të kombinojë mësimet nga eksperiencia ndërkombëtare e përshtatur për kontekstin lokal.

Literatura

- Bajeux, E., Corvol, A., & Somme, D. (2021). Integrated care for older people in France in 2020: findings, challenges, and prospects. *International Journal of Integrated Care*, 21(4), 16.
- Bonal, M., Padilla, C., Chevillard, G., & Gabrielli, V. L. (2024). A French classification to describe medical deserts: a multi-professional approach based on the first contact with the healthcare system. *International Journal of Health Geographics*, 23(1), 5. doi:<https://doi.org/10.1186/s12942-024-00366-7>
- Brisku, I. (2023). Establishment and Operation of the First Elders' Care Institution in Albania." *Bulgarian Ethnology*, 1, 66-82.
- de Stampa, M., Georges, A., Grino, M., Cerase, V., Baudouin, É., & Vedel, I. (2023). Thirty-day hospital readmission predictors in older patients receiving hospital-at-home: a 3-year retrospective study in France. *BMJ open* 13, no, 13(12), e073804.
- Française, R. (n.d.). *Décret n°92-1101 du 2 octobre 1992 relatif aux structures de soins alternatives à l'hospitalisation mentionnées à l'article L. 712-2 du code*

- de la santé publique*. Retrieved from <https://www.legifrance.gouv.fr/loda/id/JORFTEXT000000726288>
- Gabrani, J., Schindler, C., & Wyss, K. (2020). Perspectives of public and private primary healthcare users in two regions of Albania on non-clinical quality of care. *Journal of primary care & community health, 11*, 2150132720970350.
- Gusmano, M. K., Weisz, D., Rodwin, V. G., Lang, J., Qian, M., Bocquier, A., Verger, P. (2014). Disparities in access to health care in three French regions. *Health Policy, 114*(1), 31-40.
- Hurtaud, A., Lallier, F., Heidet, M., Arnoult, C., Dramé, M., & Canoui-Poitrine., F. (2020). Real-life implementation of guidelines on the hospital-to-home transition for older patients: a cohort study in general practice. *Age and Ageing, 49*(1), 46-51.
- ILO. (2022). *Long-term care for the elderly in Albania: challenges and key policy issues*. Retrieved from https://albania.un.org/sites/default/files/2023-02/6.%20Long-term%20care%20for%20the%20elderly_report.pdf
- Leff, B., & Montalto, M. (2004). Home hospital—toward a tighter definition. *Journal of the American Geriatrics Society, 52*(12), 2141-2141.
- Morris, D. E. (1983). Santé Service Bayonne: a French approach to home care. *Age and ageing, 12*(4), 323-328.
- Ocelli, P., Touzet, S., Rabilloud, M., Ganne, C., Bourdy, S. P., Galamand, B., Turkie, B. (2016). Impact of a transition nurse program on the prevention of thirty-day hospital readmissions of elderly patients discharged from short-stay units: study protocol of the PROUST stepped-wedge cluster randomised trial. *BMC geriatrics, 16*(1), 57.
- Rachas, A., Gastaldi-Ménager, C., Denis, P., Barthélémy, P., Constantinou, P., Drouin, J., Pestel, L. (2022). The economic burden of disease in France from the National Health Insurance Perspective: the healthcare expenditures and conditions mapping used to prepare the French social security funding act and the public health act. *Medical care, 60*(9), 655-664.
- Rossinot, H., Marquestaut, O., & de Stampa, M. (2019). The experience of patients and family caregivers during hospital-at-home in France. *BMC health services research, 19*(1), 470.
- Shërbimi Social Shtetëror. (2025). Retrieved from <https://www.sherbimisocial.gov.al/te-moshuar/>
- Terrade, O., Tsutsui, T., & Cottencin, A. (2012). Hospital care at home in France: an alternative to conventional hospitalization with the same obligations towards quality and administration. *Journal of the National Institute of Public Health, 61*(2), 148-154.

Pabarazia gjinore dhe taveni i qelqtë në arsimin e lartë shqiptar

Jona Marashi ^{a,7} Bukuri Dumani^a
^a *Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë*

Përmbledhja

Pabarazia gjinore në arsimin e lartë vazhdon të mbetet një çështje e rëndësishme në Shqipëri, veçanërisht në raport me përfaqësimin e grave në pozita drejtuese dhe pengesat e padukshme që njihen si “taveni i qelqtë”. Ky studim synon të analizojë perceptimet e stafit akademik mbi këto barriera, si dhe të identifikojë faktorët institucionalë dhe kulturorë që ndikojnë në avancimin e karrierës së grave në universitetet shqiptare. Duke qenë se universitetet luajnë një rol kyç në formësimin e elitave profesionale dhe në prodhimin e njohurive, vlerësimi i dinamikave të brendshme që favorizojnë ose kufizojnë barazinë gjinore merr rëndësi të veçantë. Të dhënat janë mbledhur nga një kampion prej 360 anëtarësh akademikë nga gjashtë universitete shqiptare, përmes një pyetësori të strukturuar me pesë shkallë vlerësimi. Pyetjet fokusohen në katër dimensione kryesore: ekzistencën e pengesave konceptuale në nivelet drejtuese, perceptimin e meritokracisë dhe vlerësimit profesional, përfaqësimin gjinor në pozita drejtuese dhe mekanizmat mbështetës për balancimin punë-jetë. Gjetjet tregojnë se pjesa më e madhe e të anketuarve nuk perceptojnë pengesa të drejtpërdrejta gjinore në promovim dhe vlerësim profesional, ndërsa raportojnë përfaqësim relativisht të mirë të grave në role drejtuese. Megjithatë, një pjesë domethënëse e stafit nënvizon sfida të heshtura, përfshirë skepticizëm mbi transparencën në proceset e karrierës, ngarkesën disproporcionale familjare për gratë dhe mungesën e përfaqësimit të tyre në nivelet më të larta të drejtimit. Studimi përfundon se taveni i qelqtë në universitetet shqiptare nuk është një strukturë e dukshme, por një rrjet faktorësh kulturorë dhe organizativë që ndikojnë në mënyrë të tërthortë në avancimin akademik.

Fjalë kyçe: pabarazi gjinore; arsimi i lartë; taveni i qelqtë; avancimi i grave në karrierë; qeverisja universitare; pengesa të fshehura; integrimi i perspektivës gjinore.

⁷ KONTAKT: jona.marashi@umsh.edu.al

Abstract

Gender inequality in higher education remains a significant concern in Albania, particularly regarding the representation of women in leadership positions and the presence of invisible barriers commonly referred to as the “glass ceiling.” This study aims to analyze academic staff perceptions of such barriers and to identify the institutional and cultural factors that influence women's career advancement within Albanian universities. Given the central role of universities in shaping professional elites and generating knowledge, understanding the internal dynamics that either promote or hinder gender equality is of critical importance. Data were collected from a sample of 360 academic staff members across six Albanian universities, using a structured questionnaire with a five-point Likert scale. The survey focuses on four primary dimensions: the existence of conceptual or cultural barriers at leadership levels, perceptions of meritocracy and professional evaluation, gender representation in leadership roles, and the availability of institutional support mechanisms that facilitate work–life balance. Findings indicate that most respondents do not perceive direct gender-based obstacles in promotion or professional recognition, and they report a relatively satisfactory level of female representation in leadership positions. However, a significant portion of participants highlights subtle challenges, including skepticism about the transparency of career advancement processes, the disproportionate family burden placed on women, and the underrepresentation of women in the highest decision-making roles. The study concludes that the glass ceiling within Albanian universities is not a visible or formalized structure, but rather a constellation of cultural and organizational factors that indirectly affect academic advancement. These results underline the need for clearer policies, more transparent procedures, and stronger institutional support to ensure a genuinely equitable and inclusive academic environment.

Keywords: gender inequality; higher education; glass ceiling; women’s career advancement; university governance; hidden barriers; gender mainstreaming;

1. Hyrje

Pavarësisht reformave ligjore dhe një pjesëmarrjeje të lartë të grave në arsim, ato mbeten të nënpërfaqësuar në pozitat drejtuese universitare, një fenomen i njohur ndërkombëtarisht si “tavani i qelqtë”. Ky problem vjen si rezultat i normave kulturore, strukturave të vendimmarrjes, stereotipeve gjinore dhe politikave të paqarta institucionale, të cilat ndërthurur krijojnë barriera të

heshtura, shpesh të padukshme, por me ndikim të madh në tregun universitar shqiptar. Ndonëse ligjërisht Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të barazisë gjinore, realiteti në aspektin operativ managerial dhe kulturor mbetet i vështirë për t'u transformuar.

Studimi i tavanit të qelqtë në universitetet shqiptare është veçanërisht domethënës, pasi universitetet janë vende ku formohen profesionistët e ardhshëm dhe ku kultivohen norma shoqërore. Si institucione që ndikojnë drejtpërdrejt zhvillimin njerëzor dhe social, ato pritet të jenë model i barazisë dhe meritokracisë. Megjithatë, rezultatet tregojnë se ky mision nuk është plotësisht i realizuar.

2. Sfondi i kërkimit

Pabarazia gjinore mbetet një çështje qendrore kryesisht në shkencat sociale, pasi ndikon në mundësitë e jetës, rezultatet në tregun e punës dhe mirëqenien e përgjithshme. Ekonomistët, sociologët, politologët dhe studiuesit e zhvillimit të qëndrueshëm e analizojnë pabarazinë gjinore si një rezultat të strukturave shoqërore, por edhe si një faktor që nxit proceset ekonomike e shoqërore.

2.1 Modelet kryesore të teorive ekonomike

Ekonomistët e kanë trajtuar pabarazinë gjinore duke përdorur disa korniza teorike plotësuese:

Modelet e kapitalit njerëzor dhe ofertës së punës. Teoria tradicionale e kapitalit njerëzor shpjegon diferencat në të ardhurat sipas gjinisë përmes dallimeve në arsim, përvojë dhe ndërprerje të karrierës (lindje dhe rritje fëmijësh). Becker G. S. (1964) argumenton se individët investojnë në arsim dhe trajnim për të maksimizuar fitimet gjatë gjithë jetës. Ndërsa Mincer (1974) e lidh pagën me shkollimin dhe përvojën, duke e konsideruar akumulimin e kapitalit njerëzor si faktor kyç të produktivitetit. Kombinimi i modeleve të kapitalit njerëzor dhe të ofertës së punës shpjegon pabarazitë gjinore të qëndrueshme.

Modelet e Diskriminimit në Ekonominë e Punës. Këto modele përfshijnë diskriminimin me bazë preferencash dhe diskriminimin statistikor. Koncepti

i diskriminimit në tregun e punës ka qenë prej kohësh një pikë qendrore në ekonominë e punës, i analizuar kryesisht përmes dy boshteve teorikë themelorë: modelit të diskriminimit me bazë preferencash (taste-based discrimination) dhe modelit të diskriminimit statistikor (Becker G. S., 1957). Këto modele ofrojnë shpjegime plotësuese për pabarazitë e vazhdueshme në paga, punësim dhe promovim midis gjinive dhe grupeve racore, edhe pse ekzistojnë forma të barazisë formale dhe ligje kundër diskriminimit. (Charles, K. K., & Guryan, J., 2008).

Grupimi profesional dhe pengesat në nivel organizate. Krahas qasjeve individuale, studimet e fundit theksojnë heterogjenitetin midis organizate (p.sh. fleksibiliteti i orarit, rregullat e promovimit, mënyrat e vlerësimit). Universitetet riprodhojnë grupimin profesional dhe vertikal përmes pengesave institucionale në proceset e rekrutimit, promovimit dhe shpërndarjes së kohës së punës. Studiuesit argumentojnë se papajtueshmëria midis kërkesave në rritje të roleve akademike me përgjegjësi të lartë (të lidhura me drejtimin e kërkimeve, menaxhimin e granteve dhe detyrimet administrative) dhe përgjegjësi familjare apo të kujdesit përbën një faktor qendror në vazhdimësinë e hendekut gjinor në pozitat e larta akademike (Goldin, 2014). Monitorimet ndërkombëtare (European Commission, She Figures 2024) dhe studimet sektoriale tregojnë se gratë mbeten ende të nën-përfaqësuar në pozitat drejtuese dhe vendimmarrëse në arsimin e lartë, duke nënvizuar vazhdimësinë e “tavanit të qelqtë” në universitete.

Këndvështrimi organizativ dhe ndikimi i kulturave institucionale sipas kësaj qasjeje kanë shërbyer si bazë teorike në hartimin e kornizës së këtij studimi dhe gjenerimin e instrumentit kryesor të kërkimit. Korniza e studimit i është përshtatur mjedisit shqiptar, bazuar në analizën që vijon.

3. Objektivat dhe pyetjet kërkimore

Ky studim synon të kontribuojë në literaturën mbi pabarazinë gjinore në arsimin e lartë, duke ofruar një analizë empirike të perceptimeve dhe mekanizmave institucionalë që lidhen me fenomenin e *tavanit të qelqtë* në universitetet shqiptare. Në mënyrë të veçantë, studimi orienton vëmendjen drejt elementeve të dukshme dhe të padukshme që kushtëzojnë mundësitë e avancimit akademik dhe administrativ për gratë në institucionet e arsimit të lartë.

Bazuar në këtë qëllim të përgjithshëm, studimi formëson dy objektiva kryesorë kërkimore:

1. Identifikimi i perceptimeve të stafit akademik dhe administrativ mbi nivelin dhe format e pabarazisë gjinore në universitete.
2. Analiza e faktorëve strukturore dhe kulturorë, si të dukshëm ashtu edhe të padukshëm, që mund të ndikojnë në shfaqjen dhe riprodhimin e tavanit të qelqtë në institucionet e arsimit të lartë.

Për të realizuar këta objektiva, janë ndërtuar dy pyetje kërkimore qendrore:

1. A ekzistojnë faktorë të padukshëm (norma kulturore, stereotipe, pritshmëri gjinore) që ndikojnë në pabarazinë gjinore në disa universitete shqiptare?
2. A ofrojnë disa universitete shqiptare një ambient institucional të favorshëm dhe mbështetës për barazinë gjinore?

Në funksion të këtyre pyetjeve kërkimore, studimi ka ndërtuar një set hipotezash bazë, të cilat synojnë të testojnë perceptimet, mekanizmat e mbështetjes institucionale dhe dinamikat e përfaqësimit gjinor:

1. **Hipoteza 1.** Ekzistojnë pengesa konceptuale dhe kulturore në nivelet drejtuese të universiteteve, të cilat kufizojnë avancimin në karrierë të stafit, sidomos grave, në pozita administrative dhe akademike.
2. **Hipoteza 2.** Individët në universitete ndihen të vlerësuar sipas aftësive dhe performancës profesionale, pavarësisht gjinisë.
3. **Hipoteza 3.** Pozicionet drejtuese në departamente dhe fakultete dominohen në mënyrë disproporcionale nga një gjini, me një nën-përfaqësim të grave në nivelet e larta të drejtimit.
4. **Hipoteza 4.** Universitetet ofrojnë mekanizma mbështetës që u mundësojnë stafit të balancojë detyrimet profesionale me ato familjare (p.sh., leje për arsye familjare, përshtatshmëri orari, mbështetje gjatë situatave emergjente).

Përveç këtyre hipotezave kryesore, analiza është zgjeruar duke përfshirë pyetje të tjera të anketës që mundësojnë verifikimin, alterantivat e pavendosmerise ne pergjigje ose rrëzimin e tyre. Këto pyetje shtesë

kontribuojnë në krijimin e një kuadri më të gjerë analitik, duke lejuar vlerësimin e faktorëve të institucionalizuar, perceptimeve individuale dhe klimës organizative në secilin universitet të përfshirë në studim.

4. Metodologjia

Qasja metodologjike e studimit mbështetet në analiza të ndara dhe të strukturuar që synojnë të zbulojnë barrierat e fshehura dhe mekanizmat që pengojnë arritjen e barazisë reale midis gjinive. Këto analiza synojnë të nxjerrin në pah jo vetëm boshllëqet institucionale, por edhe aspektet e kulturës organizative që mund të mbajnë gjallë forma të pabarazisë së padukshme. Rezultatet kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në hartimin e politikave të shënjestruara dhe ndërhyrjeve institucionale të bazuara në evidenca, të cilat mund të nxisin ndërtimin e një mjedisi akademik më të drejtë, të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të gjithë anëtarët e stafit pedagogjik.

Studimi mbështetet në të dhëna sasiore parësore, të mbledhura përmes një kampioni probabilitar që përfshin 360 anëtarë të stafit akademik nga gjashtë universitete të përzgjedhura në mënyrë rastësore. Procesi i përzgjedhjes është realizuar përmes një metodologjie me dy hapa për të garantuar përfaqësimin statistikor. Në hapin e parë, universitetet janë përzgjedhur duke përdorur metodën “Probabilitet proporcional me madhësinë” (Probability Proportional to Size), e cila siguron që institucionet më të mëdha të kenë probabilitet më të lartë për t’u përfshirë në kampion. Në hapin e dytë, përzgjedhja e individëve është bërë nëpërmjet metodës së kampionimit të rastësishëm të thjeshtë (Simple Random Sampling), duke mundësuar që çdo anëtar i stafit pedagogjik të ketë shanse të barabarta për t’u përfshirë në studim.

Instrumenti i mbledhjes së të dhënave është hartuar dhe administruar përmes platformës Google Forms. Linku i pyetësorit është shpërndarë dhe rishpërndarë drejtpërdrejt në adresat zyrtare të email-it të individëve të përzgjedhur pasi është testuar, duke siguruar një proces efikas, të standardizuar dhe të aksesueshëm të grumbullimit të informacionit. Përmes kësaj metodologjie, studimi synon të sigurojë një bazë të fortë empirike mbi të cilën mund të ndërtohen analiza të thelluara dhe rekomandime të vlefshme për politikëbërjen universitare në fushën e barazisë gjinore. Pyetësori përfshin: një shkallë pesëpikëshe të tavanit të qelqtë, strategjitë institucionale, mjedisin e punës, të ardhurat dhe ngarkesën e punës, sigurinë në punë dhe

ngacmimin seksual.. Ne kete studim qe eshte pjese e nje studimi me kompleks do te analizojme vetem elementet e tavanit te qelqte.

5. Rezultate dhe diskutime

Në analizën e perceptimeve mbi ekzistencën e “tavanit të qelqtë” në universitetet shqiptare, përdorimi i një shkalle me pesë nivele vlerësimi ka qenë një zgjedhje metodologjike e qëllimshme për të siguruar një matje më të fragmentuar dhe të hollësishme të qëndrimeve të pjesëmarrësve. Shkalla me pesë alternativa nga “Jo” deri të “Gjithmonë” lejon kapjen e dallimeve të holla mes qëndrimeve neutrale, pozitive dhe negative, duke reflektuar më saktë intensitetin e perceptimit të barrierave gjinore. Kjo strukturë e shkallës siguron një ekuilibër optimal mes qartësisë për anketuesit dhe ndjeshmërisë analitike për studiuesin, duke mundësuar krahasime statistikore të besueshme.


Në rastin e analizës së tavanit të qelqtë, një shkallë më e kufizuar (p.sh. 3-nivelëshe) do të rrezikonte thjeshtëzimin e tepërt të realitetit, ndërsa një shkallë më e gjerë (p.sh. 7-nivelëshe) mund të shtonte paqartësi në interpretim.

Përmes kësaj metodologjie u bë e mundur të dallohen qartë përmasa të tilla si perceptimi i pengesave konceptuale, ndjenja e vlerësimit sipas meritës, angazhimi i drejtuesve për barazi, përfaqësimi gjinor në pozita drejtuese, etj. Kështu, shkalla pesëpikëshe ofron një balancë të qëndrueshme midis thjeshtësisë së kuptimit dhe thellësisë analitike, duke kontribuar në saktësinë dhe interpretueshmërinë e rezultateve të studimit.

Hipoteza 1. A ekzistojnë pengesa konceptuale dhe kulturore në nivelet drejtuese të universiteteve, të cilat kufizojnë avancimin në karrierë të stafit, sidomos grave, në pozita administrative dhe akademike.

Të dhënat e prezantuara lidhen me perceptimin mbi ekzistencën e pengesave konceptuale në një kontekst të caktuar profesional apo akademik. Nga analiza statistikore e përgjigjeve të mbledhura rezulton se moda pra, alternativa më e shpeshtë e përzgjedhur, është përgjigjja "Jo", me 55.8% të totalit të pjesëmarrësve që deklarojnë se nuk ekzistojnë pengesa konceptuale, Figura 1. Kjo sugjeron një perceptim dominues pozitiv në lidhje me mungesën e barrierave mendore ose konceptuale në këtë mjedis.

Figura 1. Shpeshtësia e pengesave konceptuale në nivel drejtues në lidhje me gjininë për avancimin në karrierë, në përqindje.



Ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve 27.8% shprehen se pengesat konceptuale ekzistojnë “rrallë”, çka tregon një prezencë të kufizuar, por jo të papërfillshme të këtyre barrierave. Së bashku me ata që u përgjigjën “Jo”, ky grup përbën 83.6% të të anketuarve, që përjashtojnë ose minimizojnë dukshëm ekzistencën e pengesave konceptuale.


Nga ana tjetër, një numër më i vogël pjesëmarrësish pohojnë ekzistencën më të shpeshtë të këtyre pengesave: 11.8%, të cilat i përshkruajnë si të pranishme “shpesh”, ndërsa vetëm një përqindje shumë e vogël i identifikon ato si prezente “në shumicën e rasteve” (3.8%) apo “gjithmonë” (0.9%). Kjo ndarje sugjeron se megjithëse nuk mund të flitet për një mungesë absolute të pengesave konceptuale, prania e tyre perceptohet si e kufizuar dhe jo sistematike.

Hipoteza 2. Individët në universitete ndihen të vlerësuar sipas aftësive dhe performancës profesionale, pavarësisht gjinisë.

Moda e përgjigjeve është alternativa “Gjithmonë”, e cila përfaqëson 32.9% të totalit të pjesëmarrësve, Figura 2. Kjo tregon se për një pjesë të

konsiderueshme të pjesëmarrësve, ndjesia e vlerësimit sipas meritës, pa ndikuar nga gjinia, është jo vetëm e pranishme, por e vazhdueshme. Për më tepër, një tjetër grup i madh 30.8%, deklarojnë se ndihen të vlerësuar “në shumicën e rasteve”, duke e çuar përqindjen kumulative të përgjigjeve pozitive në 63.7%, që është tregues i një kulture të perceptuar si e drejtë dhe e mbështetur në aftësi profesionale.

Figura 2. Shpeshësia e të ndjerit i vlerësuar sipas aftësive pavarësisht gjinisë, në përqindje.




Përgjigjja “Shpesh” është zgjedhur nga 17.1% e pjesëmarrësve, një tregues që ndonëse pozitiv, sugjeron një vlerësim që nuk është gjithmonë i qëndrueshëm. Kjo kategori reflekton mundësinë që vlerësimi i bazuar në aftësi ndikohet në raste të caktuara nga faktorë të tjerë, potencialisht të lidhur me gjininë apo dinamika institucionale të paqarta.

Në anën tjetër, vetëm një pakicë e pjesëmarrësve deklarojnë ndjesi të ulët vlerësimi: 11.9% janë përgjigjur “Rrallë”, ndërsa 7.4% deklarojnë “Jo”, pra nuk ndihen fare të vlerësuar mbi bazën e aftësive të tyre. Këto përqindje të ulëta, megjithëse jo alarmante, përfaqësojnë zëra të rëndësishëm që sugjerojnë se ka ende vend për përmirësim në drejtim të krijimit të një ambienti të barabartë dhe mbështetës për të gjithë.

Hipoteza 3. Pozicionet drejtuese në departamente dhe fakultete dominohen në mënyrë disproporcionale nga një gjini, me një nën-përfaqësim të grave në nivelet e larta të drejtimit.

Të dhënat e analizuara për pyetjen nëse pozitat drejtuese në departamentet apo fakultetet universitare mbahen nga individë të gjinisë femërore ofrojnë një pasqyrë kuptimplotë mbi perceptimet e barazisë gjinore në nivelet udhëheqëse akademike. Nga përgjigjet e vlefshme, moda e të dhënave është alternativa “Shpesh por të merituar”, e cila përfaqëson 42.9% të të anketuarve. Kjo tregon se për një përqindje dominuese të pjesëmarrësve, gratë janë të pranishme në mënyrë të dukshme në pozitat drejtuese dhe, njëkohësisht, perceptohen si të denja për këto role.

Figura 3. Shpeshësia e të shikuarit në pozita drejtuese në departament / fakultet e individëve të gjinisë, në përqindje.



Për më tepër, një përqindje tjetër e konsiderueshme (38.5%) e klasifikon përfaqësimin e grave në pozita drejtuese si të ndodhur “sipas aftësive dhe të merituar”, duke theksuar cilësinë e përzgjedhjes, pavarësisht se nuk përmendet frekuenca. Kjo shton më tej besueshmërinë në integritetin e përzgjedhjes së lidershit dhe sugjeron që kompetenca mbizotëron mbi

konsideratat gjinore.

Nga ana tjetër, një minorancë e pjesëmarrësve ka shprehur skepticizëm: 10.5% raportojnë se gratë mbajnë shpesh pozita drejtuese, por i konsiderojnë këto raste si të pamërituara, duke ngritur pikëpyetje për ndonjë perceptim të përzgjedhjes së bazuar në kritere jo meritokratike. Kjo mund të pasqyrojë qëndrime subjektive, përvoja të izoluara, ose sfida në komunikimin institucional të procesit të përzgjedhjes.


Ndërkohë, 4.9% shprehen se gratë janë shumë rrallë në pozita drejtuese, por kur janë, janë të merituar, dhe vetëm 3.2% ndajnë mendimin se ky përfaqësim i rrallë është edhe i pamërituar. Këto shifra janë relativisht të vogla dhe nuk përbëjnë një perceptim të përhapur.

Në përfundim, analiza dëshmon se në shumicën dërrmuese të rasteve, pozitat drejtuese mbahen nga gra që perceptohen si të afta dhe të denja për rolet që ushtrojnë. Kjo sugjeron një realitet organizativ që i afrohet barazisë gjinore jo vetëm në sasi, por edhe në cilësi. Megjithatë, prania e një pakice që shpreh dyshime për meritat tregon nevojën për transparencë më të madhe dhe komunikim efektiv mbi kriteret e përzgjedhjes dhe performancën e lidërshiptit, me qëllim përforcimin e besimit institucional.

Për të përforcuar këtë ide të anketuarve ju është drejtuar pyetja “*A ju ngarkojnë eprorët tuaj punë ose detyra që nuk kanë të bëjnë me përshkrimin e vendit tuaj të punës?*”. Përgjigjet e marra për këtë pyetje ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi perceptimin e respektimit të roleve profesionale në mjedisin universitar apo institucional. Përgjigjja më e shpeshtë është “Jo”, e zgjedhur nga 45.1% e të anketuarve, duke treguar se për një pjesë të konsiderueshme të të punësuarve, nuk ka ngarkesë me detyra që tejkalojnë përshkrimin formal të punës së tyre Figura 4. Ky është një tregues pozitiv për qartësinë e roleve dhe për respektimin e kufijve të pozicionit të punës nga ana e eprorëve.

Një përqindje tjetër relativisht e lartë 32.9% deklaroi se këto situata ndodhin “rrallë”, çka tregon se edhe kur ndodhin, janë përjashtime dhe jo pjesë e praktikës së rregullt institucionale. Në total, këto dy kategori përfaqësojnë 78% të të anketuarve, duke përforcuar idenë se devijimet nga përshkrimi formal i vendit të punës nuk janë të përhapura gjerësisht.

Figura 4. Shpeshësia e ngarkimit nga eprorët me punë/detyra që nuk kanë të bëjnë me përshkrimin e vendit të punës, në përqindje.




Ndërkohë, 15.1% e pjesëmarrësve deklarojnë se u ndodh “shpesh” të ngarkohen me detyra që nuk lidhen drejtpërdrejt me rolin e tyre. Kjo sugjeron se ekziston një segment jo i vogël i të punësuarve që përjetojnë tejkalime të kompetencave apo kërkesa jashtë detyrave zyrtare në baza të përsëritura, gjë që mund të ndikojë në ndjesinë e padrejtësisë ose mbingarkesës. Nga ana tjetër, vetëm një përqindje e vogël deklaron përvoja të shpeshta në këtë drejtim, vetëm 4.2% e të anketuarve janë përgjigjur “në shumicën e rasteve”, dhe 2.8% thonë “gjithmonë”, duke treguar një përjetim të vazhdueshëm të tejkalimit të detyrave formale. Edhe pse kjo është një pakicë, prania e këtyre përqindjeve sinjalizon nevojën për kujdes në zbatimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe për të garantuar ndarjen e qartë të përgjegjësiave.

Hipoteza 4. Universitetet ofrojnë mekanizma mbështetës që u mundësojnë stafit të balancojë detyrimet profesionale me ato familjare (p.sh., leje për arsye familjare, fleksibilitet orari, mbështetje gjatë situatave emergjente).

Përgjigjet e pyetjes që vlerëson ndihmën e universitetit në përballimin e detyrimeve jashtë vendit të punës, si lejet për arsye familjare apo

shëndetësore, reflektojnë një klimë organizative mbështetëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave personale të stafit. Nga përgjigjet e vlefshme, më e shpeshta është alternativa “Gjithmonë”, e zgjedhur nga 37.1% e të anketuarve, Figura 5. Kjo tregon një perceptim të lartë institucional të përshtatshmërisë dhe mirëkuptimit ndaj detyrimeve familjare apo sociale të punonjësve.

Figura 5. Shpeshtësia me të cilën universiteti lehtëson përballimin e detyrimeve jashtë vendit të punës, në përqindje.



Për më tepër, 25.1% e pjesëmarrësve deklarojnë se ndihma nga universiteti ofrohet “në shumicën e rasteve”, ndërsa 18.1% raportojnë se ndihmohen “shpesh”. Këto përgjigje sugjerojnë se për një shumicë të qartë të stafit, 80.3% në total, institucioni ofron mbështetje të konsiderueshme për të balancuar detyrimet profesionale dhe ato personale. Ky është një tregues i fortë i një mjedisi pune që i kushton rëndësi mirëqenies së punonjësve dhe praktikon politika të kujdesit social.

Në anën tjetër, një pjesë më e vogël e të anketuarve shpreh përvoja më pak pozitive: 13.2% deklarojnë se ndihma ofrohet “rrallë”, ndërsa vetëm 6.6% nuk kanë përjetuar fare mbështetje nga institucioni në këtë drejtim. Megjithatë përqindjet janë relativisht të ulëta, ato nuk janë të papërfillshme dhe sugjerojnë se në disa njësi apo raste individuale, fleksibiliteti institucional mund të jetë i pamjaftueshëm, ose ndoshta jo i aplikuar në mënyrë të

barabartë.

Përgjigjet tregojnë qartë se universiteti perceptohet si një institucion që në shumicën e rasteve mbështet stafin në menaxhimin e sfidave personale jashtë vendit të punës. Kjo praktikë është thelbësore për promovimin e barazisë gjinore, të drejtave familjare dhe mirëqenies së përgjithshme në punë. Megjithatë, për të garantuar qëndrueshmëri dhe drejtësi institucionale, është e nevojshme që politika të tilla të jenë të formalizuara, transparente dhe të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë punonjësit.

Për t'u thelluar më shumë si në hipotezën e tretë ashtu dhe në të katërtën të anketuarit janë pyetur nëse kanë përjetuar ndonjë dallim në të ardhurat e tyre apo të të tjerëve të bazuar në gjininë për pozita të ngjashme dhe aftësi të njëjta brenda Universitetit.


Rezultatet që trajtojnë perceptimin mbi dallimet gjinore në të ardhura për pozita dhe aftësi të ngjashme në universitet ofrojnë një panoramë domethënëse mbi ndjeshmërinë institucionale ndaj barazisë ekonomike gjinore. Nga përgjigjet e vlefshme, vlera më e shpeshtë është alternativa "Jo", e zgjedhur nga 65.1% e të anketuarve, Figura 6, çka tregon se një shumicë e qartë nuk ka përjetuar ose vërejtur diferenca në pagë të bazuara në gjini.

Ky rezultat sugjeron një perceptim dominues të drejtësisë dhe barazisë në kompensim, sidomos nëse pozitat dhe kompetencat janë të krahasueshme. Në një mjedis akademik, ku përparësia duhet t'i jepet meritës dhe përvojës profesionale, kjo ndjenjë barazie përbën një tregues pozitiv për politikën institucionale të pagesave.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve 18.4% raportojnë se kanë përjetuar "rrallë" dallime në të ardhura në bazë gjinie. Megjithëse këto raste nuk janë të shpeshta, prania e tyre sinjalizon se mund të ketë situata të izoluara, ose perceptime të ndikuara nga transparenca e kufizuar mbi strukturat e pagave. Kjo kategori ngre nevojën për vlerësim më të thelluar dhe krahasues institucional, veçanërisht në rastet ku dallimet mund të jenë të padukshme por të qëndrueshme. Në përfundim, rezulton se në shumicën e rasteve universiteti perceptohet si një institucion që ofron kompensim të drejtë dhe të barabartë, pa diskriminim gjinor.

Megjithatë, ekzistenca e një grupi të vogël që percepton ose përjeton përjashtime nga kjo rregullsi tregon nevojën për monitorim të vazhdueshëm, transparencë në struktura page dhe auditime të rregullta për të garantuar që barazia gjinore në të ardhura të mos mbetet thjesht një aspiratë.


Figura 6. Shpeshtësia e të përjetuarit e ndonjë dallimi në të ardhurat bazuar në gjini për pozita të ngjashme dhe aftësi të njëjtë, në përqindje.



Po ashtu, për t'u thelluar më shumë në hipotezën e tretë dhe në të katërtën të anketuarit janë pyetur sesa të interesuar janë për të ndryshuar vendin e punës për një pagë më të lartë dhe një përgjegjësi më të madhe në hierarkinë drejtuese të institucionit?

Përgjigjet e pyetjes që trajton interesimin për të ndryshuar vendin e punës në funksion të një pagë më të lartë dhe përgjegjësie më të madhe në hierarkinë drejtuese të institucionit reflektojnë një panoramë të ndarë mes stabilitetit në vendin aktual të punës dhe ambicies për zhvillim profesional. Nga 360 përgjigje të vlefshme, përgjigjja më e shpeshtë “Jo, nuk jam i interesuar”, e zgjedhur nga 28.3% e pjesëmarrësve, Figura 7. Kjo tregon se një pjesë dominuese e stafit është e orientuar drejt qëndrueshmërisë, ndoshta për shkak të kënaqësisë në vendin aktual të punës, përfitimeve jo-materiale, apo mungesës së motivimit për të ndryshuar mjedisin profesional.

Figura 7. Interesimi për të ndryshuar vendin e punës për një pagë më të lartë dhe një përgjegjësi më të madhe hierarkinë drejtuese.



Megjithatë, përtej kësaj prirjeje drejt qëndrueshmërisë, një segment i madh i pjesëmarrësve shfaq një interes potencial për ndryshim. 21.9% e të anketuarve deklarojnë se do të ishin të interesuar për të ndërruar punë nëse kanë mbështetje, ndërsa 18.5% janë gjithmonë të interesuar për një mundësi me më shumë përgjegjësi dhe pagë më të lartë. Këto të dhëna sugjerojnë ekzistencën e një baze të rëndësishme punonjësish të motivuar për avancim karriere, por që ndoshta i mungon qartësia ose siguria për të ndërmarrë një hap të tillë pa mbështetje institucionale.

Në të njëjtën linjë, 16.0% janë të interesuar “në shumicën e rasteve”, dhe 15.3% e përshkruajnë vendimin për të ndërruar punë si të vështirë. Këta tregues të ndërmjetëm pasqyrojnë një pasiguri të moderuar, ku dëshira për avancim profesional ekziston, por përplaset me faktorë si stabiliteti, mungesa e qartësisë në mundësitë e reja, ose kompleksiteti i marrjes së vendimeve në ambientin akademik apo institucional.

Në përfundim, edhe pse një shumicë relative e punonjësve nuk është e interesuar për të ndryshuar pozicion pune për shkak të pagës apo rolit drejtues, ekziston një potencial i konsiderueshëm për mobilitet dhe avancim, veçanërisht nëse ofrohen kushte të favorshme dhe mbështetje institucionale. Kjo sugjeron se universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë duhet të adresojnë këtë potencial nëpërmjet strategjive të qarta zhvillimi karriere,

strukturave transparente promovimi dhe paketave tërheqëse që mbajnë dhe motivojnë stafin e tyre më të aftë.

Rezultatet e studimit tregojnë një prirje përgjithësisht pozitive në lidhje me barazinë gjinore, megjithëse disa tensione të nënkuptuara mbeten të pranishme në perceptimet e stafit akademik. Shumica e pjesëmarrësve mohojnë ekzistencën e pengesave konceptuale të bazuara në gjini dhe raportojnë ndjesi të forta vlerësimi profesional të pavarura nga gjinia. Një pjesë e konsiderueshme e anketuesve e vlerëson pozitivisht angazhimin e drejtuesve për garantimin e barazisë, ndërsa përfaqësimi i grave në pozita drejtuese perceptohet në shumicën e rasteve si i merituar dhe i bazuar në aftësi. Megjithatë, identifikohen edhe raste të skepticitizmit, të cilat nënvizojnë nevojën për transparencë dhe komunikim më të qartë institucional dhe elementë që evidentojnë faktore të padukshme të pabarazisë gjinore. Duke u mbështetur në këto gjetje, pjesa në vijim paraqet konkluzionet përfundimtare të studimit si dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave universitare dhe forcimin e barazisë gjinore në nivelet drejtuese dhe akademike.

Në konkluzion të studimit, si pabarazia gjinore në tregun universitar shqiptar, si dhe analiza e tavanit të qelqtë, nuk merr fund me vetëm me një reformë apo një strategji të vetme. Ajo kërkon një kulturë të re institucionale, një ndërgjegjësim të thellë manaxherial dhe një përpjekje të përbashkët nga të gjitha nivelet e institucionit. Vetëm në këtë mënyrë, universitetet shqiptare do të mund të krijojnë një mjedis akademik ku gratë dhe burrat kanë jo vetëm të drejtën, por edhe realisht mundësinë për të arritur majat e karrierës së tyre, pa u ndalur në pengesa të padukshme, por të prekshme në çdo hap.

6. Konkluzione të përgjithshme për tavanin e qelqtë

Të dhënat e këtij studimi mbi barazinë gjinore në universitetet shqiptare zbulojnë një prani të qartë të një fenomeni të heshtur, por thellësisht ndikues në barazinë gjinore, atë të “tavanit të qelqtë”. Ky term, i cili nënkupton barrierat e padukshme që kufizojnë përparimin e grave në pozita të larta, nuk është vetëm një koncept teorik i huazuar nga literatura bashkëkohore, por një realitet që përjetohet konkretisht nga një përqindje e ndjeshme e grave në sistemin akademik shqiptar. Mendojmë se kjo vihet në dukje në elementët e mëposhtëm që analizoi studimi.

Njohja me konceptin e tavanit të qelqtë.

Një ndër treguesit më domethënës të pranisë së këtij fenomeni është fakti që gratë deklarojnë në përqindje më të lartë se burrat se janë të njohura me konceptin e “tavanit të qelqtë”. Kjo njohje nuk është vetëm njohje teorike, por vjen si rezultat i përvojave të akumuluar në mjedise ku, pavarësisht përgatitjes profesionale dhe përkushtimit, barrierat e padukshme mbeten të pakapërcyeshme për shumë gra që synojnë pozita të larta akademike apo drejtuese. Ndërsa burrat kanë më pak gjasa të identifikojnë ekzistencën e një tavan qelqi, kjo mospërputhje në njohje sugjeron se fenomeni nuk është i perceptueshëm në mënyrë të barabartë nga të dy gjinitë. Pikërisht për këtë arsye, ai shpeshherë injorohet nga strukturat institucionale, sepse nuk shihet si “problem i përgjithshëm”, por si përvojë subjektive e një grupi më të ndjeshëm. Kjo mospërputhje e perceptimit është vetë një element përforcues i ekzistencës së tavanit të qelqtë.

Mungesa e përfshirjes së grave në vendimmarrje strategjike dhe në specializime

Tavani i qelqtë manifestohet në disa forma konkrete në kontekstin universitar: mungesa e përfshirjes në vendimmarrje strategjike, vështirësia në marrjen e specializimeve apo projekteve ndërkombëtare që kërkojnë mobilitet, si dhe një prani e kufizuar në rrjetet akademike të elitës që shpesh ndikojnë në promovimet ndërkombëtare. Të dhënat tregojnë se një përqindje më e lartë e grave se burrat kanë ndjerë se gjinia e tyre ka qenë faktor pengues për përfitimin e specializimeve jashtë vendit. Kjo sugjeron një formë të heshtur të diskriminimit, e cila mund të lidhet me pritshmëritë familjare dhe shoqërore që bien disproporcionalisht mbi gratë, si dhe me mungesën e mbështetjes institucionale dhe shoqërore për të përballuar këto sfida. Ky është një ilustrim konkret i mënyrës si funksionon tavani i qelqtë: nuk ndalon në mënyrë eksplicite, por kufizon në mënyrë të padukshme dhe të vazhdueshme.

Promovimi institucional i grave

Promovimi institucional dhe rrugëtimi drejt gradave më të larta akademike (si Profesor i Asociuar apo Profesor) janë fusha ku tavani i qelqtë evidentohet me vështirësi. Kjo për faktin se sistemi shqiptar përmban kritere të qarta për promovim e titujve dhe gradave akademike. Përvoja e grave sugjeron se rrjetet informale, mbështetjet “e padukshme” dhe komunikimi joformal luajnë një rol të madh në shpejtesinë e arritjes së këtyre objektivave. Gratë

shpesh përjashtohen nga këto rrjete për arsye që lidhen me stereotipe gjinore apo për shkak të barrës që mbajnë jashtë universitetit, në një kohë që ligjërisht kanë barazmundësinë e realizimit të objektivave të tyre njesoj si burrat.

Mungesa e transparencës institucionale

Përjetimi i tavanit të qelqtë është i lidhur ngushtë edhe me mungesën e transparencës institucionale. Kur informacioni mbi procedurat e promovimit nuk është i qartë, kur kriteret nuk aplikohen njesoj për të gjithë, dhe kur vendimet merren në mënyrë të centralizuar pa konsultim, atëherë krijohen hapësira për përjashtim dhe diskriminim të heshtur. Gratë, për shkak të përjashtimit më të hershëm nga strukturat e pushtetit institucional, ndihen më të ekspozuara ndaj këtij fenomeni.

Mungesa e roleve femërore në pozitat më të larta akademike e drejtuese

Një tjetër faktor që forcon egzistencën e tavanit të qelqtë është mungesa e roleve femërore në pozitat më të larta akademike dhe drejtuese. Në tërësinë e institucioneve universitare shqiptare vetëm 3 gra janë Rektore në një kohë që numri i grave në institucione është më i madh se i burrave. Kur studentet dhe stafi i ri femër nuk shohin gra në majat e karrierës, krijohet ideja e heshtur se këto pozita nuk janë realisht të arritshme për to. Kjo mungesë përfaqësimi nuk është vetëm pasojë e pabarazisë, por ajo është një mekanizëm që e riprodhon atë në brezat e ardhshëm. Edhe vetë gratë që arrijnë pozita drejtuese shpesh përballen me sfida të dyfishta: nga njëra anë, duhet të justifikojnë vendin e tyre përtej të zakonshmes dhe nga ana tjetër, nuk përfshihen gjithmonë në mënyrë të plotë në vendimmarrje thelbësore. Kjo gjëndje përforcon idenë e “përfshirjes simbolike”, ku gratë lejohen të hyjnë në struktura të caktuara, por pa ndikim real. Ky është një tjetër version i tavanit të qelqtë më i rafinuar, por po aq pengues.

Rrjetëzimi profesional dhe ndërkombëtarizimi

Rrjetëzimi profesional dhe ndërkombëtarizimi janë gjithashtu elementë kyç. Gratë duhet të kenë akses të barabartë në projekte, konferenca, publikime dhe rrjete akademike. Të dhënat tregojnë se mungesa e aksesit në këto hapësira është një nga format më të sofistikuar të tavanit të qelqtë, sepse ajo ndodh pa zhurmë dhe pa një akt të qartë përjashtimi. Jo me kot në universitete ekzistojnë më shumë gra se burra që pranojnë që gjinia dhe detyrimet

familjare shpesh pengojnë specializimet jashtë shtetit dhe lidhjet ndërkombëtare.

7. Kufizimet e studimit

Ashtu si çdo kërkim empirik me bazë të dhëna sasiore, edhe ky studim mbart disa kufizime që duhen marrë në konsideratë në interpretimin e rezultateve. Një ndër kufizimet kryesore lidhet me faktin se studimi nuk është realizuar në formën e një censusi të plotë, por mbi bazën e një kampioni të përzgjedhur nga popullata e synuar e stafit akademik në universitetet publike dhe private të Shqipërisë. Si rrjedhojë, rezultatet pasqyrojnë perceptimet e një pjese përfaqësuese të kësaj popullsie, por nuk mund të pretendohet se ato janë plotësisht të përgjithshëm për të gjithë universitetin akademik kombëtar.

Një tjetër kufizim i lidhur me këtë aspekt është rreziku i paragjykimeve të përzgjedhjes (sampling bias). Duke qenë se pjesëmarrja në anketim ka qenë vullnetare, është e mundur që individët me interes më të lartë për çështjet e barazisë gjinore, ose me përvoja më të theksuara pozitive apo negative, të kenë qenë më të prirur për të marrë pjesë. Kjo situatë mund të ketë ndikuar në drejtimin e përgjithshëm të rezultateve, duke i dhënë atyre një ngjyrim të caktuar perceptues. Megjithatë, shpërndarja e pyetësorit në mënyrë censi në të gjitha universitetet, si publike ashtu edhe private, ndihmon në zbutjen e këtij rreziku dhe kontribuon në rritjen e përfaqësueshmërisë së të dhënave.

Në përmbledhje, këto kufizime nuk e zbehin rëndësinë dhe vlefshmërinë e studimit, por ndihmojnë në kornizimin realist të rezultateve dhe në përcaktimin e drejtimeve të ardhshme të kërkimit. Ato theksojnë nevojën për studime të ardhshme më gjithëpërfshirëse, që të kombinojnë qasje sasiore dhe cilësore, me qëllim arritjen e një kuptimi më të thelluar dhe të balancuar të dinamikës gjinore në arsimin e lartë shqiptar.

Literatura

- ASCAL (Quality Assurance Agency in Higher Education, Albania)
<https://ascal.al/en/>
- Bailyn, L. (2003) "Academic careers and gender equity: Lessons learned from MIT" *Gender, Work and Organizations*, Vol.10 No.2, March 2003.
- Becker, G. S. (1957). *The Economics of Discrimination*. University of Chicago Press.

- Becker, G. S. (1964). *Human Capital*. University of Chicago Press.
- Bejleri, E., Memaj, G., & Kraja, Y. (2025). Invisible walls: Employment struggles of women with limited education in Albania. *International Journal of Sustainable Development and Planning*, 20(5), 2235-2243. doi:10.18280/ijstdp.200538
- Bellotti, E., Czerniawska, D., Everett, M. & Guadalupi, L. (2022). Gender inequalities in research funding: Unequal network configurations, or unequal network returns. *Social Networks*, 70, 138-151. <https://doi.org/10.1016/j.socnet.2021.12.007>
- Charles, K. K., & Guryan, J. (2008). Prejudice and wages: An empirical assessment of Becker's theory. *Journal of Political Economy*, 116(5), 773–809. doi:10.1086/593073
- Dhëmbo, E. & Vrbaški, S. (2024). Women's labour market participation & security for human rights defenders: women's rights in Western Balkans 2024. The Kvinna till Kvinna Foundation,. Gjetur në <https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2024/11/The-Kvinna-till-Kvinna-Foundation-Womens-Rights-in-Western-Balkans-2024.pdf>
- European Commission. (2021). *She Figures 2021: Gender in research and innovation*. Publications Office of the EU. Gjetur në <https://projects.research-and-innovation.ec.europa.eu/en/knowledge-publications-tools-and-data/interactive-reports/she-figures-2021>
- European Commission. (2024). *She Figures 2024: Gender in research and innovation — statistics and indicators*. European Union. Gjetur në <https://projects.research-and-innovation.ec.europa.eu/en/knowledge-publications-tools-and-data/intera>
- Goldin, C. (2014). A Grand Gender Convergence: Its Last Chapter. *American Economic Review*, 104(4), 1091–1119. doi:10.1257/aer.104.4.1091
- INSTAT. (2025). *Gratë dhe Burrat në Shqipëri*. TIRANA: INSTAT.
- Levy, S. P., & Lemeshow, S. (2008). *Sampling of populations* (4th ed.). Wiley.
- McKinsey (2015). *The Power of Parity: Advancing women's equality in the United Kingdom (and global MGI report)*. McKinsey Global Institute.
- Mincer, J. (1974). Schooling, Experience, and Earnings. Në J. A. Mincer, *Schooling and Earnings* (fv. 41-63). NBER. Gjetur në <https://www.nber.org/books-and-chapters/schooling-experience-and-earnings>.
- Oakley, J. G. (2000). Gender-based barriers to senior management positions: Understanding the scarcity of female CEOs. *Journal of Business Ethics*, 27(4), 321–334. <https://doi.org/10.1023/A:1006402117024>
- UN Women. (2023). 'Të Rejat dhe të Rinjtë për Përfshirje, Barazi dhe Besim'. Studim nga UNDP, UNFPA, UNESCO dhe UN Women.

World Bank. (2020). *Toward gender equality in Albania: Shifting mindsets through institutional reform*. <https://www.worldbank.org/en/results/2020/06/19/toward-gender-equality-in-albania-shifting-mindsets-through-institutional-reform>

Si munden hipermarketet shqiptare të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm?

Ersiela Sulejmani ^{a,8}, Florjan Bombaj ^a

^aUniversiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Përmbledhja

Ky artikull fokusohet tek rasti i hipermarketit Megatek në Shqipëri, duke analizuar mënyrat në të cilat ai kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm përmes strategjive të ndryshme, si reduktimi i mbetjeve, përdorimi i burimeve të rinovueshme, inkurajimi i konsumit të përgjegjshëm dhe mbështetja e iniciativave të komunitetit. Për këtë qëllim, Megatek është marrë si rast studimi, duke u analizuar politikat dhe praktikrat e tij për qëndrueshmëri. Janë përdorur anketa me menaxherët dhe klientët e Megatek, së bashku me të dhëna të mbledhura nga dokumente dhe burime të brendshme, për të shqyrtuar ndikimin dhe rezultatet e masave të ndërmarra. Rezultatet tregojnë se Megatek ka investuar në programe si reduktimi i konsumit të energjisë, ofrimi i produkteve ekologjike dhe edukimi i klientëve për një mënyrë jetese më të qëndrueshme. Ky artikull kontribuon në literaturën ekzistuese mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe shërben si model për praktikrat e qëndrueshme në sektorin e shitjeve me pakicë.

Fjalë kyçe: hipermarket; zhvillimi i qëndrueshëm; rast studimi; Megatek

Abstract

This article focuses on the case of the Megatek hypermarket in Albania, analyzing the ways in which it contributes to sustainable development through various strategies, such as reducing waste, using renewable resources, encouraging responsible consumption and supporting community initiatives. For this purpose, Megatek is taken as a case study, analyzing its sustainability policies and practices. Interviews with Megatek managers and customers, along with data collected from documents and internal sources, are used to examine the impact and results of the

⁸ KONTAKT: ersiela.sulejmani@umsh.edu.al

measures taken. The results show that Megatek has invested in programs such as reducing energy consumption, offering ecological products and educating customers about a more sustainable lifestyle. This article contributes to the existing literature on sustainable development and serves as a model for sustainable practices in the retail sector.

Keywords: hypermarket; sustainable development; case study; Megatek

1. Hyrje

Përcaktimi i zhvillimit të qëndrueshëm kërkon referimin tek origjina e tij dhe formulimin e sugjeruar nga Raporti Brundtland⁹ (1984) si zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre. Ky përkufizim i gjerë nuk lejon gjithmonë një përkufizim të saktë të konceptit, pasi ai përshkruhet si një ide elastike së cilës të gjithë mund t'i atribuojnë një kuptim specifik. Për këtë arsye, disa akademikë sugjerojnë një përkufizim më të përshtatshëm për sferën ekonomike, duke e konsideruar zhvillimin e qëndrueshëm si një qasje e biznesit që gjeneron fitime duke mbrojtur njerëzit dhe planetin (Connelly et al., 2011). Një përmbledhje e literaturës mbi shpërndarjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm zbulon se hulumtimet përqendrohen kryesisht në ndikimin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm tek konsumatorët. Disa studime shqyrtojnë marrëdhënien midis iniciativave të qendrave tregtare me përgjegjësi sociale dhe tërheqjes së tyre ndaj konsumatorëve (Oppewal et al., 2006), ose në sjelljen blerëse të konsumatorëve. Ndërsa këto studime theksojnë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm në shitjen me pakicë, ato nuk përqendrohen posaçërisht te shitësit me pakicë të pavarur. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe shpërndarja përmes kanaleve kanë një ndërveprim kompleks me aspektet sociale, mjedisore dhe ekonomike. Rezultatet e qëndrueshmërisë së zinxhirëve të furnizimit ndikohen ndjeshëm nga kanalet e shpërndarjes, të cilat variojnë nga zinxhirët e shkurtër të furnizimit me ushqime deri tek sistemet shumëkanalëshe. Disa Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të tilla si konsumi dhe prodhimi i përgjegjshëm, veprimi për

⁹ <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/5987our-common-future.pdf>

klimën, dhe inovacioni në industri, lidhen drejtpërdrejt me praktikën e shpërndarjes së qëndrueshme (Cammarano et al., 2022).

Duke shfrytëzuar madhësinë, shtrirjen e konsumatorëve dhe ndikimin në zinxhirin e furnizimit, hipermarketet kanë potencial të madh për të çuar përpara zhvillimin e qëndrueshëm. Përvetësimi i praktikave të qëndrueshme, furnizimi etik, inovacioni teknologjik dhe kultivimi i ndërgjegjësimit dhe besnikërisë së klientit janë taktika të rëndësishme. Hipermarketet mund të zvogëlojnë ndikimin e tyre në mjedis dhe shpenzimet operative duke zbatuar ndriçim dhe ftohje me efikasitet energjetik, duke ulur përdorimin e plastikës me një përdorim dhe duke rritur riciklimin dhe kompostimin (Marín-García et al., 2023). Gjurmët e karbonit zvogëlohen më tej duke kaluar në burime të rinovueshme të energjisë si panelet diellore. Kur kombinohet me komunikim dhe edukim të qartë, promovimi i mallrave dhe praktikave miqësore me mjedisin mund të rrisë besnikërinë e konsumatorit dhe të nxisë besimin. Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë se si hipermarketet mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, duke marrë rastin e Megatek si një shembull konkret në Shqipëri. Megatek, si një nga hipermarketet më të mëdha në vend, përfaqëson një aktor të rëndësishëm në tregun vendas dhe një kontribues potencial për praktika të qëndrueshme. Ky artikull shqyrton masat që ky hipermarket ka ndërmarrë në drejtim të reduktimit të mbetjeve, promovimit të konsumit të përgjegjshëm, përdorimit të burimeve të ripërtëritshme dhe mbështetjes së iniciativave të komunitetit.

2. Rishikimi i literaturës

Zhvillimi i qëndrueshëm në sektorin e shitjeve është një temë e diskutuar gjerësisht në literaturën shkencore. Hipermarketet, si aktorë kryesorë në këtë sektor, përballen me sfidën e balancimit midis kërkesave për rritje ekonomike dhe përgjegjësi për ruajtjen e mjedisit dhe mirëqenien sociale. Shumë studime kanë theksuar rëndësinë e strategjive të qëndrueshmërisë për të reduktuar ndikimet mjedisore dhe për të inkurajuar konsumatorët drejt blerjeve më të përgjegjshme. Markimi dhe etiketimi ekologjik përmirësojnë besueshmërinë, besueshmërinë dhe imazhin e një marke. Kjo i ndihmon firmat të dallohen në tregjet konkurruese dhe të tërheqin njerëzit që kujdesen për mjedisin. Kompanitë që shihen si të vetëdijshme për mjedisin kanë më shumë gjasa të marrin informacion pozitiv nga goja në gojë, avokim nga konsumatorët dhe besnikëri, të cilat të gjitha rrisin reputacionin e tyre (Li,

2025; Panda et al., 2020). Fushatat për edukimin e konsumatorëve dhe kuptimin e efekteve mjedisore nxisin qëndrimet miqësore me mjedisin, qëllimet për të blerë dhe blerjet aktuale të artikujve të gjelbër (Kuźniar et al., 2021). Veçanërisht midis konsumatorëve më të rinj dhe më të informuar, ndërgjegjësimi për produktet ekologjike dhe avantazhet e tyre inkurajon blerje më të menduara (Lee & Hung, 2024). Besnikëria afatgjatë dhe rritja e qëllimeve të blerjes nxiten nga marketingu i gjelbër dhe komunikimi i hapur rreth qëndrueshmërisë. Përfshirja e produkteve miqësore me mjedisin dhe edukimi i klientëve rreth efekteve të tyre përmirëson ndjeshëm reputacionin e markës dhe inkurajon sjellje më të qëndrueshme të konsumatorëve. Këto taktika janë thelbësore për kompanitë që shpresojnë të kenë sukses në industrinë e fokusuar në qëndrueshmëri në planin afatgjatë, sepse ato nxisin besnikërinë dhe besimin.

Në mënyrë të ngjashme, Chen & Lee (2019) argumentojnë se adoptimi i praktikave të qëndrueshme, si përdorimi i energjive të rinovueshme dhe reduktimi i mbetjeve, rrit efikasitetin operacional dhe ul kostot afatgjata për bizneset. Ata theksojnë se këto praktika nuk përmirësojnë vetëm reputacionin e kompanisë, por gjithashtu kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme të biznesit dhe në krijimin e avantazheve konkurruese. Ky përfundim sugjeron që ndërmarrjet që adoptojnë qasje të tilla kanë më shumë gjasa të qëndrojnë konkurruese në tregun modern. Ruajtja e energjisë dhe ujit, përdorimi i energjisë së rinovueshme dhe reduktimi i mbetjeve janë shembuj të iniciativave për efikasitetin e burimeve që përmirësojnë drejtpërdrejt procedurat operative dhe ulin konsumin e burimeve, duke rezultuar në rritjen e efikasitetit si në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ashtu edhe në bizneset më të mëdha (Majid et al., 2023). Teknologjitë e përparuara (si Internet of Things, Inteligjenca Artificiale dhe mësimi automatik) dhe sistemet e menaxhimit të energjisë optimizojnë më tej përdorimin e energjisë, thjeshtojnë proceset dhe lehtësojnë vendimmarrjen efikase në kohë reale (Horzela-Miś et al., 2025). Duke u bazuar në literaturën më të fundit dhe problematikën e pa-eksploruar më parë në Shqipëri në lidhje me praktikën për zhvillim të qëndrueshëm të aplikuara nga hipermarketet ky artikull tenton të përgjigjet pyetjes se cilat janë praktikën aktuale konkrete të qëndrueshmërisë të implementuara nga Megatek10.

¹⁰ Për informacione më të detajuara cfr. Sulejmani, E. (2025). *Si munden Hipermarketet të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm: rasti Megatek*. Temë diplome Master i Shkencave, Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë", fq. 61, Tiranë, Shqipëri.

3. Qasja metodologjike dhe dizajni i kërkimit

Përzgjedhja e Megatek¹¹ si rast studimor për këtë hulumtim është bërë mbi baza të argumentuara dhe të lidhura ngushtë me objektivat e kërkimit. Megatek përfaqëson një nga hipermarketet më të mëdha dhe më të konsoliduara në Shqipëri, me një shtrirje të gjerë gjeografike dhe një ndikim të konsiderueshëm në sektorët e ndërtimit, mobilimit dhe tregtimit të produkteve për shtëpi. Si një kompani me një rrjet të gjerë furnizuesish dhe një bazë të madhe konsumatorësh, Megatek është në pozitë të favorshme për të reflektuar trendet dhe qasjet moderne në menaxhimin e qëndrueshëm të biznesit.

Studimi i Megatek si rast i vetëm (single-case study) i mundëson hulumtuesit të zbrësë në një nivel të detajuar të analizës, duke ekzaminuar në mënyrë gjithëpërfshirëse strukturën organizative, politikat e brendshme dhe rezultatet e matshme të praktikave të aplikuara. Për më tepër, përmasa dhe kompleksiteti i funksionimit të Megatek mundëson eksplorimin e qëndrueshmërisë në disa nivele – nga vendimmarrja strategjike e menaxhimit të lartë, deri te ndërveprimi me klientët dhe furnizuesit. Në këtë mënyrë, ky rast paraqet një mundësi të vlefshme për të gjeneruar njohuri të thelluara dhe për të nxjerrë rekomandime me aplikueshmëri më të gjerë në sektorin e shitjeve me pakicë në Shqipëri dhe më tej.

Elementët që e bëjnë këtë subjekt të përshtatshëm për një studim të thelluar përfshijnë ndërmarrjen e një sërë iniciativash që synojnë të reduktojnë ndikimin negativ në mjedis dhe të rrisin përgjegjësinë sociale korporative. Këto përfshijnë, ndër të tjera, përdorimin e ndriçimit LED në ambientet e brendshme dhe të jashtme, ofrimin e produkteve me etiketime ekologjike, minimizimin e përdorimit të plastikës në proceset e paketimit, si dhe angazhimin aktiv në projekte të komunitetit lokal. Këto praktika tregojnë qartësisht përpjekjet e kompanisë për të harmonizuar qëllimet tregtare me parimet e qëndrueshmërisë.

Për këtë kërkim janë përdorur metoda të mikse cilësore dhe sasiore. U kryen vëzhgime në Megatek për të analizuar praktikat e zhvillimit të qëndrueshëm si edhe u morën fotografi. Më pas, u zhvilluan intervista gjysmë të strukturuar me drejtorë të departamenteve dhe stafit të Megatek. Udhëzuesi i intervistës u strukturua rreth rolit të menaxherëve, strategjitë e ndjekura nga Megatek si edhe veprimet e zbatuara në dyqan. U anketuan gjithashtu rastësisht 100 klientë të përzgjedhur rastësisht brenda ambienteve të Megatek midis prillit 2025 dhe majit 2025, me qëllim vlerësimin e

¹¹ <https://www.megateksa.com/sq/>

perceptimit të tyre mbi masat për qëndrueshmëri, ndikimin në sjelljen e konsumit dhe nivelin e ndërjegjësimit mbi zhvillimin e qëndrueshëm. U krye gjithashtu edhe analiza e dokumentacionit zyrtar ku përfshihen dokumente të brendshme të kompanisë (raporte vjetore, nisma të përgjegjësive sociale të kompanisë), publikime në media, si dhe faqes zyrtare në internet të Megatek për të kuptuar evolucionin e qasjes së tyre ndaj qëndrueshmërisë ndër vite. Procesi i analizës së të dhënave u zhvilluar në përputhje me natyrën dhe tipologjinë e informacionit të mbledhur. Të dhënat u kategorizuan në tre grupe kryesore: të dhëna sasiore nga anketat, të dhëna cilësore nga intervistat dhe dokumentacioni zyrtar nga burime të brendshme dhe publike të Megatek. Të dhënat nga anketat janë analizuar duke përdorur metoda statistikore deskriptive.

4. Gjetjet kryesore

4.1 Qëndrueshmëria energjitike

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 1 tregojnë qartë një trend të qëndrueshëm në rënie të konsumit të energjisë elektrike në hipermarketin Megatek gjatë periudhës katërvjeçare 2021–2024. Në vitin 2021, konsumi total i energjisë elektrike ishte 1,250,000 kWh, ndërsa deri në fund të vitit 2024 kjo sasi kishte rënë ndjeshëm në 960,000 kWh. Ky ndryshim përfaqëson një reduktim të përgjithshëm prej rreth 23%, duke sinjalizuar një përmirësim domethënës në eficiencën energjetike të kompanisë gjatë kësaj periudhe.

Tabela 1. Konsumi i energjisë elektrike në Megatek (2021–2024)

Viti	Konsumi (kWh)	Ndryshimi (%)
2021	1,250,000	—
2022	1,200,000	-4%
2023	1,080,000	-10%
2024	960,000	-11%

Burimi: Autorët

Vlen të theksohet se ulja e konsumit të energjisë nuk ka qenë e rastësishme apo e përqendruar vetëm në një vit të caktuar, por ka pasur një trend të vazhdueshëm dhe progresiv çdo vit. Në vitin 2022, krahasuar me 2021, u regjistrua një ulje prej 4%, duke shënuar fillimin e përpjekjeve të qëndrueshme për të reduktuar konsumin. Ky trend pozitiv u përforcua edhe më tej në vitin 2023, ku u arrit një reduktim më i theksuar prej 10%, ndërkohë që në vitin 2024 u regjistrua një tjetër ulje mbresëlënëse prej 11% krahasuar

me vitin pararendës. Këto rezultate janë tregues i qartë i përkushtimit serioz të Megatek për të avancuar drejt objektivave të qëndrueshmërisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore.

Ka shumë gjasa që ky progres të jetë rezultat i një sërë masash strategjike të ndërmarra nga kompania. Ndër më të rëndësishmet mund të përmenden instalimi i sistemeve ndriçuese LED, të cilat janë më efikase dhe konsumojnë më pak energji se ndriçimi tradicional, si dhe automatizimi i sistemeve elektrike që lejon një menaxhim më të zgjuar dhe më të optimizuar të konsumit të energjisë. Gjithashtu, përdorimi i pajisjeve me konsum të ulët të energjisë dhe organizimi i fushatave të brendshme për sensibilizimin e stafit mbi rëndësinë e përdorimit racional të energjisë kanë luajtur rol thelbësor në arritjen e këtyre rezultateve. Përfitimet e këtyre përmirësimeve janë të shumëfishta. Përveç ndikimit pozitiv mjedisor, siç është reduktimi i emetimeve të CO₂, Megatek ka arritur gjithashtu të ulë ndjeshëm kostot operative, duke përmirësuar rentabilitetin e përgjithshëm të kompanisë. Ky model i suksesshëm mund të shërbejë si një shembull frymëzues për ndërmarrje të tjera në sektorin e shitjeve me pakicë në Shqipëri, të cilat mund të adoptojnë praktika të ngjashme për të kombinuar qëllimet ekonomike me përgjegjësinë mjedisore.

4.2 Qëndrueshmëria mjedisore

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 2 ofrojnë një pasqyrë të qartë dhe të detajuar mbi përpjekjet e vazhdueshme të Megatek për të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme mbetjet e padobishme gjatë periudhës 2022–2024. Gjatë kësaj periudhe trevjeçare, vihet re një tendencë pozitive e reduktimit të volumit total të mbetjeve të krijuara nga aktivitetet e kompanisë. Në vitin 2022, Megatek raportoi një total prej 110 ton mbetje, një shifër që u ul në 100 ton gjatë vitit 2023, dhe më tej në 95 ton në vitin 2024. Ky progres përfaqëson një ulje të përgjithshme prej rreth 13.6%, e cila tregon qartë përmirësimin e ndjeshëm të praktikave të menaxhimit të mbetjeve dhe përkushtimin e kompanisë për të reduktuar ndikimin e saj mjedisor.

Tabela 2. Reduktimi i mbetjeve të padobishme (në ton)

Viti	Mbetje totale	Mbetje të ricikluara	% e riciklimit
2022	110	25	23%
2023	100	32	32%
2024	95	40	42%

Burimi: Autorët

Përveç uljes së sasisë totale të mbetjeve, një aspekt veçanërisht domethënës është rritja e ndjeshme e sasisë së mbetjeve të ricikluara gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2022, vetëm 25 ton mbetje u dërguan për riciklim, ndërsa kjo shifër u rrit në 32 ton në vitin 2023, dhe më tej arriti në 40 ton në vitin 2024. Kjo rritje nuk është vetëm numerike, por përkthehet gjithashtu në një përmirësim domethënës të përqindjes së riciklimit në raport me sasinë totale të mbetjeve. Konkretisht, përqindja e riciklimit është rritur nga 23% në 2022, në 32% në vitin 2023, dhe ka arritur në një nivel mbresëlënës prej 42% në vitin 2024. Ky progres sinjalizon qartë se Megatek po e trajton menaxhimin e mbetjeve jo thjesht si një detyrim ligjor, por si një pjesë integrale të strategjisë së saj për qëndrueshmëri.

Këto rezultate premtuese sugjerojnë që Megatek ka ndërmarrë një sërë masash konkrete për të arritur këto përmirësime. Masa të tilla ka të ngjarë të përfshijnë instalimin e pikave të veçanta për grumbullimin dhe ndarjen e mbetjeve sipas llojit, trajnimin e stafit për rëndësinë e menaxhimit të duhur të mbetjeve, dhe krijimin e partneriteteve me kompani të specializuara në fushën e riciklimit. Përveç përfitimeve mjedisore, këto iniciativa mund të kenë gjithashtu ndikime pozitive në aspektin financiar, duke reduktuar kostot e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve në afat të gjatë.

4.3 Qëndrueshmëria në investime

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 3 japin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të angazhimit të Megatek ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, përmes investimeve të strukturuar në fusha kyçe gjatë periudhës 2022–2024. Në total, kompania ka alokuar një shumë prej €111,500 të dedikuar për katër kategori që lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e qëndrueshmërisë së saj: ndriçim LED, riciklim dhe menaxhim të mbetjeve, projekte sociale dhe trajnime për stafin. Ky plan investimesh reflekton qartë një strategji të mirëmenduar që synon jo vetëm të përmbushë detyrimet mjedisore dhe sociale, por edhe të ndërtojë një avantazh konkurrues afatgjatë për kompaninë.

Në vitin 2022, vëmendja kryesore ishte përqendruar te përmirësimi i sistemit të ndriçimit nëpërmjet teknologjisë LED, me një investim prej €20,000. Kjo shifër përfaqësonte pjesën më të madhe të shpenzimeve për atë vit dhe tregonte qartë prioritetin e kompanisë për të reduktuar konsumin e energjisë dhe për të rritur efikasitetin energjetik. Në vitet pasuese, investimi në këtë kategori u reduktua ndjeshëm, duke zbritur në vetëm €5,000 në vitin

2024. Kjo ulje nënkupton se infrastruktura e ndriçimit LED është konsoliduar, dhe tashmë kërkon vetëm shpenzime për mirëmbajtje dhe optimizime të vogla.

Tabela 3. Investimet në qëndrueshmëri (2022–2024), euro

Fusha e investimit	2022	2023	2024
Ndriçim LED	20,000	10,000	5,000
Riciklim & Menaxhim mbetjesh	8,000	10,000	12,000
Projekte sociale	5,000	6,000	7,000
Trajnime për stafin	2,000	2,500	3,000

Burimi: Autorët

Në të kundërt, investimet në riciklim dhe menaxhim të mbetjeve kanë treguar një tendencë të vazhdueshme rritjeje gjatë kësaj periudhe. Nga €8,000 në vitin 2022, kjo kategori ka arritur në €12,000 në vitin 2024, duke reflektuar fokusin e shtuar të kompanisë në përmirësimin e proceseve të menaxhimit mjedisor dhe rritjen e përqindjes së riciklimit të mbetjeve. Ky është një tregues i qartë se Megatek po përpiqet të ndërtojë një kulturë të fortë të qëndrueshmërisë brenda operacioneve të saj.

Po ashtu, investimet në projekte sociale kanë shënuar një rritje të qëndrueshme, nga €5,000 në vitin 2022 në €7,000 në 2024. Kjo rritje nënvizon përkushtimin e Megatek për të forcuar marrëdhëniet me komunitetin dhe për të kontribuar në zhvillimin shoqëror përtej angazhimeve të saj të drejtpërdrejta ekonomike. Ndërkohë, investimet në trajnimin e stafit janë rritur në mënyrë modeste, por të qëndrueshme – nga €2,000 në vitin 2022 në €3,000 në 2024. Kjo tregon vlerësimin e Megatek për rëndësinë e zhvillimit të kapaciteteve të brendshme dhe përgatitjen e stafit për të zbatuar praktikatat më të mira të qëndrueshmërisë në aktivitetet e përditshme të kompanisë.

4.4 Qëndrueshmëria e produkteve

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 4 japin një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse të zgjerimit të ofertës së produkteve ekologjike në Megatek, sipas katër kategorive kryesore: pastrimi, ndriçimi, elektroshtëpiaket dhe mobiljet. Ky zgjerim përbën një hap domethënës në drejtim të përforcimit të qëndrueshmërisë në sektorin e shitjeve me pakicë, duke reflektuar qartë tendencat globale drejt konsumit më të përgjegjshëm dhe miqësor ndaj

mjedisit. Megatek ka treguar vullnetin për të ndjekur dhe për t'iu përshtatur kërkesave gjithnjë e më të mëdha të konsumatorëve për produkte që ofrojnë më pak ndikim negativ mjedisor dhe që kontribuojnë në ruajtjen e burimeve natyrore.

Tabela 4. Produktet ekologjike në ofertë

Kategori	Nr. i produkteve ekologjike	Rritja (krahasuar me 2022)
Pastrimi	120	+20%
Ndriçim	85	+15%
Elektroshtëpiake	60	+25%
Mobilje	45	+12%

Burimi: Autorët

Kategoria më e pasur mbetet ajo e produkteve të pastrimit, me një ofertë prej 120 artikujsh të etiketuara si ekologjike dhe me një rritje të konsiderueshme prej +20% krahasuar me vitin 2022. Ky zgjerim pasqyron një vetë-ndërgjegjësim gjithnjë e më të lartë të konsumatorëve për rëndësinë e përdorimit të produkteve të sigurta, jo vetëm për shëndetin personal, por edhe për ruajtjen e mjedisit në shtëpi dhe në hapësirat e përbashkëta. Rritja tregon gjithashtu që Megatek ka ditur të reagojë ndaj këtyre pritshmërive, duke zgjeruar gamën e produkteve miqësore me ambientin.

Pas kësaj kategorie, ndjek ndriçimi me 85 produkte ekologjike dhe një rritje prej +15%. Kjo pasqyron qartë përpjekjet e vazhdueshme të kompanisë për të promovuar përdorimin e teknologjisë LED dhe zgjidhjeve të tjera për ndriçim që karakterizohen nga efikasiteti energjetik dhe jetëgjatësia më e madhe e produkteve. Rritja në këtë kategori tregon se Megatek po ndjek me vëmendje trendet e tregut që lidhen me reduktimin e konsumit të energjisë dhe zvogëlimin e gjurmës së karbonit.

Në kategorinë e elektroshtëpiakeve, pavarësisht se numri total është më i ulët — 60 produkte — është shënuar rritja më e lartë relative prej +25%. Kjo është tregues i përfshirjes në ofertë të pajisjeve moderne me klasifikim energjie A++ dhe teknologji të avancuara që reduktojnë ndjeshëm konsumin e energjisë dhe ndihmojnë në ruajtjen e burimeve natyrore, duke e bërë këtë kategori një ndër më premtueset për të ardhmen.

Ndërkohë, mobiljet kanë përjetuar një rritje më të moderuar prej +12%, duke përfaqësuar një segment të qëndrueshëm që përfshin produkte të prodhuara nga materiale të riciklueshme dhe të certifikuara për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve, siç është rasti me certifikimin FSC. Ky është një hap

i rëndësishëm drejt zgjerimit të një oferte që respekton ekosistemet natyrore dhe promovon një qasje më të përgjegjshme ndaj prodhimit.

4.5 Klientët dhe qëndrueshmëria e perceptuar

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 5 ofrojnë një pasqyrë të qartë dhe të vlefshme mbi nivelin e ndërgjegjësimit dhe perceptimit që klientët e Megatek kanë në lidhje me politikat e qëndrueshmërisë të zbatuara nga kompania. Ky feedback është thelbësor për përmirësimin e mëtejshëm të strategjive të komunikimit dhe ofertës së produkteve të qëndrueshme. Fillimisht, është inkurajuese të vërehet se 65% e të anketuarve janë të informuar për politikat e qëndrueshmërisë që Megatek ka ndërmarrë. Ky rezultat tregon se përpjekjet e kompanisë për të komunikuar këto nisma përmes kanaleve të ndryshme, si fushatat e marketingut, sinjalistika e brendshme në dyqan dhe ndoshta edhe media sociale, kanë qenë efektive në rritjen e ndërgjegjësimit të klientëve. Një nivel i tillë informimi krijon bazën për ndërtimin e një marrëdhënieje më të qëndrueshme midis kompanisë dhe konsumatorëve.

Tabela 5. Perceptimi i klientëve mbi politikat e qëndrueshmërisë

Pyetja	Përgjigje Po (%)
A jeni të informuar për politikat e qëndrueshmërisë?	65%
A ndikojnë ato në vendimin tuaj për të blerë?	40%
A mendoni se Megatek kontribuon në ruajtjen e mjedisit?	58%
A do të preferonit produkte ekologjike në të ardhmen?	73%

Burimi: Autorët

Megjithatë, vetëm 40% e klientëve të pyetur pohojnë se politikat e qëndrueshmërisë ndikojnë drejtpërdrejt në vendimet e tyre të blerjes. Kjo tregon se ekziston ende një hendek midis ndërgjegjësimit dhe sjelljes së vërtetë konsumatore. Ky rezultat sugjeron se Megatek mund të eksplorojë mundësi të tjera për ta bërë ndikimin e politikave të saj më të prekshëm për konsumatorin, si për shembull ofrimi i stimujve konkretë, uljeve për produkte ekologjike apo theksimi i përfitimeve të drejtpërdrejta që vijnë nga blerja e produkteve të qëndrueshme.

Nga ana tjetër, 58% e klientëve besojnë se Megatek kontribuon në mbrojtjen e mjedisit. Kjo shifër është mjaft pozitive dhe dëshmon se politikat e ndërmarra kanë ndikuar në formimin e një perceptimi të favorshëm për kompaninë, edhe nëse ky perceptim nuk përkethehet ende plotësisht në veprime të qarta blerjeje. Ky është një tregues se Megatek është në rrugën e duhur për të forcuar imazhin e saj si një kompani përgjegjëse mjedisore.

Edhe më inkurajues është fakti se 73% e klientëve deklarojnë se do të preferonin të blinin produkte ekologjike në të ardhmen. Ky rezultat tregon një potencial të madh për rritjen e ofertës së gjelbër dhe për promovimin më agresiv të produkteve të qëndrueshme. Megatek mund ta shfrytëzojë këtë predispozitë pozitive të konsumatorëve për të zgjeruar më tej gamën e produkteve ekologjike, për të rritur diferencimin në treg dhe për të ndërtuar një avantazh konkurrues bazuar në qëndrueshmëri.

5. Diskutime

Në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm, është thelbësore që kompanitë jo vetëm të ndërmarrin veprime konkrete në drejtim të ruajtjes së mjedisit dhe përfshirjes sociale, por edhe të krahasojnë veten me standardet ndërkombëtare për të vlerësuar përputhshmërinë dhe për të identifikuar hapësira për përmirësim. Megatek, si një nga hipermarketet më të mëdha në Shqipëri, ka ndërmarrë një sërë iniciativash për qëndrueshmëri, por krahasimi me standardet globale tregon një panoramë më të balancuar të progresit dhe sfidave të saj. Standardi më i njohur për menaxhimin mjedisor në nivel ndërkombëtar është ISO 14001, i cili përcakton kërkesa të qarta për sistemet e menaxhimit që ndihmojnë një organizatë të përmirësojë vazhdimisht performancën e saj mjedisore. Përveç tij, UN Global Compact dhe Global Reporting Initiative (GRI) përfaqësojnë korniza të tjera të rëndësishme që inkurajojnë transparencë, objektiva të matshme dhe përfshirjen e palëve të interesuara në proceset e qëndrueshmërisë. Nga një analizë krahasuese, Megatek përputhet me disa nga kriteret kyçe të këtyre standardeve, por mbetet pas në disa fusha të tjera. Në vijim paraqitet një tabelë krahasuese që përmbledh këtë analizë.

Megatek ka bërë përparime domethënëse në aspekte si monitorimi i konsumit të energjisë, duke aplikuar sistemet e matjes së vazhdueshme dhe teknologji me eficiencë të lartë, si ndriçimi LED. Kjo përputhje është në linjë me kërkesat e ISO 14001 dhe rekomandimet e GRI për uljen e ndikimit mjedisor përmes zbatimit të teknologjive të pastra (ISO, 2018). Një tjetër fushë ku Megatek rezulton në përputhje të mirë është trajnimi i stafit për qëndrueshmëri. Përqindja e punonjësve të trajnuar është rritur nga 10% në 2022 në 35% në 2024 dhe parashikohet të arrijë në 60% deri në vitin 2026. Ky angazhim për edukimin e brendshëm ndihmon në përhapjen e kulturës së qëndrueshmërisë në të gjithë organizatën (Dervishi & Kola, 2022).

Gjithashtu, Megatek ka filluar të vendosë objektiva të matshme mjedisore, si reduktimi i konsumit të energjisë me 10% në vitin 2024 dhe rritja e përqindjes së produkteve ekologjike me 15%. Vendosja e këtyre objektivave e afron kompaninë me praktikatat më të mira ndërkombëtare që synojnë përmirësimin progresiv të performancës (UNGC, 2023).

Tabela 6. Krahasimi i praktikave të Megatek me standardet globale

Elementi i vlerësimit	Kërkesë nga standardet ndërkombëtare	Gjendja në Megatek	Vlerësim përputhshmërie
Monitorimi i konsumit të energjisë	Po	Po	Në përputhje
Trajnimi i stafit për qëndrueshmëri	Po	Po	Në përputhje
Objektiva të matshme mjedisore	Po	Po	Në përputhje
Raportim publik i performancës	Po (GRI, ISO 14001)	Jo	Mungesë përputhshmërie
Certifikimi formal me ISO 14001	Rekomandohet	Jo	Mungesë përputhshmërie
Përfshirja e palëve të interesuara	Po	Po, por e kufizuar	Pjesërisht në përputhje
Rishikimi periodik i politikave	Po	Jo sistematik	E paplotë
Edukimi i konsumatorëve	Po	Po	Në përputhje

Burimi: Autorët

Pavarësisht këtyre arritjeve, Megatek ende nuk ka përmbushur disa nga kërkesat themelore të standardeve ndërkombëtare. Së pari, nuk realizon raportim publik vjetor të performancës mjedisore, një praktikë që është thelbësore sipas GRI dhe ISO 14001 për transparencën dhe llogaridhënien (GRI, 2022). Mungesa e raporteve e bën të vështirë për palët e jashtme të vlerësojnë progresin dhe impaktin real të praktikave të ndërmarra.

Megatek nuk është i certifikuar me ISO 14001, çka përfaqëson jo vetëm një mungesë përputhshmërie formale, por edhe një humbje potenciale në imazh dhe besueshmëri ndërkombëtare. Një certifikim i tillë do të dëshmonte përkushtimin e kompanisë ndaj standardeve të menaxhimit mjedisor të njohura globalisht. Për më tepër, përfshirja e palëve të interesuara, megjithëse ekziston në disa forma si anketime të klientëve dhe projekte sociale, mbetet modeste në krahasim me standardet globale që kërkojnë një angazhim më të thelluar dhe sistematik me komunitetin, punonjësit dhe furnitorët.

6. Rekomandime

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe analizën krahasuese të zhvilluar në këtë punim, Megatek ka bërë përparime të dukshme në fushën e qëndrueshmërisë, megjithatë ekziston një potencial i madh për përmirësim dhe thellim të mëtejshëm të këtyre praktikave në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Një nga rekomandimet kryesore është që kompania të fillojë të përgatisë dhe të publikojë raporte vjetore të qëndrueshmërisë, të strukturuar sipas udhëzimeve të Global Reporting Initiative (GRI). Raportet duhet të përmbajnë tregues të matshëm mbi konsumin e energjisë, menaxhimin e mbetjeve, ndikimin në komunitet dhe përparimin drejt objektivave të qëndrueshmërisë. Publikimi i tyre do të rrisë nivelin e transparencës dhe llogaridhënies, duke krijuar besim te klientët, partnerët dhe institucionet publike. Raportimi gjithashtu do t'i mundësonte kompanisë të ndjekë përparimin në mënyrë sistematike dhe të ndërmarrë masa korrigjuese kur është e nevojshme.

Një tjetër rekomandim kyç është aplikimi për certifikimin ISO 14001, që përfaqëson standardin ndërkombëtar për menaxhimin mjedisor. Marrja e këtij certifikimi do të formalizonte përpjekjet ekzistuese të Megatek dhe do ta ndihmonte atë të strukturojë më mirë sistemet e brendshme të menaxhimit të ndikimeve mjedisore. Ky proces kërkon ndërtimin e një ekipi të brendshëm të përkushtuar ndaj çështjeve të qëndrueshmërisë, hartimin e politikave dhe procedurave në përputhje me standardin dhe realizimin e auditimeve të rregullta të brendshme dhe të jashtme për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat e certifikimit.

Gjithashtu, Megatek duhet të forcojë përfshirjen e palëve të interesuara në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm. Deri tani, përfshirja e konsumatorëve, furnitorëve, punonjësve dhe komunitetit është e kufizuar dhe nuk ndodh në

mënyrë sistematike. Rekomandohet që kompania të krijojë platforma për dialog, konsultime publike dhe mekanizma për mbledhjen e feedback-ut, me qëllim përfshirjen më të thelluar të grupeve të interesit në vendimmarrje dhe strategji të ardhshme. Kjo qasje do të ndihmonte në ndërtimin e një marrëdhënieje më të qëndrueshme dhe të qëllimshme ndërmjet kompanisë dhe mjedisit të saj shoqëror.

Përmirësimi i edukimit të brendshëm dhe të jashtëm është një tjetër hap i domosdoshëm. Megatek ka nisur trajnime për stafin, por ato mund të zhvillohen më tej duke përfshirë temat e qëndrueshmërisë në orientimin e punonjësve të rinj dhe duke organizuar trajnime të detajuara mbi menaxhimin e burimeve, reduktimin e mbetjeve dhe përfshirjen sociale. Në të njëjtën kohë, kompania duhet të intensifikojë fushatat edukative për konsumatorët, duke shpjeguar përfitimet e produkteve ekologjike, ndikimin e zgjedhjeve të tyre në mjedis dhe rëndësinë e konsumit të përgjegjshëm.

Një tjetër drejtim i rëndësishëm për përmirësim është zgjerimi i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare dhe institucionet arsimore. Përmes këtyre partneriteteve, Megatek mund të ndikojë më gjerësisht në edukimin për qëndrueshmërinë, të zhvillojë projekte me impakt social dhe të pozicionohet si një kompani lidere në angazhimin për zhvillim të qëndrueshëm. Këto bashkëpunime do të sillnin përfitime të dyanshme: do të rrisnin ndërgjegjësimin publik dhe do të forconin pozicionin strategjik të kompanisë në treg.

Gjithashtu, rekomandohet që Megatek të fillojë integrimin e kriterëve të qëndrueshmërisë në zinxhirin e furnizimit. Kompania duhet të vendosë kërkesa të qarta për furnitorët dhe partnerët, duke favorizuar ato subjekte që zbatojnë standarde mjedisore dhe sociale. Kjo do të mundësonte zgjerimin e ndikimit të qëndrueshmërisë përtej kufijve të organizatës dhe do të kontribuonte në krijimin e një ekosistemi biznesi më të përgjegjshëm.

Në përfundim, Megatek ka bazën e duhur për të ndërtuar një profil të fortë në fushën e qëndrueshmërisë, por për të kaluar nga praktikata e shpërndara në një strategji të integruar dhe të qëndrueshme, duhet të fokusohet në transparencë, certifikim, përfshirje dhe bashkëpunim. Zbatimi i këtyre rekomandimeve do ta ndihmonte kompaninë jo vetëm të përmbushë pritshmëritë ndërkombëtare, por edhe të forcojë rolin e saj si një lider në zhvillimin e qëndrueshëm në sektorin e shitjes me pakicë në Shqipëri.

7. Kufizimet e artikullit

Çdo punim ka kufizime dhe ky nuk bën përjashtim. Një nga kufizimet kryesore ishte aksesimi i informacionit të brendshëm të kompanisë. Disa nga të dhënat që lidhen me buxhetin e dedikuar për projektet e qëndrueshmërisë ose matjet konkrete të ndikimit mjedisor nuk ishin të disponueshme për arsye konfidencialiteti. Gjithashtu, për shkak të kohës së kufizuar dhe burimeve të kufizuara njerëzore, numri i anketave dhe i përgjigjeve të marra nuk mund të konsiderohet përfaqësues për gjithë popullatën e klientëve. Megjithatë, ata përfaqësojnë një grup të larmishëm që ofron perspektiva të vlefshme. Një tjetër sfidë ishte mungesa e një kulture të konsoliduar të transparencës në raportimin e performancës mjedisore dhe sociale nga ana e kompanive shqiptare, çka e bën më të vështirë krahasimin e praktikave me standardet ndërkombëtare. Pavarësisht këtyre kufizimeve, është bërë maksimumi për të siguruar cilësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e analizës, duke përdorur triangulim të burimeve dhe duke ndjekur parime etike të rrepta në të gjitha fazat e kërkimit.

8. Përfundime

Ky punim ka trajtuar në mënyrë të detajuar rastin e Megatek si një hipermarket i angazhuar në praktika të qëndrueshmërisë, duke ndihmuar në krijimin e një pasqyre të qartë mbi mënyrën sesi aktorët e mëdhenj të sektorit të shitjeve në Shqipëri mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm. Megjithatë, për t'u thelluar më tej në këtë fushë dhe për të siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse, nevojiten edhe kërkime të mëtejshme në disa drejtime të rëndësishme.

Së pari, sugjerohet që në të ardhmen të realizohen studime krahasuese midis disa hipermarketeve ose rrjeteve të shitjes me pakicë në Shqipëri apo rajon, me qëllim për të kuptuar ndryshimet në praktikën e qëndrueshmërisë, sfidat dhe mënyrën sesi këto kompani e perceptojnë dhe e zbatojnë këtë koncept. Një analizë e tillë do të ndihmonte në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në nivelin e përfshirjes së kompanive në praktikën e gjelbra dhe do të ofronte një bazë të mirë për krijimin e standardeve të përbashkëta.

Gjithashtu, një tjetër drejtim që kërkon vëmendje të veçantë është analiza e sjelljes konsumatore në raport me qëndrueshmërinë. Megjithëse ky punim përfshiu disa të dhëna për perceptimin e klientëve të Megatek, një studim më

i thelluar mbi faktorët që ndikojnë në vendimmarrjen e konsumatorit për blerje të produkteve ekologjike do të ndihmonte kompanitë të hartojnë strategji më efektive marketingu dhe edukimi. Ky hulumtim mund të përfshijë segmentimin e tregut sipas moshës, gjinisë, arsimit apo të ardhurave, për të përcaktuar se cilat grupe janë më të ndjeshme ndaj çështjeve të qëndrueshmërisë.

Një fushë tjetër me potencial kërkimi është analiza e politikave publike që nxisin ose pengojnë qëndrueshmërinë në sektorin e shitjeve. Një studim i tillë do të ndihmonte në identifikimin e boshllëqeve në kuadrin ligjor dhe institucional shqiptar, duke dhënë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit, politikave fiskale dhe skemave mbështetëse për bizneset që zbatojnë praktika të qëndrueshme. Kjo do të ishte veçanërisht e dobishme për politikëbërësit dhe institucionet qeveritare që duan të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm në nivel kombëtar.

Një tjetër sugjerim është të realizohen studime të thelluara për impaktin ekonomik të praktikave të qëndrueshmërisë në performancën financiare të kompanive. Këto kërkime do të mund të provojnë në mënyrë empirike lidhjen mes qëndrueshmërisë dhe përfitimeve ekonomike afatgjata, si reduktimi i kostove operative, përmirësimi i imazhit të kompanisë dhe rritja e besueshmërisë së markës.

Së fundi, është e nevojshme të zhvillohen studime ndërdisiplinore, që përfshijnë elementë të marketingut, menaxhimit, sociologjisë dhe mjedisit, për të ndërtuar një kuadër më të plotë dhe gjithëpërfshirës mbi qëndrueshmërinë në sektorin e shitjeve. Këto lloj kërkimesh do të ndihmonin në kuptimin më të thellë të ndërveprimeve midis aktorëve ekonomikë, konsumatorëve dhe politikave publike në raport me mjedisin dhe zhvillimin social.

Literatura

- Chen, M., & Lee, J. (2019). Sustainable business strategies and long-term performance. *Journal of Business Strategy*, 30(2), 120–135.
- Cammarano, A., Perano, M., Michelino, F., Del Regno, C., & Caputo, M. (2022). SDG-Oriented Supply Chains: Business Practices for Procurement and Distribution. *Sustainability*, 14(3), 1325. <https://doi.org/10.3390/su14031325>

- Connelly, B. L., Ketchen Jr, D. J., & Slater, S. F. (2011). Toward a “theoretical toolbox” for sustainability research in marketing. *Journal of the Academy of Marketing Science*, 39(1), 86-100.
- Dervishi, E., & Kola, M. (2022). Environmental awareness in Albanian businesses. *Albanian Business Review*, 5(2), 88–101.
- Horzela-Miś, A., Semrau, J., Wolniak, R., & Grebski, W. W. (2025). Energy Transformation in the Construction Industry: Integrating Renewable Energy Sources. *Energies*, 18(9), 2363.
<https://doi.org/10.3390/en18092363>
- Kuźniar, W., Surmacz, T., & Wierzbiński, B. (2021). The Impact of Ecological Knowledge on Young Consumers’ Attitudes and Behaviours towards the Food Market. *Sustainability*.
<https://doi.org/10.3390/su13041984>.
- Lee, C., & Hung, H. (2024). The Impact of Education on Consumers’ Eco-Friendly Shopping Habits towards Sustainable Purchases: Evidence from Indonesia and Taiwan. *Sustainability*.
<https://doi.org/10.3390/su16208832>.
- Li, D. (2025). Impact of green advertisement and environmental knowledge on intention of consumers to buy green products. *BMC Psychology*, 13.
<https://doi.org/10.1186/s40359-025-02538-x>.
- Majid, S., Zhang, X., Khaskheli, M. B., Hong, F., King, P. J. H., & Shamsi, I. H. (2023). Eco-efficiency, environmental and sustainable innovation in recycling energy and their effect on business performance: evidence from European SMEs. *Sustainability*, 15(12), 9465.
<https://doi.org/10.3390/su15129465>
- Marín-García, A., Gil-Saura, I., Ruiz-Molina, M., & Berenguer-Contrí, G. (2023). Capturing consumer loyalty through technological innovation and sustainability: the moderating effect of the grocery commercial format. *British Food Journal*. <https://doi.org/10.1108/bfj-12-2021-1317>.
- Oppewal, H., Alexander, A., & Sullivan, P. (2006). Consumer perceptions of corporate social responsibility in town shopping centres and their influence on shopping evaluations. *Journal of retailing and Consumer services*, 13(4), 261-274.
- Panda, T., Kumar, A., Jakhar, S., Luthra, S., Garza-Reyes, J., Kazancoglu, I., & Nayak, S. (2020). Social and environmental sustainability model on consumers’ altruism, green purchase intention, green brand loyalty and evangelism. *Journal of Cleaner Production*. 243, 118575.
<https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2019.118575>.
- Sulejmani, E. (2025). *Si munden Hipermarketet të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm: rasti Megatek*. Temë diplome Master i Shkencave, Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, fq. 61, Tiranë, Shqipëri.

Një qasje teorike e formimit të pritshmërive, sjelljes kognitive dhe politikave makroekonomike

Egla Mansi ^{a,12}

^a*Fakulteti i Ekonomise, Universiteti i Tiranës*

Përmbledhja

Ky punim ofron një përmbledhje teorike dhe integruese se si paragjykimet njohëse, njohuritë financiare dhe mjediset e informacionit dixhital formësojnë formimin e pritjeve ekonomike. Analiza sintetizon njohuritë kryesore nga makroekonomia e sjelljes, studimet e pritjeve të bazuara në anketa dhe literatura mbi kufizimet njohëse, duke theksuar mekanizmat përmes të cilave familjet formojnë besime për inflacionin, interpretojnë sinjalet e politikave dhe përshtaten ndaj goditjeve makroekonomike. Punimi argumenton se bashkëveprimi midis njohurive të kufizuara financiare, fërkimeve të informacionit dhe ekspozimit dixhital çon në gabime të vazhdueshme parashikimi, besime heterogjene dhe transmetim të dobësuar të politikës monetare. Përmes një metodologjie përshkruese dhe cilësore, studimi shqyrton tre shtylla të literaturës moderne të formimit të pritjeve: racionalitetin e kufizuar, heterogjenitetin e bazuar në njohuri dhe përditësimin e besimeve të nxitur nga paragjykimet. Gjetjet sugjerojnë që heterogjeniteti i sjelljes tani është një përcaktues qendror i stabilizimit makroekonomik dhe se përmirësimi i njohurive ekonomike dhe dixhitale është një shtyllë kyçe për forcimin e qëndrueshmërisë në ekonominë në zhvillim. Punimi kontribuon në literaturën akademike në gjuhën shqipe duke ofruar një rishikim të strukturuar konceptual të kësaj fushe që po zgjerohet me shpejtësi.

Fjalët kyç: pritshmëri ekonomike; paragjykimet njohëse; edukim financiar; sjellje ekonomike; politikë monetare.

Abstract

¹² KONTAKT: eglamansi@gmail.com

This paper offers a theoretical and integrative overview of how cognitive biases, financial literacy, and digital information environments shape the formation of economic expectations. The analysis synthesizes key insights from behavioral macroeconomics, survey-based expectation studies, and the literature on cognitive constraints, highlighting the mechanisms through which households form inflation beliefs, interpret policy signals, and adjust to macroeconomic shocks. The paper argues that the interaction between limited financial literacy, information frictions, and digital exposure leads to persistent forecast errors, heterogeneous beliefs, and weakened monetary-policy transmission. Through a descriptive and qualitative methodology, the study examines three pillars of the modern expectation-formation literature: bounded rationality, literacy-based heterogeneity, and bias-driven belief updating. The findings suggest that behavioral heterogeneity is now a central determinant of macroeconomic stabilization and that improving economic and digital literacy is a key pillar for strengthening resilience in emerging economies. The paper contributes to the literature by providing a structured conceptual review of this rapidly expanding field.

Keywords: economic expectations; cognitive biases; financial education; economic behavior; monetary policy.

1. Hyrje

Pritshmëritë makroekonomike zënë një rol qendror në mënyrën se si individët, firmat dhe tregjet reagojnë ndaj politikave publike dhe tronditjeve ekonomike. Modelet standarde të pritshmërive racionale supozojnë se agjentët përpunojnë informacionin në mënyrë të plotë dhe të paanshme, duke formuar parashikime që janë konsistentë me modelet e vërteta të ekonomisë. Megjithatë, një korpus i gjerë kërkimesh ka dokumentuar se parashikimet e konsumatorëve dhe firmave devijojnë në mënyrë sistematike nga ky standard teorik. Studimet empirike tregojnë se gabimet e vazhdueshme të parashikimit, mospërputhjet e theksuara mes agjentëve dhe një elasticitet i ulët i pritshmërive ndaj sinjaleve të politikës monetare janë tipare të rregullta të dhënave (Coibion & Gorodnichenko, 2015; D’Acunto et al., 2024; Weber et al., 2025). Këto gjetje sugjerojnë se pritshmëritë nuk formohen sipas mekanizmave të optimizimit perfekt, por reflektojnë kufizime njohëse dhe informacion të përpunuar me vonesë.

Literatura bashkëkohore e ekonomisë njohëse ka treguar se agjentët ekonomikë përdorin rregulla të thjeshta, filtrojnë informacionin në mënyrë

selektive dhe i përgjigjen vetëm pjesërisht sinjaleve monetare dhe fiskale. Modeli i vëmendjes së kufizuar i Gabaix (2019) argumenton se agjentët përpunojnë vetëm një pjesë të informacionit ekonomik për shkak të kostove të informacionit dhe kufizimeve njohëse. Në mënyrë të ngjashme, mekanizmat e të mësuarit nga përvoja të Malmendier dhe Nagel (2016) tregojnë se individët u japin peshë më të madhe ngjarjeve të fundit ekonomike që kanë përjetuar vetë, duke prodhuar parashikime që varen nga “*memoria makroekonomike*” individuale. Këto devijime të strukturuar nga racionaliteti perfekt rezultojnë në pritshmëri që shpesh janë të ngurta, të polarizuara ose tepër të ndjeshme ndaj informacioneve të thjeshta dhe domethënëse në perceptim (salient cues).

Një tjetër determinant kyç i pritshmërive është edukimi financiar. Studimet e Lusardi dhe Mitchell (2014) dhe D’Acunto, Hoang, Paloviita dhe Weber (2023) tregojnë se individët me aftësi më të mira numerike dhe njohuri financiare gabojnë më pak në parashikimet e tyre, përgjigjen më ndjeshëm ndaj komunikimeve të bankës qendrore dhe janë më pak të cenueshëm ndaj paragjykimeve të zakonshme si inercia e pritshmërive ose optimizmi i tepruar. Këto rezultate kanë nxitur krijimin e modeleve të reja në makroekonomi me agjentë heterogjenë, ku edukimi financiar dhe kapaciteti njohës shpjegojnë heterogjenitetin e sjelljes.

Transformimi dixhital ka shtuar një dimension të ri në mënyrën se si individët formojnë pritshmëri. Përhapja e shpejtë e informacionit online, rritja e burimeve informale dhe shpesh jo të verifikuara, si dhe ndikimi i mediave sociale kanë ndryshuar mekanizmin tradicional të informimit publik. Në epokën e tepricës së informacionit, agjentët përballen me sfida të reja: mbingarkesë informacioni, dezinformim dhe pasiguri për cilësinë e burimeve. Kjo nxit varësinë nga heuristika të thjeshta, përqendrim tek informacione të dallueshme dhe shpesh një rënie në besueshmërinë ndaj institucioneve tradicionale (Blinder et al., 2024; Edelman, 2025). Ndërveprimi midis edukimit financiar, kapaciteteve digjitale dhe strukturës së informacionit që individët ekspozohen e bën procesin e formimit të pritshmërive shumë më kompleks se sa përshkruajnë modelet standarde.

Në këtë sfond, Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor përbëjnë një rast të veçantë studimi. Edukimi financiar mbetet i ulët dhe i pabarabartë ndërmjet grupeve demografike, ndërsa përdorimi i teknologjive digjitale po rritet me ritme të shpejta, por shpesh pa aftësi të mjaftueshme për vlerësimin kritik të informacionit ekonomik dhe financiar. Kjo krijon një mospërputhje midis

ekspozimit të gjerë ndaj informacionit dhe aftësisë për ta interpretuar atë në mënyrë të saktë, duke ndikuar në formimin e pritshmërive për inflacionin, besimin tek politika monetare dhe sjelljen financiare të individëve.

Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një qasje teorike dhe sintetizuese, duke shqyrtuar mënyrat përmes të cilave kufizimet njohëse, edukimi financiar dhe informacioni dixhital formësojnë pritshmëritë makroekonomike dhe ndikojnë në transmetimin e politikave. Përmes një analize përshkruese dhe cilësore, studimi synon të kontribuojë në literaturën shqiptare dhe rajonale, duke theksuar rëndësinë e dimensioneve njohëse dhe informative në kuptimin e sjelljes ekonomike. Duke ndërthurur perspektivat nga ekonomia eksperimentale, makroekonomia me agjentë heterogjenë dhe ekonomia e informacionit, punimi synon të ofrojë një kornizë të pasur konceptuale për analizën e pritshmërive në ekonominë në zhvillim.

2. Pritshmëritë Ekonomike në Makroekonominë Moderne

2.1 Nga pritshmëritë racionale tek kufizimet njohëse

Që prej formulimit klasik të Muth (1961) dhe operacionalizimit të tij në modelet makroekonomike të Lucas (1972), paradigma e pritshmërive racionale ka qenë gur themeli në ekonominë moderne. Sipas këtij këndvështrimi, agjentët ekonomikë posedojnë pritshmëri paanshme dhe përdorin gjithë informacionin në dispozicion për të parashikuar të ardhmen. Megjithatë, evidentimi empirik i dekadave të fundit ka vënë në dyshim këtë supozim bazë. Të dhënat nga sondazhet e konsumatorëve dhe firmave, eksperimentet në laborator, si dhe analizat strukturore të cikleve të biznesit tregojnë qartazi se pritshmëritë në botën reale janë sistematikisht të njëanshme, të ngadalshme në përditësim dhe thellësisht heterogjene midis individëve (Coibion et al., 2022; D’Acunto et al., 2024).

Agjentët shpesh mbështeten në heuristika të thjeshtuara, ndjekin trende të fundit, ose i kushtojnë vëmendje selektive informacionit, çka prodhon devijime të qëndrueshme nga proceset racionale të parashikimit. Mungesa e përditësimit të menjëhershëm të pritshmërive, e njohur si “ngurtësi informative”, dokumentohet gjerësisht në literaturë dhe sjell pasoja të drejtpërdrejta mbi efektivitetin e politikës monetare dhe dinamikën e inflacionit (Coibion & Gorodnichenko, 2015). Evidencat mbi “mësimin nga përvojat” tregojnë se individët i japin peshë të tepruar episodeve ekonomike

të përjetuara personalisht, duke anashkaluar informacionin historik objektiv (Malmendier & Nagel, 2016). Po ashtu, modelet moderne të miopisë njohëse demonstrojnë se agjentët perceptojnë zbehur ngjarjet e largëta në kohë dhe mbivlerësojnë kushtet aktuale, duke deformuar kanalet tradicionale të transmetimit të politikës monetare (Gabaix, 2019).

Këto prova kumulative kanë zhvendosur gradualisht fokusin e makroekonomisë nga modeli idealizuar i agjentit plotësisht racional drejt një qasjeje më realiste që pranon kufizimet e kujtesës, të kapaciteteve përpunuese dhe të vëmendjes njerëzore. Në vend të pritshmërive të unifikuara e të sakta, të dhënat tregojnë ekzistencën e shpërndarjeve të gjera besimesh, ku gabimet e parashikimit janë të lidhura me faktorë socio-demografikë, statusin ekonomik, expunimin informativ, si dhe nivelin e edukimit financiar (Das et al., 2020; D'Acunto et al., 2023).

Në këtë kontekst, modelet e pritshmërive racionale paraqesin kufizime serioze për shpjegimin e sjelljeve reale të familjeve dhe firmave. Për shembull, një numër studimesh dokumentojnë se agjentët nuk reagojnë ndaj premtimeve të politikës monetare aq fuqishëm sa parashikon modeli standard i *forward guidance*, për shkak të miopisë njohëse dhe mungesës së mirëkuptimit rreth mekanizmit të normave të interesit (Coibion et al., 2023). Edhe perceptimi i inflacionit rezulton të jetë i shtrembëruar nga ekspozimi i përditshëm ndaj çmimeve të shportës së konsumit, duke gjeneruar prirje përmbi-reaktuese në mjedise me paqëndrueshmëri të lartë (D'Acunto et al., 2021). Përballë këtyre rezultateve, literatura bashkëkohore ka filluar të ndërtojë një paradigmë të re: pritshmëri të formuara nën kufizime njohëse, asimetrikë informative dhe kapacitete heterogjene për të përpunuar informacionin ekonomik. Ky orientim i ri metodologjik ka hapur rrugën për modele më të besueshme të sjelljes mikro dhe dinamika makro që janë në përputhje me evidencën empirike.

2.2 Burimet e Devijimeve të Pritshmërive

Një nga zhvillimet më të rëndësishme në makroekonominë moderne është njohja se devijimet nga pritshmëritë racionale nuk janë anomalitë sporadike, por pasqyrojnë mekanizma të qartë psikologjikë, njohës dhe informacionalë që karakterizojnë mënyrën se si individët përpunojnë informacionin ekonomik. Literatura e dy dekadave të fundit ka identifikuar disa burime themelore të këtyre devijimeve, të cilat shfaqen në forma sistematike dhe të

përsëritshme, duke prodhuar modele të besueshme për shpjegimin e sjelljes së agjentëve ekonomikë.

Mësimi nga përvoja personale (Malmendier & Nagel, 2016) është një nga temat më të fuqishme. Individët peshojnë tepër fort ngjarjet që kanë përjetuar vetë dhe formojnë pritshmëri duke i projektuar përvojat e tyre mbi të ardhmen. Për shembull, kujtimet e inflacionit të lartë gjatë rinisë i bëjnë individët më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të çmimeve dekada më vonë, duke prodhuar pritshmëri më të larta inflacioniste sesa ato të gjeneratave që nuk kanë përjetuar të njëjtën histori. Ky mekanizëm krijon heterogjenitet gjeneracional të pritshmërive dhe kontribuon në ngurtësinë e besimeve edhe kur informacioni publik është i qartë. Një burim tjetër thelbësor është vëmendja e kufizuar. Në modelin e Gabaix (2019), konsumatorët nuk i përpunojnë plotësisht informacionet për politikën monetare apo kushtet makroekonomike; ata janë “miopë njohësisht”, duke i nënvlerësuar ngjarjet e ardhshme dhe duke reaguar më pak ndaj sinjaleve të largëta. Ky kufizim krijon devijime nga racionaliteti ideal dhe shpjegon pse udhëzimet e politikës monetare (forward guidance) kanë efekte shumë më të vogla në praktikë sesa parashikojnë modelet New Keynesian me pritshmëri racionale (Coibion et al., 2023). Në këtë kuptim, pritshmëritë bëhen *sticky*, sepse individët i rifreskojnë besimet rrallë dhe vetëm pas ngjarjeve të forta apo komunikimeve shumë të drejtpërdrejta. Pjesë e rëndësishme e devijimeve vjen edhe nga rregullat psikologjike të përpunimit të informacionit. Modeli i expectation formation diagnostike (Bordalo, Gennaioli & Shleifer, 2018) tregon se individët u japin peshë të tepruar lajmeve “të habitshme” në krahasim me informacionin rutinë. Kjo sjell mbireagim (overreaction) pas lajmeve pozitive dhe nënreagim pas lajmeve negative, duke prodhuar cikle të vetë-ushqyer të optimizmit dhe pesimizmit. Në tregjet e aseteve, ky mekanizëm krijon luhatshmëri të tepruar dhe rrit probabilitetin e zhvendosjeve të menjëhershme në sentiment (Landier, Ma & Thesmar, 2019). Në pritshmëritë makroekonomike të konsumatorëve, mbireagimi shfaqet si rritje e parashikimeve të inflacionit pas ekspozimit ndaj çmimeve të ndjeshme emocionalisht (D’Acunto et al., 2021).

Një tjetër burim i devijimeve është overconfidence, i cili i shtyn individët të mbivlerësojnë njohuritë e tyre dhe të nënvlerësojnë pasigurinë. Kjo sjell normë më të lartë gabimesh në parashikime dhe besime tepër të ngushta, edhe kur varianca objektive e shkaktarëve makroekonomikë është e lartë (Feldman, 2011). Overconfidence lidhet ngushtë me sjelljen spekulative në tregjet financiare dhe nxit reagime të tepruara ndaj lajmeve të fundit.

Kapaciteti i ose njohja financiare (Lusardi & Mitchell, 2014) është një tjetër determinant struktural i devijimeve të pritshmërive. Individët me aftësi të kufizuara numerike dhe interpretuese kanë gabime më të mëdha në vlerësimet e inflacionit, kanë besime më të paqëndrueshme, dhe shpesh përdorin heuristika të thjeshta si “çmimet gjithmonë rriten”, pavarësisht të dhënave reale. Kjo krijon grupe të mëdha popullsie që reagojnë dobët ndaj sinjaleve të politikës monetare dhe që janë më të ekspozuar ndaj dezinformatave të tregut. Evidenca nga studimet e fundit europiane sugjeron se aftësitë financiare janë një ndër determinantët kryesorë të pasaktësisë së parashikimeve të inflacionit dhe të shpërndarjes së besimeve (Brandão-Marques et al., 2025).

Në mënyrë të ngjashme, rritja e shpejtë e kanalit digjital ka sjellë forma të reja të devijimeve përmes mbingarkesës së informacionit dhe burimeve jo të besueshme (Blinder et al., 2024). Përdoruesit e mediave sociale marrin sinjale ekonomike jo nga institucione zyrtare, por nga rrjete informale që shpesh prodhojnë interpretime të gabueshme të politikës monetare, duke kontribuar në besime të polarizuara. Ky mekanizëm është evidentuar si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në vendet në zhvillim, duke theksuar rolin e “epokës së informacionit të bollshëm por të pakontrolluar”. Në terma të përmbledhjes, literaturat bashkëkohore mbi mësimin nga përvoja, vëmendjen e kufizuar, diagonistikën e informacionit, overconfidence-in dhe aftësitë financiare sugjerojnë se pritshmëritë ekonomike formohen nëpërmjet proceseve të ndërthurura psikologjike dhe strukturore. Këto procese prodhojnë modele të devijimeve që jo vetëm janë sistematike, por edhe parashikuese, duke sfiduar historikun e modeleve me pritshmëri racionale dhe duke kërkuar qasje të reja analitike në makroekonomi dhe politikë ekonomike.

2.3 Heterogjeniteti i pritshmërive

Një nga zhvillimet më të rëndësishme në makroekonominë moderne është pranimi se pritshmëritë nuk formohen në mënyrë homogjene, siç supozohet në qasjen tradicionale të Rational Expectations. Studimet empirike dhe eksperimentale kanë treguar në mënyrë të përsëritur se individët dhe firmat ndryshojnë ndjeshëm në mënyrën se si perceptojnë informacionin, si përpunojnë sinjalet ekonomike dhe si përgjigjen ndaj politikave monetare e fiskale. Ky heterogjenitet nuk është “zë i rastësishëm”, por rrjedhë e

mekanismave psikologjikë, diferencave të kapitalit njohës, përvojave të jetës dhe ekspozimit ndaj informacionit.

Një linjë e gjerë kërkimore dokumenton ekzistencën e grupeve të dallueshme të formimit të pritshmërive, të cilat shpesh mbeten të qëndrueshme gjatë kohës. Evidenca nga sondazhet e fundit të familjeve dhe firmave sugjeron se disa individë përdorin rregulla të thjeshta adaptive, të tjerë bazohen në parashikime trendi, ndërsa një pjesë e vogël përpiqet të formojë pritshmëri më afër racionales (Afrouzi et al., 2024). Ky pluralizëm heuristik gjeneron shpërndarje të gjerë të besimeve (belief dispersion), që vërehet si në tregjet e mallrave, ashtu edhe në tregjet financiare. Një burim kryesor i heterogjenitetit vjen nga kapitali njohës individual, sidomos ai ekonomik dhe financiar. Të dhënat nga sondazhet ndërkombëtare tregojnë se individët me njohuri më të ulëta financiare priren të kenë parashikime më të paqëndrueshme, me variancë më të lartë dhe me mbipeshim të informacionit të fundit (D'Acunto et al., 2023). Më tej, evidenca e re tregon se diferencat në aftësitë statistikore, në kuptimin e probabiliteteve dhe rrezikut, janë determinante të rëndësishme të devijimeve të pritshmërive, duke çuar në nënvlerësim të variancës ose mbivlerësim të rrezikut (Link et al., 2023).

Një tjetër determinante e rëndësishme është mosha dhe përvoja e inflacionit. Individët e rritur në periudha inflacioni të lartë, siç dokumenton literatura e re, mbartin kujtime shumë më të forta dhe formojnë pritshmëri më të ngulitura rreth rreziqeve të inflacionit (Weber et al., 2025). Në të kundërt, gjeneratat që janë rritur në ambiente të stabilizuara monetare kanë pritshmëri më të ulëta dhe më pak të ndikuara nga luhatjet afatshkurtra. Heterogjeniteti shfaqet edhe në nivelet e besimit institucional. Individët me nivele të ulëta të besimit të bankat qendrore ose në institucionet publike i interpretojnë ndryshimet e normave të interesit ose deklaratat e politikës monetare në mënyrë shumë të ndryshme nga individët me besim të lartë (Blinder et al., 2024). Ky dimension është thelbësor në ekonominë në zhvillim, ku besimi institucional shpesh është i brishtë.

Një literaturë e re (2024–2025) ka shtuar në qendër të debatit edhe rolin e ekosistemit digjital të informacionit. Përhapja e shpejtë e platformave online dhe rrjeteve sociale ka krijuar burime të shumëllojshme informacioni, me cilësi të pabarabartë dhe shpesh të pajetëshme me standardet zyrtare. Siç theksojnë studimet e kohëve të fundit, individët me aftësi të kufizuara digjitale kanë më pak gjasa të dallojnë informacionin cilësor nga informacioni

i gabuar, duke çuar në pritshmëri shumë më të devijuara dhe më të paqëndrueshme (Brandão-Marques et al., 2025; De Fiore et al., 2024).

Së fundi, heterogjeniteti i pritshmërive ka pasoja të rëndësishme makroekonomike. Modelet e fundit të makroekonomisë me agjentë heterogjenë tregojnë se shpërndarja e besimeve, jo thjesht mesatarja e tyre, ndikon fuqishëm në efektivitetin e politikës monetare, stabilitetin e konsumit dhe ndjeshmërinë e ekonomisë ndaj goditjeve (Hofmann, Munakata, Rosewall & Sandri, 2025). Në prani të heterogjenitetit të madh, sinjalet e politikës monetare transmetohen në mënyrë asimetrike, duke gjeneruar përgjigje të ndryshme në konsum, pritshmëri dhe investime. Në këtë mënyrë, literatura bashkëkohore konsideron heterogjenitetin e pritshmërive jo si zhurmë, por si një karakteristikë thelbësore të sjelljes ekonomike, e cila duhet modeluar, matur dhe inkorporuar në analizën makroekonomike.

2.4 Konteksti Shqiptar dhe i Ballkanit Perëndimor

Në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor, heterogjeniteti i pritshmërive merr një dimension veçanërisht të theksuar për shkak të kombinimit të faktorëve institucionalë, edukativë dhe informacionalë. Rajoni karakterizohet nga nivele relativisht të ulëta të literacisë financiare (OECD-INFE, 2023), akses i pabarabartë në teknologjitë digjitale dhe diferenca të qëndrueshme në besimin ndaj institucioneve publike, përfshirë bankat qendrore. Këta faktorë krijojnë një mjedis ku individët mbështeten më tepër te informacione të pjesshme, shpesh informale, dhe te përvoja të drejtpërdrejta, sesa te komunikimi zyrtar i politikave monetare. Si rezultat, pritshmëritë makroekonomike formohen në mënyrë shumë të fragmentuar dhe reflektojnë më shumë kontekste lokale sesa narrativat e dizajnuara nga politikatat publike.

Fragmentimi institucional ka pasur pasoja të dukshme për efektivitetin e komunikimit monetar. Në Shqipëri, niveli i besimit ndaj institucioneve monetare ka qenë tradicionalisht i paqëndrueshëm, gjë që dobëson transmetimin e sinjaleve të politikës monetare në pritshmëritë e individëve, një fenomen i vërejtur edhe në ekonomi të tjera në zhvillim. Për më tepër, vëzhgimet empirike sugjerojnë se ekspozimi ditor ndaj çmimeve të ushqimeve dhe energjisë ka një ndikim të jashtëzakonshëm në perceptimet inflacioniste të familjeve. Ky është një mekanizëm i ngjashëm me atë që dokumentohet në punimet e D'Acunto et al. (2021), ku individët

mbivlerësojnë inflacionin kur përballen me çmime të larta në kategoritë e konsumit të përditshëm.

Ndryshimet strukturore midis zonave urbane dhe rurale e shtojnë edhe më tej heterogjenitetin e pritshmërive. Në zonat urbane, akses më i gjerë në teknologji digjitale ofron mundësi më të mëdha për informim, por njëkohësisht ekspozon individët ndaj “information overload” dhe burimeve të paverifikuara, sidomos nëpërmjet rrjeteve sociale. Ndërkohë, në zonat rurale, kufizimet në infrastrukturën digjitale dhe niveli më i ulët i edukimit financiar dhe teknologjik e bëjnë informacionin ekonomik edhe më të pjesshëm dhe më të vështirë për t'u interpretuar. Në të dyja rastet, aftësitë digjitale luajnë një rol thelbësor në mënyrën se si individët përpunojnë informacionin dhe formojnë pritshmëritë, duke krijuar dallime të qarta ndërmjet atyre që thjesht ekspozohen ndaj informacionit dhe atyre që aftohen ta vlerësojnë dhe ta përdorin atë në mënyrë të qëndrueshme.

Një tjetër veçori e rëndësishme e kontekstit ballkanik lidhet me prevalencën e burimeve jozyrtare të informacionit ekonomik. Studimet e fundit të bankave qendrore në rajon sugjerojnë se pjesa më e madhe e familjeve bazojnë pritshmëritë për inflacionin mbi perceptime të brendshme, opinione të rrethit shoqëror ose sinjale të marra nga mediat sociale, duke krijuar pritshmëri sistematikisht më të larta se inflacioni faktik. Ky devijim është i përhapur në shumë ekonomi në zhvillim, por në Ballkan ai përforcohet nga kombinimi i literacisë së ulët financiare dhe niveleve modeste të aftësive digjitale. Në këtë mjedis, ku struktura informuese është e fragmentuar dhe kapaciteti i individëve për të vlerësuar informacionin ekonomik është i kufizuar, heterogjeniteti i pritshmërive nuk është vetëm një fenomen teorik, por një faktor me ndikim të drejtpërdrejtë në efektivitetin e politikave publike, besueshmërinë monetare dhe stabilitetin ekonomik të familjeve. Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor përfaqësojnë kështu një laborator natyror të veçantë për studimin e mënyrës se si kufizimet njohëse, literacia financiare dhe aftësitë digjitale ndërveprojnë për të formësuar pritshmëritë ekonomike nën kushte informacioni të pabarabartë.

3. Edukimi Financiar dhe Pritshmëritë

3.1. Edukimi Financiar si Kapacitet Njohës

Një ndër zhvillimet më të rëndësishme në literaturën moderne mbi formimin e pritshmërive është trajtimi i edukimit financiar si një formë e kapitalit kognitiv që kushtëzon mënyrën se si individët përpunojnë informacion ekonomik, interpretojnë sinjale të politikave, dhe formojnë parashikime për inflacionin dhe variablat e tjerë makroekonomikë. Që nga puna themelore e Lusardi dhe Mitchell (2014), është dokumentuar gjerësisht se individët me literaci të ulët financiare janë më të prirur të përdorin heuristika të thjeshta, të mbështeten tek kujtesa afatshkurtër dhe të ndikohen nga informacioni i fundit, duke prodhuar gabime të qëndrueshme në parashikime dhe një shpërndarje shumë më të gjerë të pritshmërive. Rezultate të ngjashme dalin edhe nga studimet e kohëve të fundit, të cilat tregojnë se aftësia për të kuptuar shkallën vjetore të inflacionit, diferencën midis normave nominale dhe reale, ose ndikimin e normave të interesit mbi kursimet dhe kreditë është e lidhur ngushtësisht me korrektësinë e parashikimeve. D’Acunto et al. (2024) tregojnë se individët me njohuri më të mira financiare raportojnë pritshmëri më të ulëta dhe më të stabilizuara ndaj goditjeve të ofertës, ndërsa Weber et al. (2022) dokumentojnë se literacia financiare redukton ndikimin e paragjyqimeve të zakonshme si “*extrapolation bias*” dhe “*saliency bias*”. Këto rezultate sugjerojnë se edukimi financiar funksionon si një mekanizëm filtrimi, që redukton mbingarkesën e informacionit dhe i afron parashikimet e individëve me ato të modeleve profesionale.

3.2. Ndikimet mbi Politikën Monetare

Edukimi financiar dhe aftësitë digjitale kanë rëndësi të posaçme për mekanizmin e transmetimit të politikës monetare. Një literaturë e gjerë ka treguar se reagimi i individëve ndaj normave të interesit, njoftimeve të bankës qendrore dhe sinjaleve të inflacionit varet në mënyrë sistematike nga kapacitetet e tyre kognitive dhe informuese. Studimet e Coibion dhe Gorodnichenko (2025) demonstrojnë se pritshmëritë e individëve janë më elastike ndaj informacionit të thjeshtuar dhe të personalizuar, ndërsa trajtimet komplekse të politikës monetare kanë pak efekt për individët me literaci të ulët financiare. Roli i edukimit financiar në përmirësimin e transmetimit të politikës monetare del në pah edhe në punën e D’Acunto, Weber dhe bashkëautorëve, të cilët gjejnë se individët me aftësi më të larta financiare korrigjojnë më shpejt pritshmëritë dhe i përgjigjen më mirë sinjaleve të normave të interesit. Po kështu, studimet e fundit mbi komunikimin monetar

(Blinder et al., 2024; De Fiore et al., 2024) tregojnë se qartësia dhe besueshmëria e mesazheve zyrtare kanë efekt të dukshëm vetëm atëherë kur publiku ka kapacitete bazë njohëse dhe digjitale për t'i interpretuar ato.

Në vende si Shqipëria, ku literacia financiare dhe digjitale janë të pabarabarta, politikëbërësit përballen me sfidën e transmetimit të pabarabartë të politikës monetare. Ndërkohë që një pjesë e popullatës i kupton njoftimet e bankës qendrore dhe i përditëson pritshmëritë në mënyrë të arsyeshme, një pjesë tjetër mbetet e izoluar nga informacioni formal, duke mbështetur pritshmëritë mbi burime të paqëndrueshme ose të pasakta. Si pasojë, politika monetare shpesh humbet një pjesë të efektit të saj stabilizues, ndërsa pasiguria makroekonomike rritet.

4. Ndërlidhja midis bias-eve, edukimit financiar dhe pritshmërive

Ndërveprimi midis bias-eve njohëse, edukimit financiar dhe pritshmërive ekonomike përbën boshtin mikro-foundues të mënyrës se si funksionon makroekonomia në praktikë. Literatura eksperimentale dhe e survejimit tregon se gabimet në parashikim nuk janë rastësore, por të strukturuar: individët mbivlerësojnë peshën e përvojave të fundit, i përgjigjen me vonesë informacionit të ri, dhe mbështeten te heuristika të thjeshta si *“rule of thumb”* apo çmimet që shohin përditë. Modele si *“learning from experience”* të Malmendier dhe Nagel nxjerrin në pah se brezat që kanë përjetuar inflacion të lartë mbajnë pritshmëri më të larta inflacioni për dekada, edhe kur kushtet objektive kanë ndryshuar, duke krijuar një spirale të qëndrueshme të bias-eve historike. Në një linjë të ngjashme, kornizat e myopisë dhe *“cognitive discounting”* sugjerojnë se agjentët thjesht nuk i përpunojnë në mënyrë të plotë pasojat e ngjarjeve të largëta në kohë: shoku i sotëm merr peshën kryesore në mendjen e tyre, ndërsa horizonti i komunikimit të politikëbërësve mbetet abstrakt.

Edukimi financiar vepron si kapacitet kognitiv që mund të zbusë, por jo të eliminojë, këto shtrembërime. Evidenca e survejimeve të mëdha tregon se individët me literacy më të lartë financiare kanë gabime mesatare më të ulëta në pritshmëritë e inflacionit, shmangin ekstremet, dhe reagojnë më koherent ndaj sinjaleve të politikës. Megjithatë, edhe brenda këtij grupi, bias-et nuk zhduken; ato thjesht modulojnë, duke u bërë më të vogla në amplitudë dhe më pak të paqëndrueshme. Studime që lidhin IQ, aftësitë numerike dhe literacinë me pritshmëritë makro tregojnë se individët më të aftë janë më pak

të prirur për over-reaction apo extrapolation të thjeshtë të trendeve, por gjithsesi i nënshtrohen heuristikave, sidomos kur informacioni është kompleks dhe i zhurmshëm. Në këtë kuptim, edukimi financiar nuk është një “kurë” ndaj bias-eve, por një faktor që zvogëlon variancën e gabimeve dhe rrit koherencën midis pritshmërive individuale dhe objektivave të bankës qendrore.

Mjedisi digjital shton një shtresë të tretë kompleksiteti. Rritja e aksesit në informacion, platformat fintech dhe kanalet online të komunikimit monetar kanë potencialin të ulin kostot e informacionit dhe të ulin “inattention”. Por kjo vlen vetëm kur kapaciteti kognitiv (edukimi financiar) dhe aftësitë digjitale ecin në hap me sasinë e informacionit. Në mungesë të këtij balanci, agjentët ekspozohen ndaj “information overload”, burimeve jozyrtare dhe narrativave polarizuese, gjë që mund të rrisë jo vetëm nivelin e gabimeve, por edhe shpërndarjen e pritshmërive. Evidenca e fundit mbi rolin e mediave sociale dhe lajmeve online sugjeron se individët shpesh filtrojnë informacionin monetar përmes lenteve emocionale dhe sociale, duke u mbështetur madhërisht te çmimet e përditshme (p.sh. në supermarketet) dhe te mesazhet e thjeshtuara, në vend që të integrojnë informacionin e detajuar që vjen nga bankat qendrore.

Nga kjo ndërthurje del një mekanizëm i qartë: bias-et themelore (si extrapolation, anchoring, present bias) gjenerojnë gabime sistematike në pritshmëri; niveli i edukimit financiar përcakton sa të mëdha janë këto gabime dhe sa koherent reagojnë individët ndaj sinjaleve të politikës; ndërsa arkitektura digjitale përcakton se çfarë informacioni arrin tek agjentët dhe si filtrohet ai. Në ekonomi me edukim të ulët dhe mjedis informacional të fragmentuar, politika monetare përballet me një “trinom” sfidues: anchor institucional i brishtë, shpërndarje të gjerë të pritshmërive dhe kanale komunikimi që amplifikojnë zhurmën po aq sa sinjalin. Përkundrazi, në ekonomi me literaci më të lartë dhe dizajn të kujdesshëm të komunikimit digjital, e njëjta strukturë bias-esh mund të menaxhohet, duke e kthyer edukimin financiar dhe aftësitë digjitale në instrumente komplementare të stabilizimit makroekonomik.

5. Përfundime

Formimi i pritshmërive makroekonomike është një proces thellësisht njohës, i ndikuar si nga kufizimet individuale të informacionit, ashtu edhe nga mjedisi

institucional dhe teknologjik. Analiza e literaturës tregon se devijimet e pritshmërive nga modeli klasik i pritshmërive racionale janë sistematike dhe të qëndrueshme, duke u formësuar nga paragjykimet njohëse, përvoja personale, niveli i edukimit financiar dhe kapaciteti digjital. Këto gjetje sfidojnë supozimin standard të racionalitetit të plotë dhe theksojnë nevojën për qasje më realiste në makroekonomi. Së pari, paragjykimet njohëse si *anchoring*, *overreaction*, *memory-based updating* dhe *inattention*, ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si individët përpunojnë informacionin ekonomik. Këto mekanizma prodhojnë gabime të parashikimit dhe rrisin shpërndarjen e pritshmërive, fenomen i dokumentuar gjerësisht në studimet eksperimentale dhe të anketave. Së dyti, edukimi financiar shfaqet si faktor moderues që redukton gabimet, rrit koherencën e pritshmërive me treguesit makroekonomikë dhe forcon reagimin e individëve ndaj sinjaleve të politikës monetare. Së treti, aftësitë digjitale luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në epokën e informacionit të bollshëm: ato përcaktojnë aftësinë për të filtruar, verifikuar dhe interpretuar informacionin ekonomik në një mjedis mediatik të fragmentuar.

Në kontekstin shqiptar dhe të Ballkanit Perëndimor, këta faktorë marrin një peshë edhe më të madhe për shkak të niveleve të ulëta të literacisë financiare, hendekut digjital midis zonave urbane dhe rurale, si dhe besimit të kufizuar institucional. Kjo kombinon informacion të pabarabartë, ekspozim intensiv ndaj çmimeve ditore dhe përdorim të lartë të rrjeteve sociale si burim informacioni ekonomik, duke gjeneruar pritshmëri inflacioni të larta dhe të paqëndrueshme. Në këtë dimension, pritshmëritë nuk janë vetëm një koncept teorik, por faktor që lidhet me përfshirjen financiare, vulnerabilitetin ekonomik të familjeve dhe efektivitetin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Këto vlerësime sugjerojnë disa implikime të rëndësishme për politikëbërjen. Së pari, forcimi i edukimit financiar nëpërmjet programeve kombëtare, ndërhyrjeve në shkolla dhe platformave digjitale do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin e pritshmërive dhe në sjelljen e konsumatorëve. Së dyti, përmirësimi i komunikimit monetar përmes mesazheve të thjeshta, të përsëritura dhe të orientuara drejt publikut të gjerë mund të zvogëlojë gabimet e perceptimit dhe të rrisë besueshmërinë institucionale. Së treti, zhvillimi i aftësive digjitale dhe i kulturës së verifikimit të informacionit është thelbësor për të kufizuar efektet e informacionit të pasaktë dhe të zhurmës mediatike mbi pritshmëritë.

Në përfundim, kombinimi i kufizimeve njohëse, edukimit financiar dhe aftësive digjitale formon një treshe kritike që ndikon ndjeshëm në mënyrën se si individët perceptojnë politikën monetare dhe e interpretojnë gjendjen ekonomike. Ky dimension është veçanërisht i rëndësishëm për Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor, ku mjedisi informacional dhe kushtet institucionale e bëjnë popullsinë më të ndjeshme ndaj devijimeve të pritshmërive. Studimet e ardhshme empirike veçanërisht ato që përdorin anketa të strukturuar ose eksperimente të ngjashme me literaturën ndërkombëtare mund të japin evidencë të vlefshme për të kuptuar më thellë këto mekanizma dhe për t'i përkthyer ato në instrumente konkrete të politikës ekonomike.

Literatura

- Afrouzi, H., Blanco, A., Drenik, A., & Hurst, E. (2024). A theory of how workers keep up with inflation (No. w33233). National Bureau of Economic Research.
- Blinder, A. S., Ehrmann, M., De Haan, J., & Jansen, D. J. (2024). Central bank communication with the general public: Promise or false hope?. *Journal of Economic Literature*, 62(2), 425-457.
- Bordalo, P., Gennaioli, N., & Shleifer, A. (2018). Diagnostic expectations and credit cycles. *The Journal of Finance*, 73(1), 199-227.
- Brandao-Marques, L., Albuquerque, R. A., & Costa, C. (2025). A Contribution to the EU's Economic Governance Review: The Importance of Strong National Fiscal Councils. Lusiana. *Economia & Empresa*.
- Coibion, O., & Gorodnichenko, Y. (2015). Information rigidity and the expectations formation process: A simple framework and new facts. *American Economic Review*, 105(8), 2644-2678.
- Coibion, O., & Gorodnichenko, Y. (2025). Inflation, Expectations and Monetary Policy: What Have We Learned and to What End? (No. w33858). National Bureau of Economic Research.
- Coibion, O., Georgarakos, D., Gorodnichenko, Y., & Van Rooij, M. (2023). How does consumption respond to news about inflation? Field evidence from a randomized control trial. *American Economic Journal: Macroeconomics*, 15(3), 109-152.
- Coibion, O., Gorodnichenko, Y., & Weber, M. (2022). Monetary policy communications and their effects on household inflation expectations. *Journal of Political Economy*, 130(6), 1537-1584.

- D'Acunto, F., Charalambakis, E., Georgarakos, D., Kenny, G., Meyer, J., & Weber, M. (2024). Household inflation expectations: An overview of recent insights for monetary policy.
- D'Acunto, F., Hoang, D., Paloviita, M., & Weber, M. (2023). Cognitive constraints and economic incentives. *Bank of Finland Research Discussion Paper*, (9).
- D'Acunto, F., Malmendier, U., Ospina, J., & Weber, M. (2021). Exposure to grocery prices and inflation expectations. *Journal of Political Economy*, 129(5), 1615-1639.
- Das, S., Kuhnen, C. M., & Nagel, S. (2020). Socioeconomic status and macroeconomic expectations. *The Review of Financial Studies*, 33(1), 395-432.
- De Fiore, F., Maurin, A., Mijakovic, A., & Sandri, D. (2024). Monetary policy in the news: communication pass-through and inflation expectations. Bank for International Settlements, Monetary and Economic Department.
- Edelman, J. (2025). Principal Behaviors and Actions That Foster Trust: A Comparative Analysis of Teacher and Principal Perceptions. Concordia University Irvine.
- Feldman, T. (2011). Behavioral biases and investor performance. *Algorithmic Finance*, 1(1), 45-55.
- Gabaix, X. (2019). Behavioral inattention. In *Handbook of behavioral economics: Applications and foundations 1* (Vol. 2, pp. 261-343). North-Holland.
- Hofmann, B., Munakata, K., Rosewall, T., & Sandri, D. (2025). Completing the post-pandemic landing (No. 96). Bank for International Settlements.
- Landier, A., Ma, Y., & Thesmar, D. (2019). Biases in expectations: Experimental evidence. Available at SSRN, 3046955.
- Link, S., Peichl, A., Roth, C., & Wohlfart, J. (2023). Information frictions among firms and households. *Journal of Monetary Economics*, 135, 99-115.
- Lucas Jr, R. E. (1972). Econometric testing of the natural rate hypothesis. *The econometrics of price determination*, 50, 50-59.
- Lusardi, A., & Mitchell, O. S. (2014). The economic importance of financial literacy: Theory and evidence. *American Economic Journal: Journal of Economic Literature*, 52(1), 5-44.
- Malmendier, U., & Nagel, S. (2016). Learning from inflation experiences. *The Quarterly Journal of Economics*, 131(1), 53-87.
- Muth, J. F. (1961). Rational expectations and the theory of price movements. *Econometrica: journal of the Econometric Society*, 315-335.
- OECD/INFE (2023). Support to develop and implement national strategies for financial literacy in EU Member States. Paris, France: OECD. Available at: <https://www.oecd.org/financial/education/financial-literacy-policies-and-initiatives-in-the-european-union.htm>, 12/6/2023.

- Weber, M., Candia, B., Afrouzi, H., Ropele, T., Lluberas, R., Frache, S., ... & Ponce, J. (2025). Tell Me Something I Don't Already Know: Learning in Low-and High-Inflation Settings. *Econometrica*, 93(1), 229-264.
- Weber, M., d'Acunto, F., Gorodnichenko, Y., & Coibion, O. (2022). The subjective inflation expectations of households and firms: Measurement, determinants, and implications. *Journal of Economic Perspectives*, 36(3), 157-184.

Auditimi i brendshëm si instrument strategjik i qeverisjes së mirë

Eni Danaj^{a,13}, Lindita Milo^b, Frederik Çuçllari^a

^a *Koleji Universitar i Biznesit*

^b *Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë*

Përmbledhja

Auditimi i brendshëm ka evoluar nga një funksion tradicional i përputhshmërisë dhe verifikimit financiar në një mekanizëm strategjik që mbështet qeverisjen e mirë përmes menaxhimit të riskut, llogaridhënies, kontrollit të brendshëm dhe integritetit organizativ. Literatura teorike e konceptualizon auditimin e brendshëm si një proces analitik, vlerësues dhe këshillues, i cili mbështet parandalimin e parregullsive, përmirëson efektivitetin operacional dhe rrit besueshmërinë institucionale. Ky punim sintetizon literaturën e fundit për të argumentuar se auditimi i brendshëm, kur është i pavarur dhe i zbatuar profesionalisht, kontribuon në mënyrë të qenësishme në performancën organizative, kulturën etike dhe besimin e palëve të interesit. Gjetjet tregojnë se integrimi strategjik i funksionit të auditimit të brendshëm nxit qëndrueshmërinë institucionale si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Fjalët kyç: Auditimi i brendshëm; Qeverisja e mirë; Llogaridhënia; Menaxhimi i riskut; Kontrolli i brendshëm; Integriteti organizativ

Abstract

Internal auditing has evolved from a traditional compliance and financial verification function into a strategic mechanism that supports good governance through risk management, accountability, internal control, and

¹³ KONTAKT: endanaj@kub.edu.al

organizational integrity. The theoretical literature conceptualizes internal auditing as an analytical, evaluative, and advisory process that supports the prevention of irregularities, improves operational effectiveness, and enhances institutional credibility. This paper synthesizes recent literature to argue that internal auditing, when independent and professionally implemented, makes a substantial contribution to organizational performance, ethical culture, and stakeholder trust. The findings indicate that the strategic integration of the internal audit function promotes institutional sustainability in both the public and private sectors.

Keywords: internal auditing, good governance; accountability, risk management, internal control, organizational integrity

Hyrje

Qeverisja e mirë njihet gjithnjë e më shumë si një element thelbësor për legjitimitetin dhe performancën institucionale. Për më tepër, qeverisja e mirë përfaqëson një model modern administrimi, i cili bazohet në transparencë, llogaridhënie, efektivitet dhe sundim të ligjit. Në këtë kontekst, auditimi i brendshëm është shndërruar në një prej mekanizmave më të rëndësishëm të mbështetjes së mirë qeverisjes, pasi garanton integritet të proceseve, menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe besueshmëri në raportim.

Auditimi i brendshëm, i perceptuar tradicionalisht si një funksion përputhshmërie, sot luan një rol kyç në forcimin e strukturave të qeverisjes, përmirësimin e llogaridhënies dhe fuqizimin e proceseve të menaxhimit të riskut. Mjediset institucionale dhe korporative bashkëkohore përballen me sfida komplekse, si rreziqe të reja operative, çështje etike dhe kërkesa të shtuara të palëve të interesit për transparencë, të cilat kërkojnë një funksion të fuqizuar të auditimit të brendshëm, të aftë të kontribuojë në mënyrë strategjike në rezultatet e qeverisjes. Ky zhvillim ka bërë që auditimi të konsiderohet sot një komponent thelbësor i qeverisjes institucionale, duke kontribuar jo vetëm në kontroll, por edhe në përmirësimin e praktikave të brendshme dhe rritjen e cilësisë së vendimmarrjes.

Eksperienca e Shqipërisë referuar raporteve zyrtare qartësi e vërtetojnë se funksionaliteti i auditimit të brendshëm është një kusht jetësor për eficiencën e sistemeve të kontrollit të brendshëm e për rrjedhojë ka efekte të

drejtpërdrejta në mirë qeverisjen. Në këtë kontekst është konstatuar se mos funksionimi në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit është e lidhur edhe me paqartësitë parimore të funksionimit të auditimit të brendshëm kryesisht në sektorin publik.

Pikërisht , ky punim adreson këto kushte dhe parime baze për një sistem të aludimit të brendshme funksional.

Kuadri teorik dhe konceptual

Auditimi i brendshëm përkufizohet si një veprimtari e pavarur, objektive e sigurimit dhe këshillimit, e projektuar për të krijuar vlerë të shtuar dhe për të përmirësuar funksionimin e organizatës përmes vlerësimit dhe përmirësimit të efektivitetit të menaxhimit të riskut, kontrollit të brendshëm dhe proceseve të qeverisjes (Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA, 2020), Nguyen, T. Q., et.al (2024)). Është gjerësisht e pranuar nga studimet e fushës të qeverisjes theksojnë kontributin e auditimit përtej verifikimit të rregullsisë së disiplinës financiare dhe të përputhshmërisë ligjore, duke përfshirë vlerësimin proaktiv të riskut dhe rolin këshillues strategjik në mbështetje të vendimmarrjes dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Auditimi përkufizohet në literaturën profesionale si një proces sistematik vlerësimi që synon të sigurojë përputhjen e veprimtarive ekonomike me normat, kriteret dhe rregullat e përcaktuara (Arens, Elder & Beasley, 2017). Në këtë kuptim, auditimi përbën një komponent thelbësor të mekanizmave të qeverisjes, pasi kontribuon në garantimin e ligjshmërisë, integritetit dhe efektivitetit të institucioneve (Moeller, 2016). Funksionet e tij lidhen ngushtë me krijimin e baraspeshës organizative, ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare dhe mbrojtjen e interesit publik.

Kuadri teorik i auditimit mbështetet në parimin e besueshmërisë, një kusht i domosdoshëm për funksionimin e marrëdhënieve ekonomike dhe sociale (Pickett, 2010). Zhvillimi historik i auditimit ka treguar se institucionet dhe tregjet nuk mund të funksionojnë pa mekanizma kontrolli që sigurojnë drejtësi dhe ndershmëri (Sawyer et al., 2003). Auditimi shfaqet në këtë kontekst si instrument që orienton sjelljen ekonomike drejt standardeve të pranuar dhe kontribuon në reduktimin e pasigurisë dhe rreziqeve institucionale.

Një element qendror i kuadrit konceptual është roli i audituesit si vlerësues i pavarur dhe garant i drejtësisë së procedurave. Përmes verifikimit, analizës dhe raportimit, audituesi siguron përdorimin ekonomik dhe efektiv

të burimeve dhe vlerëson përputhjen e rezultateve me objektivat strategjike (IIA, 2020). Raportet e auditimit përfaqësojnë instrumenta të rëndësishëm komunikimi që krijojnë transparencë dhe forcojnë besimin midis organizatës dhe palëve të interesit.

Modeli teorik i auditimit përfshin nocionet e efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomikitetit, të cilat lidhen me mënyrën se si organizatat përdorin burimet dhe arrijnë rezultatet e synuara (COSO, 2013). Auditimi vlerëson raportin ndërmjet kostove dhe përfitimeve, verifikon përdorimin e burimeve sipas qëllimit dhe identifikon devijimet që kërkojnë përmirësim të vazhdueshëm.

Ky kuadër teorik e pozicionon auditimin si mekanizëm kyç të qeverisjes së mirë, pasi lidh transparencën me besueshmërinë, kontrollin me ligjshmërinë dhe performancën me përgjegjshmërinë. Nëpërmjet ndërthurjes së funksioneve mbikëqyrëse, vlerësuese dhe këshilluese, auditimi krijon një strukturë normative të domosdoshme për drejtimin dhe stabilitetin institucional.

Auditimi i brendshëm përfaqëson një komponent thelbësor të qeverisjes së mirë, duke siguruar transparencë, llogaridhënie dhe përdorim të përgjegjshëm të burimeve brenda organizatave publike dhe private (. Me zhvillimin e praktikave moderne të menaxhimit, auditimi i brendshëm nuk shihet më si një proces i kufizuar në verifikimin e dokumenteve financiare, por si një funksion i integruar që kontribuon në vlerësimin e riskut, forcimin e kontrolleve të brendshme dhe mbështetjen e vendimmarrjes strategjike.

Auditimi i brendshëm ka evoluar nga një proces i thjeshtë verifikimi financiar në një funksion të integruar vlerësimi, këshillimi dhe sigurie, duke u shndërruar në një mekanizëm që mbështet drejtpërdrejt parimet e qeverisjes së mirë. Kjo qasje përqendrohet te transparenca, llogaridhënia, kontrolli i brendshëm efektiv dhe menaxhimi i qëndrueshëm i riskut, elemente që përbëjnë thelbin e punës së auditimit të brendshëm (Sawyer; Moeller).

Standardet ndërkombëtare të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe kuadri i COSO theksojnë se auditimi i brendshëm ka për detyrë të vlerësojë nëse proceset organizative funksionojnë në përputhje me objektivat, politikat dhe kërkesat ligjore. Një sistem i fortë kontrolli të brendshëm kërkon mekanizma mbikëqyrës që monitorojnë rreziqet, verifikojnë efektivitetin e kontrolleve dhe sigurojnë që informacioni të jetë i besueshëm e i saktë. Auditimi i brendshëm është instrumenti që teston dhe konfirmon këto elemente, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e qeverisjes.

Auditimi i brendshëm si mekanizëm i qeverisjes së mirë

Standardet ndërkombëtare të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe kuadri COSO theksojnë se misioni i auditimit të brendshëm është të vlerësojë në mënyrë të pavarur dhe objektive nëse proceset organizative funksionojnë në përputhje me objektivat strategjike, politikat e brendshme dhe kërkesat ligjore e rregullatore. Në këtë kuadër, auditimi shërben si instrument që teston efektivitetin e kontroleve të brendshme, identifikon rreziqet aktuale dhe potenciale dhe rrit besueshmërinë e informacionit financiar dhe jofinanciar. Studime empirike të fundit tregojnë se organizatat me funksione të konsoliduara të auditimit të brendshëm shfaqin nivele më të larta të transparencës, përputhshmërisë dhe cilësisë së raportimit, duke reflektuar një qeverisje m

Studimet tregojnë se auditimi i brendshëm përforcon standardet e qeverisjes korporative duke vlerësuar sistemet e kontrollit të brendshëm dhe duke monitoruar përputhshmërinë me politikat dhe rregulloret, çka çon në rritjen e transparencës dhe integritetit institucional (Pangastuti, L. A. (2023). Për më tepër, auditimi i brendshëm kontribuon në ndërtimin e etikës organizative dhe integritetit, duke integruar parimet etike në planifikimin e auditimit, megjithëse literatura identifikon edhe pengesa të tilla si mbështetja e pamjaftueshme e menaxhimit dhe kufizimet në burime (Geraldo, J. E., 2025)

Roli i auditimit të brendshëm në qeverisje është i shumëanshëm. Përmes raportimeve të tij, auditimi rrit transparencën, ndihmon identifikimin e parregullsive dhe krijon një kulturë organizative të bazuar në përgjegjësi dhe etikë profesionale. Raportet e auditimit, të cilat konsiderohen mjete thelbësore të kontrollit institucional, japin një vlerësim të qartë të devijimeve nga standardet dhe ndihmojnë drejtuesit të marrin masa korrigjuese në kohë (Lee, 1988; Carmichael & Willingham, 1979; Mallin, 2010). Këto raporte forcojnë besimin e publikut dhe të palëve të interesit, duke ndikuar pozitivisht në reputacionin dhe stabilitetin e organizatës.

Auditimi i brendshëm luan gjithashtu rol parandalues. Duke identifikuar rreziqet potenciale, mangësitë strukturore dhe dobësitë në sistemet e kontrollit, auditimi krijon mundësinë për ndërhyrje të hershme dhe parandalon devijimet që mund të dëmtojnë funksionimin institucional. Literatura thekson se auditimi kontribuon në rritjen e efektivitetit të menaxhimit dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme, pasi sugjeron mënyra konkrete për optimizimin e proceseve dhe përdorimin e burimeve.

Në këtë kuadër, auditimi i brendshëm paraqitet si një mekanizëm i domosdoshëm për funksionimin e qeverisjes së mirë. Ai nuk është thjesht një proces vlerësimi, por një funksion strategjik që mbështet organizatën në arritjen e objektivave, forcimin e integritetit institucional dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm e transparent. Përmes vlerësimit të pavarur, këshillimit profesional dhe kontributit në menaxhimin e riskut, auditimi i brendshëm mbetet një nga shtyllat kryesore që garanton qeverisje të përgjegjshme dhe efektive.

Menaxhimi i riskut dhe auditimi i brendshëm

Rishikimet sistematike të literaturës së fundit tregojnë se auditimi i brendshëm luan një rol vendimtar në sigurimin e përputhshmërisë me politikatat e menaxhimit të riskut dhe në parandalimin e mashtrimeve, duke forcuar kështu kuadrin e qeverisjes në kontekste të ndryshme organizative (Alfina, A., & Utama, A., 2025). Audituesit e brendshëm identifikojnë, vlerësojnë dhe menaxhojnë rreziqe financiare, operative dhe reputacionale, duke përmirësuar qeverisjen përmes rritjes së transparencës së riskut dhe forcimit të mjedisit të kontrollit.

Auditimi i brendshëm dhe performanca organizative

Evidencat empirike sugjerojnë një lidhje pozitive ndërmjet cilësisë së mekanizmave të auditimit të brendshëm dhe rezultateve të qeverisjes, si rritja e transparencës, përmirësimi i performancës dhe forcimi i besimit të palëve të interesit (Ali, S. T., 2024). Këto gjetje përputhen me kërkime më të gjera që dëshmojnë se kontrolli i brendshëm efektiv dhe funksionet e auditimit përforcojnë qëndrueshmërinë institucionale dhe cilësinë e vendimmarrjes..

Metodologjia e punimit

Metodologjia e këtij artikulli bazohet në një analizë cilësore të literaturës teorike dhe burimeve institucionale që trajtojnë auditimin e brendshëm, kontrollin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë. Qasja e përdorur është kryesisht analitike dhe interpretative, me fokus në identifikimin e lidhjeve konceptuale ndërmjet funksioneve të auditimit dhe elementëve përbërës të qeverisjes së mirë. Burimet e përdorura përfshijnë standardet profesionale të auditimit të brendshëm, dokumentet udhëzuese të institucioneve mbikëqyrëse, literaturën bashkëkohore në fushën e qeverisjes, si dhe analizat teorike mbi rolin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut. Përmes

krahasimit të koncepteve të paraqitura në këto burime, artikulli synon të ofrojë një interpretim koherent mbi mënyrën se si auditimi i brendshëm kontribuon në rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit institucional.

Analiza krahasuese

Analiza e rolit të auditimit të brendshëm në qeverisjen e mirë tregon se ky funksion nuk është më thjesht një mekanizëm verifikimi, por një instrument i zhvillimit organizativ dhe i garantimit të integritetit institucional. Rezultatet teorike dhe praktike të nxjerra nga dokumenti bazë tregojnë se auditimi shërben si një faktor i rëndësishëm për rritjen e besueshmërisë, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e përdorimit të burimeve. Aftësia e auditimit për të identifikuar rreziqet, për të vlerësuar efektivitetin dhe eficiencën e proceseve dhe për të nxjerrë rekomandime konkrete e bën atë një mekanizëm kryesor për drejtimin e institucioneve në mënyrë të përgjegjshme. Nga analiza e elementeve të auditimit të performancës dhe të auditimit të ligjshmërisë, vihet re se audituesi luan rol të shumëfishtë: vëzhgues, diagnostikues, këshillues dhe garant i zbatimit të standardeve. Raportet e auditimit tregojnë se rezultatet më të zakonshme të procesit përfshijnë identifikimin e mangësive në përdorimin e burimeve, mungesën e standardizimit të procedurave, dobësi në kontrollin e brendshëm dhe probleme të lidhura me mosrespektimin e rregullave. Ky realitet praktik përputhet me përmbajtjen teorike të dokumentit, ku theksohet se auditimi është i bazuar në ligj, mbështetet në procedura standarde dhe kërkon profesionalizëm të lartë për të siguruar objektivitet dhe besueshmëri.

Diskutimi mbi eficiencën dhe efektivitetin në auditim tregon se dy konceptet janë të pandashme në vlerësimin e qeverisjes së mirë. Eficiencia lidhet me përdorimin optimal të burimeve, ndërsa efektiviteti lidhet me realizimin e objektivave dhe me cilësinë e shërbimeve që organizata u ofron qytetarëve apo klientëve. Dy shtyllat, së bashku, përbëjnë bazën e analizës së performancës, e cila është një nga format më të rëndësishme të auditimit modern. Në studime ka evidenca të qarta se organizatat që e kanë të organizuar sistemin e auditimit kanë më pak gabime, më pak rekomandime korrigjuese dhe nivel më të lartë të besueshmërisë financiare, ndërsa organizatat me mungesë auditimi janë më të ekspozuara ndaj mashtrimeve dhe raportimeve të pasakta. Element i rëndësishëm i diskutimit është edhe ndikimi i auditimit në kulturën

e përgjegjshmërisë. Procesi i auditimit krijon një mekanizëm reflektimi brenda organizatës, ku drejtuesit dhe punonjësit duhet të justifikojnë veprimet, të argumentojnë vendimmarrjen dhe të dokumentojnë procedurat. Kjo nxit përmirësim të vazhdueshëm, rrit transparencën dhe ul mundësinë e abuzimeve. Auditimi vepron si një “sinjal paralajmërues” që orienton sjelljen organizative drejt standardeve dhe praktikave më të mira.

Në terma të qeverisjes së mirë, rezultatet e analizës tregojnë se auditimi i brendshëm ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e besueshmërisë publike, mbrojtjen e interesit ekonomik dhe forcimin e strukturave të kontrollit. Funksioni i auditimit nuk duhet parë si formalitet, por si instrument zhvillimi strategjik. Ai formëson kulturën organizative, orienton vendimmarrjen, rrit cilësinë e raportimit financiar dhe ndihmon në konsolidimin e institucioneve.

Një paraqitje grafike të ndërthurjes së funksioneve kryesore të auditimit të brendshëm dhe garantimi i mirë qeverisjes paraqitet në diagramën e mëposhtme.

Figura 1. Kontributi i auditimit të brendshëm në elementët e qeverisjes së mirë




Burimi: Autori sipas Nagaveni, S. (2024),

Karakteristikat e linjave të mbrojtjes në sektorin publik

Një nga kontributet kryesore të auditimit të brendshëm në qeverisjen e mirë lidhet me modelin “Tre Lijat e Mbrojtjes”, i cili ofron ndarjen e qartë të rolit të funksioneve brenda organizatës. Sipas këtij modeli, menaxhimi operativ (linja e parë) është përgjegjës për zbatimin e proceseve dhe rrezik-menaxhimin e drejtpërdrejtë. Funksionet mbikëqyrëse të riskut dhe përputhshmërisë (linja e dytë) monitorojnë nëse aktivitetet zhvillohen sipas politikave dhe standardeve. Auditimi i brendshëm, si linjë e tretë, ofron vlerësim të pavarur mbi efektivitetin e dy linjave të para dhe siguron që aktivitetet e organizatës të jenë në harmoni me objektivat strategjike, ligjet dhe rregulloret.

Në sektorin publik, modeli i Tre Linjave të Mbrojtjes përbën një kuadër funksional thelbësor për sigurimin e qeverisjes së mirë, transparencës dhe përdorimit të përgjegjshëm të fondeve publike. Ky model përcakton qartë ndarjen e përgjegjësiive ndërmjet aktorëve institucionalë, duke reduktuar mbivendosjen e funksioneve dhe duke forcuar mekanizmat e kontrollit dhe llogaridhënies.

Figura 2. Sistemi i kontrollit të brendshëm dhe “Tre linjat e mbrojtjes” në sektorin publik



Burimi: Autori

Figura paraqet strukturën e sistemit të kontrollit të brendshëm në sektorin publik shqiptar sipas modelit të Tre Linjave të Mbrojtjes.

Linja e parë e mbrojtjes përfaqësohet nga njësitë operationale dhe drejtuesit e programeve publike, të cilët janë drejtpërdrejt përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e politikave publike, administrimin e burimeve buxhetore dhe menaxhimin e rreziqeve operative. Në këtë nivel realizohet zbatimi praktik i kontroleve të brendshme dhe monitorimi i përditshëm i proceseve administrative dhe financiare.

Linja e dytë e mbrojtjes përfshin funksionet e menaxhimit të riskut, kontrollit të brendshëm financiar publik, përputhshmërisë dhe monitorimit të performancës. Këto struktura hartojnë politika, udhëzime dhe procedura standarde, mbikëqyrin respektimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe ofrojnë mbështetje metodologjike për njësitë operationale në identifikimin dhe trajtimin e rreziqeve.

Linja e tretë e mbrojtjes, auditimi i brendshëm, ofron siguri të pavarur dhe objektive mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe qeverisjes institucionale. Në sektorin publik, auditimi i brendshëm ka rol kyç në mbrojtjen e interesit publik, rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit të qytetarëve, duke raportuar drejtpërdrejt tek drejtuesit e lartë dhe strukturat drejtuese.

Në krye të këtij modeli qëndrojnë drejtimi i lartë dhe organet qeverisëse, të cilat përcaktojnë objektivat strategjike, miratojnë politikat publike dhe sigurojnë mbikëqyrjen e përgjithshme të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Analiza krahasuese e praktikave institucionale tregon se institucionet me sisteme të zhvilluara të kontrollit të brendshëm dhe auditimit kanë një përputhshmëri më të lartë me standardet ligjore dhe rregullatore, si dhe një nivel më të ulët të parregullsive dhe mashtrimeve të raportuara (Granling, Maletta, Schneider, & Church, 2004; Soh & Martinov-Bennie, 2018). Raportet e auditimit të brendshëm shërbejnë si burime empirike informacioni për drejtuesit, duke ofruar evidencë mbi eficiencën, efektivitetin dhe ekonomikitetin e përdorimit të burimeve, çka ndikon pozitivisht në procesin e vendimmarrjes strategjike (Pizzini, Lin, & Ziegenfuss, 2015).

Në këtë kontekst, eksperiencia shqiptare tregon se referuar të dhënave të agreguara të analizuara nga sistemi i pyetësorve të vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit paraqitura nga “Raport mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për

vitin 2024”¹⁴ konstatohet se për vitin 2024, janë dhënë Opinione të Vlerësimeve të cilat përfshijnë:

22% të njësive të auditit të brendshëm konkludojnë me “Opinion negativ”: Veprimtaria AB vlerësohet përgjithësisht në MOS përputhje e plotë me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditit;

39 % të njësive të auditit të brendshëm konkludojnë me “Opinion pjesërisht negativ”: Veprimtaria AB në pjesën më të madhe vlerësohet në MOS përputhje e pjesshme me kërkesat e SNA, përmirësime të rëndësishme janë të domosdoshme;

39% të njësive të auditit të brendshëm konkludojnë me “Opinion pjesërisht pozitiv”: Veprimtaria AB në disa fusha është në Mospërputhje me kërkesat e SNA, përmirësime janë të nevojshme.

Opinionet e formuluar në kuadër të vlerësimeve evidentojnë dobësi të dukshme në funksionimin e strukturave të auditimit të brendshëm si në nivelin e qeverisjes vendore, ashtu edhe në institucionet shëndetësore publike. Këto mangësi lidhen kryesisht me mosrespektimin e plotë të kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për auditimin e brendshëm, veçanërisht në aspektin e krijimit dhe funksionalizimit të njësive të auditimit të brendshëm, mënyrës së organizimit dhe sigurimit të shërbimit të auditimit, si dhe në proceset e rekrutimit dhe kualifikimit profesional të audituesve të brendshëm. Për më tepër, vlerësimet tregojnë se zbatimi i standardeve profesionale të auditimit mbetet i pjesshëm, çka ndikon negativisht në cilësinë, pavarësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë audituese¹⁵.

Diskutime

Roli i auditimit të brendshëm në qeverisjen e mirë shtrihet përtej monitorimit të përputhshmërisë; ai vepron si një partner strategjik që informon menaxhimin e lartë dhe organet drejtuese mbi ekspozimet ndaj riskut, dobësitë etike dhe mangësitë e kontrollit. Ky kontribut strategjik është veçanërisht i rëndësishëm në administratën publike, ku kërkesat për transparencë dhe llogaridhënie janë më të theksuara. Për më tepër, literature (Alduaig, M. & Farid, N., 2025) thekson se efektiviteti i auditimit varet nga

¹⁴ <https://financa.gov.al/drejtorse-se-menaxhimit-financiar-kontrollit-dhe-kontabilitetit/>

¹⁵ <https://www.klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/11/Raport-per-Zbatimin-e-Buxhetit-te-Shtetit-te-Vitit-2024.pdf>

pavarësia, mbështetja organizative dhe burimet në dispozicion, duke sugjeruar se funksioni i auditimit duhet të fuqizohet për të maksimizuar ndikimin e tij në qeverisje.

Literatura bashkëkohore thekson se zbatimi efektiv i modelit “TreLinjat” forcon integritetin institucional, rrit transparencën dhe përmirëson cilësinë e vendimmarrjes, veçanërisht në sektorin publik dhe në organizatat me interes publik. Evidencat empirike sugjerojnë se auditimi i brendshëm, kur është i pavarur, profesional dhe i integruar në sistemin e qeverisjes, kontribuon në reduktimin e rrezikut operacional, në parandalimin e parregullsive dhe në rritjen e besimit të palëve të interesit ndaj institucioneve (OECD, 2020; Eulerich & Lenz, 2020; Goodwin & Stein, 2021). Në këtë kontekst, auditimi i brendshëm nuk duhet parë si një funksion formal kontrolli, por si një mekanizëm dinamik dhe strategjik i qeverisjes së mirë, i cili mbështet organizatat në arritjen e objektivave të tyre, në forcimin e llogaridhënies dhe në krijimin e një kulture institucionale të bazuar në përgjegjshmëri, etikë dhe transparencë.

Studimi tregojn se auditimi i brendshëm ka një rol thelbësor në forcimin e qeverisjes së mirë, duke ndikuar drejtpërdrejt në transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin institucional. Analiza e modeleve teorike, veçanërisht “Tre linjat e mbrojtjes”, konfirmon se auditimi i brendshëm funksionon si një mekanizëm i pavarur sigurie, i cili vlerëson objektivisht proceset e menaxhimit të riskut dhe të kontroleve të brendshme. Gjetjet theksojnë se institucionet që zbatojnë struktura të qarta kontrolli dhe auditimi kanë më pak devijime, rreziqe operative më të ulëta dhe një proces vendimmarrjeje më të qëndrueshëm. Nga analiza e literatureës u argumentua se auditimi i brendshëm jo vetëm identifikon mangësitë, por gjithashtu kontribuon në zhvillimin e rekomandimeve praktike që rrisin eficiencën dhe besueshmërinë e institucionit. Në tërësi, gjetjet mbështesin idenë se auditimi i brendshëm është një shtyllë qendrore e qeverisjes së mirë dhe një instrument i domosdoshëm për përmirësim të vazhdueshëm institucional.

Limitimet e studimit

Ky studim paraqet disa kufizime që duhen marrë parasysh në interpretimin e rezultateve. Analiza është bazuar kryesisht në burime teorike dhe modele konceptuale mbi auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë, pa përfshirë të dhëna empirike ose studime rastesh nga institucione konkrete, çka mund të kufizojë përgjithësimin e gjetjeve në situata të ndryshme organizative.

Studimi fokusohet në aspektin teorik të auditimit të brendshëm dhe nuk analizon ndikimin e faktorëve të jashtëm, si kultura organizative, teknologjia apo kapacitetet e menaxhimit, të cilat mund të kenë ndikim të rëndësishëm në praktikën e auditimit.

Punimi është një parashtrim i një studimi empirik i cili është në process dhe që do të kombinojë qasjen teorike me të dhëna empirike.

Përfundime

Literatura ofron prova të qëndrueshme se auditimi i brendshëm, kur integrohet siç duhet në kuadrin e qeverisjes, funksionon si një instrument strategjik që mbështet parimet e qeverisjes së mirë. Ai rrit transparencën, forcon menaxhimin e riskut dhe nxit integritetin organizativ, duke kontribuar kështu në përmirësimin e performancës dhe besimit të palëve të interesit.

Më specifikisht:

- Auditimi i brendshëm është një mekanizëm thelbësor i qeverisjes së mirë, duke siguruar vlerësim të pavarur mbi menaxhimin e riskut, efektivitetin e kontroleve të brendshme dhe respektimin e kuadrit ligjor e rregullator.
- Auditimi i brendshëm rrit transparencën dhe besueshmërinë institucionale, duke forcuar marrëdhënien ndërmjet drejtimit të organizatës dhe palëve të interesit.
- Modeli “Tre linjave të mbrojtjes” konfirmon rolin strategjik të auditimit, duke e pozicionuar atë si linjën e tretë të mbrojtjes që ofron siguri të pavarur dhe objektive mbi proceset organizative.
- Institucionet me struktura të konsoliduara të auditimit shfaqin më pak devijime, kontroll më të mirë të riskut dhe vendimmarrje më të informuar.
- Auditimi i brendshëm kontribuon ndjeshëm në efektivitetin operacional, parandalimin e gabimeve dhe nxitjen e kulturës së përgjegjshmërisë brenda organizatës.
- Roli i auditimit është strategjik dhe jo thjesht formal, pasi orienton zhvillimin organizativ, stabilitetin dhe integritetin institucional.
- Forcimi i kapaciteteve profesionale të auditimit, përditësimi i metodologjive dhe integrimi i praktikave ndërkombëtare janë të domosdoshme për rritjen e cilësisë së qeverisjes dhe përdorimit të përgjegjshëm të burimeve.

Kërkimet e ardhshme duhet të fokusohen në mekanizma specifike kontekstuale që rrisin efektivitetin e auditimit, veçanërisht në ekonomitë në zhvillim dhe në sektorin publik

Literatura

- Alduaig, M. & Farid, N. (2025). The impact of internal auditing on improving risk management under corporate governance. *World Journal of Engineering Research and Technology*, 11(10), 51-89. Gjetur në www.wjert.org
- Alfina, A., & Utama, A. A. G. S. (2025). The role of internal audit in ensuring compliance with risk management policies: Systematic literature review. *Eduvest – Journal of Universal Studies*.
- Ali, S. T. (2024). The role of internal audit in enhancing governance in economic institutions: A field study. *Scientific Research Journal of Economics and Business Management*.
- Arens, A. A., Elder, R. J., & Beasley, M. S. (2017). *Auditing and assurance services: An integrated approach*. Pearson.
- Carmichael, D. R., & Willingham, J. J. (1979). *Auditing: Concepts and methods*. McGraw-Hill.
- Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission (COSO). (2013). *Internal control—Integrated framework*. AICPA.
- Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission (COSO). (2017). *Enterprise risk management—Integrating with strategy and performance*. AICPA. DOI:10.47310/srjebm.2024.v04.i02.005
- Eulerich, M., & Lenz, R. (2020). The value contribution of internal audit: Perceptions of audit committee members and senior management. *Managerial Auditing Journal*, 35(2), 196–224.
<https://doi.org/10.1108/MAJ-01-2019-2145>
- Eulerich, M., Haji-Kazemi, S., & Soderstrom, N. (2021). Internal audit function characteristics and audit committee monitoring. *Accounting & Finance*, 61(1), 533–567. <https://doi.org/10.1111/acfi.12616>
- Geraldo, J. E. (2025). The role of internal audit in promoting organisational ethics and integrity. *Journal of Business Management and Accounting*.
- Goodwin, J., & Stein, M. (2021). Oversight effectiveness of audit committees and internal audit functions: Evidence from public sector entities. *International Journal of Auditing*, 25(1), 63–81.
<https://doi.org/10.1111/ijau.12209>
- Gramling, A. A., Maletta, M. J., Schneider, A., & Church, B. K. (2004). The role of the internal audit function in corporate governance: A synthesis of the extant

- internal auditing literature and directions for future research. *Journal of Accounting Literature*, 23, 194–244.
- Institute of Internal Auditors (IIA). (2020). *International Professional Practices Framework (IPPF)*. The IIA.
- Institute of Internal Auditors. (2020). *International professional practices framework (IPPF)*. The Institute of Internal Auditors.
- Lee, T. A. (1988). *The evolution of auditing: Its history and development*. *Journal of Social and Economic Studies*.
- Mallin, C. A. (2010). *Corporate governance* (3rd ed.). Oxford University Press.
- Moeller, R. R. (2016). *Brink's modern internal auditing* (8th ed.). Wiley.
- Nagaveni, S. (2024, May 20). Maximizing efficiency: The essential purpose of internal audit. *IT Gov Docs*. <https://itgov-docs.com/blogs/internal-audit/maximizing-efficiency-the-essential-purpose-of-internal-audit>
- Nguyen, T. Q., Truong, T. H., Tran, M. D., Phung, V. H., Nguyen, T. L., & Tran, B. M. (2024). Determinants influencing the effectiveness of internal auditing and the responsibility of auditors in fraud detection in an emerging country [Special issue]. *Journal of Governance & Regulation*, 13(1), 310–321. <https://doi.org/10.22495/jgrv13i1siart5>
- Organisation for Economic Co-operation and Development. (2020). *Public integrity handbook*. OECD Publishing. <https://doi.org/10.1787/ac8ed8c8-en>
- Pangastuti, L. A. (2023). The Role of Internal Auditing in Upholding Corporate Governance Standards. *Advances in Managerial Auditing Research*, 1(3), 114–124. <https://doi.org/10.60079/amar.v1i3.214>
- Pickett, K. H. S. (2010). *The internal auditing handbook* (3rd ed.). Wiley.
- Pizzini, M., Lin, S., & Ziegenfuss, D. E. (2015). The impact of internal audit function quality and contribution on audit delay. *Auditing: A Journal of Practice & Theory*, 34(1), 25–58. <https://doi.org/10.2308/ajpt-50848>
- Roussy, M., & Perron, A. (2022). Internal audit as a governance mechanism: A systematic literature review. *Journal of Accounting & Organizational Change*, 18(3), 423–451. <https://doi.org/10.1108/JAOC-10-2020-0126>
- Sawyer, L. B., Dittenhofer, M. A., & Scheiner, J. H. (2003). *Sawyer's internal auditing: The practice of modern internal auditing* (5th ed.). Institute of Internal Auditors.
- Soh, D., & Martinov-Bennie, N. (2018). Factors associated with internal audit's involvement in environmental and social assurance and consulting. *International Journal of Auditing*, 22(3), 404–421. <https://doi.org/10.1111/ijau.12125>

